

# *FGJH*

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA  
UNIVERSITETI I TIRANËS



**12/2025**

## **Botohet për herë të parë në dhjetor 2019**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia\_fgjh@fgjh.edu.al; redaksia\_fgjh@gmail.com

### **©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

**ISSN 2664-7346**

#### **BORDI EDITORIAL**

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Saverina PASHO (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Dr. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore

Dr. Orges SELMANI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Dr. Viola BITI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

#### **BORDI SHKENCOR**

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Saverina PASHO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lorena DEDJA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Klodeta Dibra

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikëna KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Jonida BUSHI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Irena LAMA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Adriatik DERJAJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Xhemile ABDIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Anastasi PRODANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Daniela HASA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Daniela TAMO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lindita SEJDIU RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Freiderikos VALETOPOULOS

(Université de Poitiers, Francë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Ionian, Greqi)

## PËRMBAJTJA

5

Contre les emprunts dans le lexique des sports  
*Prof. Dr. Raul Lilo*

13

Përtej Migrimit: Papërkthyeshmëria, trauma dhe identiteti hibrid  
në veprën e Shkrimtarit Pajtim Statovci  
*Dr. Albana Lilaj*

23

Didaktika e përkthimit në shekullin XXI:  
Kurrikula dhe kompetenca në epokën digjitale  
*Doktorante Anna Maria Vasili*  
*Prof. Dr. Viktor Ristani*

31

Le rôle du patrimoine culturel dans les programmes éducatifs du tourisme  
*MSc. Simonyan Narinee*

43

Pritja bashkëkohore e veprave të përkthyer në Shqip,  
të shkrimtarit italian Italo Calvino  
*Doktorante Marinela Prifti*

55

Lexical and grammatical interference:  
A linguistic problem assessed through translation  
*PhD Candidate Ksenja Ferro*

71

Moralizmi fetar dhe përjashtimi shoqëror në romanin Marta Ajala [L'esclusa]  
të shkrimtarit italian Luigi Pirandello  
*Doktorante Serxha (Kolaj) Gjinaj*

81

Nga riprodhimi drejt reflektimit: Një rast studimor mbi zhvillimin  
e mendimit kritik në mësimin e gjuhës angleze në një institucion të ciklit të mesëm  
*MSc. Mikena Bilbili*  
*Prof. Asoc. Dr. Eileva Koni*

90

Early exposure to a foreign language - developmental effects,  
exposure methods and the influence of parental mediation

*MSc. Sara Tema*

*Prof. Asoc. Dr Rovena Vora*

100

Stilet e të nxënit në mësimnxënien dhe mësimdhënien  
e gjuhës së huaj angleze në arsimin parauniversitar

*MSc. Elton Gjurra*

# CONTRE LES EMPRUNTS DANS LE LEXIQUE DES SPORTS

**Prof. Dr. Raul Lilo**

Département de Français

Faculté des Langues étrangères, Université de Tirana

E-mail: raul.lilo@unitir.edu.al

## RÉSUMÉ

Les emprunts linguistiques constituent un phénomène inévitable dans le contact entre les langues, surtout dans un monde globalisé (Haugen, 1950 ; Weinreich, 1953). Ils apparaissent souvent lorsque de nouveaux objets, idées ou pratiques se diffusent rapidement, et la langue d'origine du concept fournit le mot correspondant. Dans le domaine du sport, l'anglais domine en raison de son rôle central dans la médiatisation internationale et dans la création de disciplines modernes (Crystal, 2003 ; Graddol, 2006) (Placeholder1). Des termes comme *play-off*, *fair-play* etc., se sont imposés dans de nombreuses langues. Ces emprunts reflètent une ouverture culturelle, mais peuvent aussi susciter des inquiétudes concernant la perte d'identité linguistique. Certains prônent la création d'équivalents locaux, tandis que d'autres estiment que ces mots enrichissent la langue et témoignent de son évolution naturelle.

Mots-clés: emprunts linguistiques, anglais et sport, mondialisation, identité

## ABSTRACT

Linguistic borrowing is an inevitable phenomenon arising from contact between languages, especially in a globalized world (Haugen, 1950; Weinreich, 1953). It often occurs when new objects, ideas, or practices spread quickly and the source language provides the corresponding terminology. In the field of sports, English predominates due to its central role in international media and in the development of modern disciplines (Crystal, 2003; Graddol, 2006). Terms such as *play-off* and *fair-play* have become established in many languages. These borrowings reflect cultural openness but can also raise concerns about the erosion of linguistic identity. Some scholars advocate for the creation of local equivalents, while others argue that such borrowings enrich the language and reflect its natural evolution.

Keywords: linguistic borrowing, English in sports, globalization, linguistic identity

## 1. Contact de langues et emprunts

Une langue n'est jamais isolée. Chaque communauté linguistique a toujours des relations avec d'autres, car le monde est plurilingue et les communautés linguistiques se côtoient sans cesse (Weinreich, 1953). De nos jours, l'ouverture de l'Albanie sur l'Occident depuis 1990 et la mondialisation des échanges a entraîné un contact sans précédent entre l'albanais et les autres langues. Par conséquent, les transformations politico-sociales, économiques, culturelles et technologiques induisent un changement linguistique. La mondialisation se manifeste dans tous les secteurs d'activité et elle ne peut pas laisser le vocabulaire qui s'y rapporte intact. Mais, dans cette communication, nous nous intéressons à ce qui se passe sur le plan linguistique dans le domaine du sport : un bon nombre d'*italianismes*, d'*anglicismes*, voire des vocables venant du *français* ou de l'*espagnol*, occupent une place de plus en plus importante dans le lexique des sports. Depuis plus de trois décennies, le monde du sport en Albanie change, les sportifs sont des professionnels, et les médias jouent un rôle important dans la diffusion des sports où les vocables d'origine étrangère abondent. Cependant, nous constatons aussi, pour des raisons diverses, que tous les locuteurs n'ont pas les mêmes usages. D'une langue à l'autre, on constate également des variations sémantiques.

Nous avons tout d'abord mené une recherche empirique en recueillant des emprunts dans le quotidien sportif *Panorama Sport*. Quant au choix du journal, un facteur décisif a guidé notre sélection : c'est le journal le plus lu actuellement dans le domaine du sport, en Albanie. La constitution du corpus s'est faite majoritairement du 1<sup>er</sup> janvier 2025 au 31 octobre 2025.

À l'heure actuelle, le vocabulaire sportif est tellement peuplé d'emprunts qu'on pourrait même avancer l'hypothèse qu'il est plus facile d'utiliser un emprunt qu'un vocable autochtone. Il y a quelques facteurs qui jouent à l'avantage de l'emprunt (Martinet, 1960): le vocable existe dans *une relation signifiant - signifié déjà établie*, conditionnant l'esprit et donnant un sentiment de sécurité ; *le snobisme*, les vocables étrangers peuvent servir à marquer, peut-être, une certaine «différence sociale» ; *l'exotisme*, les emprunts peuvent posséder un petit quelque chose de fascinant ; *la loi du moindre effort enfin*, car il est plus facile d'emprunter que d'utiliser les équivalents albanais ou de « néologiser ». Mais, considérons plutôt quelques exemples pertinents, extraits du quotidien sportif *Panorama Sport* :

## 2. Essai de typologie des emprunts collectés

A. Souvent, le mot albanais existe et peut remplacer le vocable d'origine étrangère qui n'est pas nécessaire. Dans ce cas, selon la terminologie du linguiste

français Louis Guilbert<sup>1</sup>, on peut parler d'*emprunts de luxe* (Guilbert, 1975). En plus, (Brunet, 1995) de concert avec Sylvie Brunet, on peut dire aussi que « *chaque époque a ses modismes* ».

**a.** Quelques exemples provenant de l'italien :

- *dopietë* (it. doppietta) / *dygolësh* (alb.)
- 
- *tripletë* (it. tripletta) / *trigolësh* (alb.)
- *pankinë* (it. panchina) / *stol* (alb.)
- *teknik,u* (it. tecnico) / *trajner* (alb.)
- *skuderia Ferrari* (it. Scuderia Ferrari) / *ekipi Ferrari, skuadra Ferrari* (alb.)
- *impiant modern* (it. Impianto moderno) / *stadium modern* (alb.)
- *...ekipi bëri mirë sot* (it. *La squadra ha fatto bene oggi*) / *... ekipi zhvilloi lojë të mire sot* (alb.)

**b.** Voilà quelques exemples provenant du français :

- *posedoj topin* (fr. posséder la balle) / *zotëroj topin* (alb.)
- *perioda e parë e ndeshjes* (fr. la première période du match) / (*pjesa e parë e ndeshjes* (alb.)
- *gardian,i* (fr. gardien de but) / *portier* (alb.)

**c.** Et voilà quelques exemples venant de l'anglais :

- *start* (ang.) / *nisje* (alb.). Les commentateurs sportifs utilise de plus en plus souvent ce vocable en Formule Un.
- *play - off* (ang.) / *fazë shtesë, ndeshje shtesë* (alb.)
- *sponsor* (ang.) / *dhurues* (alb.)
- *fair - play* (ang.) / *lojë e ndershme* (alb.)
- *play - out* (ang.) / *fazë, ndeshje për mbijetesë* (alb.)
- *bomber* (ang.; on l'utilise aussi en italien) / *golshënuesi, sulmuesi kryesor* (alb.)
- *ofsajd* (ang. off-side) / (pozicion) *jashtë loje*

**d.** Enfin, un exemple provenant de l'espagnol :

- *goleador* (esp.) / *golshënues* (alb.)

**B.** Un phénomène très négatif, de nos jours, est la reprise ou le retour des vocables étrangers remplacés par les équivalents albanais jusqu'en 1990. La revue linguistique « Notre langue » a beaucoup contribué à cette fin. Pendant plus de dix ans les linguistes albanais ont fait bien des recommandations afin de remplacer un bon nombre d'emprunts par des vocables autochtones. Et cela,

1 GUILBERT, L., (1975), *La créativité lexicale*, Larousse, Paris, p. 89-100.

même dans le domaine des sports. Considérons quelques exemples :

- *penallti* (ang. penalty) / *njëmbëdhjetëmetërsh* (alb.)
- *korne* (ang. corner) / *goditje këndi* ou *këndore* (alb.)
- *gardalinë* (it. guardalinee) / *vijërojtës, anësori* < *gjqqtar anësor* (alb.)
- *turi i Shqipërisë* (fr. le tour de France) / *rrëthi çiklistik i Shqipërisë* (alb.)

C. L'utilisation des vocables étrangers et leur variation sémantique :

Un exemple qui revient souvent dans la pratique langagière actuelle est l'anglicisme *derby* qui signifie « match entre équipes voisines d'une ville (par exemple : le derby de la capitale), voire d'une région », par exemple : les rencontres entre *AS Roma* et *S.S. Lazio*, *Milan* et *Inter*, *Juventus* et *Turin* en Italie, *Tirana* et *Partizani*, *Skënderbeu* et *Pogradeci* (le derby du sud-est) en Albanie. Mais, actuellement on constate une extension d'emploi de ce vocable comportant le sème « un match important ou décisif entre équipes rivales dans un pays » : par exemple, les rencontres entre *Juventus* et *Inter*, en Italie ; *PSG* et *Marseille* en France ; *Partizani* et *Vllaznia*, en Albanie etc.

### 3. Emprunts, créativité lexicale et dirigisme linguistique

#### - En Albanie

Une question se pose tout naturellement : A-t-on fait, au fil des années, des efforts pour préserver et enrichir continuellement la langue albanaise, afin qu'elle réponde aux évolutions du monde dans tous les domaines, y compris celui du sport ?

Dans l'histoire de l'albanais il y a eu deux mouvements organisés visant à le préserver et à l'enrichir. Le premier mouvement, qui ne nous intéresse pas tellement dans le cadre de cette communication englobe l'époque de la Renaissance. Pendant cette période, ce sont les écrivains tels que Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jani Vreto, Andon Zako Çajupi, etc., qui ont joué un rôle important afin de bannir surtout les vocables turcs de l'albanais.

Après, jusqu'en 1980 il y a eu plutôt des activités individuelles. L'un des plus ardents dans ce domaine a été Aleksandër Xhuvani, qui a publié même un livre : «Pour la pureté de la langue albanaise» (Xhuvani, 1956). Il s'agit d'un travail acharné d'une cinquantaine d'années où il propose de remplacer environ 300 emprunts (y compris des vocables venant du français). En voilà quelques exemples :

- *intim* (fr. intime) ? *i afërt*
- *izoloj* (fr. isoler) ? *veçoj*
- *kolektiv* (fr. collectif) ? *i përbashkët*
- *kompletoj* (fr. compléter) ? *plotësoj*

- *kompakt* (fr. compact) ? *i ngjeshur, i dëndur*
- *i komplikuar* (fr. compliqué) ? *i ndërlikuar*

Mais, au début des années '80, dans le cadre d'une rationalisation ou modernisation planifiée de l'albanais dit «standard», on a entrepris une large campagne en vue de remplacer par des vocables autochtones un bon nombre d'emprunts, essentiellement d'origine italienne ou française. En 1979 on a créé la Commission Permanente, auprès du Conseil des Ministres, qui allait organiser l'activité visant l'épuration et l'enrichissement de la langue littéraire albanaise. À cette fin, une revue linguistique «Notre langue» a également vu le jour sous l'égide de l'Académie des Sciences. Dans cette revue, il y avait une rubrique spéciale intitulée «Le vocable albanais à la place d'un vocable d'origine étrangère». Là, il y avait aussi quelques exemples relatifs au lexique du sport. Toutes ces recommandations officielles ont même été regroupées dans un dictionnaire par quelques linguistes bien connus sous l'égide d'Androkli Kostallari<sup>2</sup> (Kostallari, 1984)

En 1992 et en 2002 il y a eu deux conférences internationales sur la langue albanaise organisées sous l'égide de l'Académie des Sciences d'Albanie.

De plus, en 2003, les meilleurs spécialistes de l'Institut de Littérature et de Linguistique ont rédigé un projet de loi<sup>3</sup>, ayant pour but la défense de l'albanais, et qui peut-être sera adopté un jour par le Parlement Albanais. Par ce projet de loi, les linguistes-défenseurs de l'albanais, exigent que des rédacteurs travaillent dans toutes les institutions de l'état. Par ailleurs, étant donné que les villes albanaises ont pris des «allures méconnaissables», on interdira peut-être un jour les enseignes étrangères des bars, des restaurants, des hôtels etc. Actuellement, on a interdit les paris sportifs, et les appellations qu'ils comportaient se sont estompées quelque peu au fil du temps.

En guise de conclusion, on peut dire que cette activité planifiée et bien orchestrée afin de remplacer les emprunts a été en général stimulée par des raisons extra-linguistiques. À vrai dire, il n'y a pas eu jusqu'à l'heure actuelle d'études particulières à orientation sociolinguistique pour vérifier l'impact direct des recommandations officielles dans la vie quotidienne de la communauté albanaise. Il pourrait être révélateur et intéressant d'enregistrer par exemple la réaction spontanée d'un usager ordinaire. Il est vrai que dans de nombreux cas les emprunts survivent. Selon S. Brunet «chaque époque a ses modismes qui, à eux seuls, restituent le parfum d'une décennie, l'image d'un contexte sociologique».<sup>4</sup>

2 KOSTALLARI A. et alii (1998), *Për pastërtinë e shqipes*, (Fjalor), Tiranë.

3 CENAJ A. (22 juillet 2003), *Një ligj për mbrojtjen e gjuhës shqipe*, in Koha Jonë, p.19

4 BRUNET S., (2001), *Les mots de la fin du siècle*, Belin, Paris, p. 35

De nos jours, il y a en albanais et en particulier dans le vocabulaire des sports, un afflux d'emprunts d'origine italienne, anglo-américaine et française. L'uniformité, la stabilité et la campagne de purisme exigées avec tant de persévérance dans les années '80, se révèlent actuellement tout à fait utopiques.

Dans les circonstances d'une osmose interculturelle toujours plus grandissante entre les différentes communautés, l'attitude envers les emprunts en albanais contemporain exige obligatoirement une réévaluation plus attentive. «Emprunter un mot, c'est emprunter un concept (Calvet, 1999): plus même, une vision du monde»(Toinet, 1991)<sup>5</sup>, nous dit Marie-France Toinet.

### - En France

La défense du français a fait couler beaucoup d'encre. Le projet des dirigistes, rendre la langue «meilleure», est lié à des motifs extra-linguistiques. D'une part, les puristes condamnent toute création pour que soit préservée dans un monde changeant une langue «pure». D'autre part, les dirigistes, eux, veulent contribuer à l'évolution du français pour qu'il se répande.

Tout d'abord, on peut mentionner l'activité des organisations qui se sont donné pour tâche de défendre la norme et de diriger l'évolution du français. Il faut souligner qu'elles se sont surtout développées après 1945 et portent le plus gros de leurs efforts sur le domaine du lexique. Ainsi, *l'Académie française*, depuis 1954, publie des mises en garde, diffusées par la presse. On peut citer aussi d'autres organismes comme : *L'Office de la langue française* (OLF), *L'Office du vocabulaire français* (OVF), *Le Comité d'étude des termes techniques français*, *L'Association française de normalisation*, (AFNOR), *La Défense de la langue française* (DFL), *Le Haut Comité pour la défense et l'expansion de la langue française*, *L'Association pour le bon usage du français de l'administration*. Il y a également beaucoup d'organismes constituant *La Fédération du Français Universel*.

Des commissions de terminologie ont été aussi créées dans chaque ministère à partir de 1970 (par exemple : arrêté du 7 juillet 1970 *vocabulaire pétrolier*, arrêté du 16 juin 1971 ? *vocabulaire de l'économie et des finances*, etc.).

On a effectué aussi beaucoup d'efforts pour les listes d'expressions et de termes parus au *Journal officiel* et dont l'emploi est rendu obligatoire ou recommandé par arrêté (par exemple : arrêtés du 12 janvier 1973 ? *terminologie de l'audio-visuel, vocabulaire du bâtiment, des travaux publics et de l'urbanisme* ; arrêté du 2 janvier 1975 ? *vocabulaire de la santé et de la médecine* ; circulaire du 15 septembre 1977 ? *vocabulaire judiciaire*, etc.).

5 TOINET M.F., (1991), *Les mots ne sont pas neutres*, in *Échos*, n. 63, p. 81

Cependant, la législation linguistique en France a connu aussi des rebondissements. Ainsi, dès l'annonce du projet de loi (la loi Toubon) sur l'emploi de la langue française, ce dernier a suscité beaucoup de réactions surtout auprès des défenseurs des langues régionales. Le projet de loi sur l'emploi du français dont Jacques Toubon fait mention dans ses vœux du 11 janvier 1994, n'est pas une nouveauté. Il vient renforcer une loi et une action en faveur de la langue française déjà existante.

-1972 : Décret du 7 janvier 1972 *relatif à l'enrichissement de la langue française* qui prévoit la création des commissions ministérielles de terminologie pour l'enrichissement du vocabulaire français. La commission ministérielle de terminologie du sport a été créée en 1984. Ce décret sera remplacé par celui de 1986 qui sera lui-même abrogé par l'entrée en vigueur du décret de 1996.

-1975 : Loi Bas-Lauriol *relative à l'emploi de la langue française*.

-1992 : La loi constitutionnelle du 15 juin 1992 pose le principe que «*la langue de la République est le français*».

- 1994 : La «loi Toubon» *relative à l'emploi de la langue française* se substitue à la loi Bas-Lauriol. Entrée en vigueur en septembre 1995, elle étend l'action de la loi précédente à l'enseignement, l'audiovisuel et aux colloques scientifiques. Elle s'accompagne de sanctions clairement spécifiées dans le texte qui s'appuie sur le code pénal et le code du travail.

En ce qui concerne le lexique des sports, *La Délégation générale à la langue française et aux langues de France* a publié le document «*Vous pouvez le dire en français – Football*» qui suggère l'utilisation de formulations en français à la place des emprunts sportifs typiques : par exemple, *phase finale* pour *play-off*, *hors-jeu* pour *off-side*, *marché des transferts* pour *mercato* etc. De plus, un guide intitulé «*Guide de bonnes pratiques linguistiques pour le secteur du sport francophone*» a été publié récemment, contenant des directives sur la terminologie sportive quotidienne et l'usage d'un français plus riche dans le contexte sportif.

Au terme de cet exposé sur les grandes étapes de la législation linguistique en France, on peut remarquer aisément les efforts continuels des français en vue de défendre et surtout de diriger l'évolution de leur langue. En revanche, les albanais agissent plutôt individuellement et très lentement, malgré les problèmes multiples posés par le déferlement des vocables étrangers en albanais d'aujourd'hui, et en particulier dans la langue des sports.

## Conclusions

Lorsqu'on emprunte, on se prête en même temps à des interprétations conceptuelles déterminées par un milieu «étranger» aux préoccupations qu'un pays donné peut avoir ; on accepte une vision de la réalité, d'une autre réalité.

L'intérêt et la pratique du sport augmente de jour en jour. Les emprunts sportifs augmentent également. Et ce sont les jeunes qui en usent particulièrement. Une étude sociolinguistique serait intéressante et révélatrice en ce sens ; les variations sémantiques également sont de plus en plus présentes.

La politique linguistique doit contribuer à élever le niveau de la culture linguistique des citoyens. Le comité interacadémique créé en 2004 doit s'occuper en priorité des emprunts, qui abondent en albanais contemporain. D'ailleurs, le Comité Olympique albanais pourrait prendre l'initiative de publier un guide et de préconiser l'utilisation des vocables albanais à la place des mots d'origine étrangère. La langue albanaise possède tous les moyens nécessaires pour remplacer une grande partie des emprunts superflus, largement utilisés aujourd'hui dans le lexique du sport.

### Abréviations

- alb. / albanais
- ang. / anglais
- it. / italien
- fr. / français
- esp. / espagnol

### BIBLIOGRAPHIE

- BRUNET, S. (1995). *Les mots de la mode*. Paris: Belin.
- CALVET, L.-J. (1999). *Pour une écologie des langues du monde*. Paris: Plon.
- Crystal, D. (2003). *English as a Global Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- GRADDOL, D. (2006). *English Next*. London: British Council.
- GUILBERT, L. (1975). *La créativité lexicale*. Paris: Larousse.
- HAUGEN, E. (1950). "The Analysis of Linguistic Borrowing". *Language*, 26(2), 210–231.
- KOSTALLARI, A. (1984). *Gjuha letrare kombëtare dhe norma e saj*. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- MARTINET, A. (1960). *Éléments de linguistique générale*. Paris: Armand Colin.
- TOINET, M.-F. (1991). *L'anglais en France*. Paris: PUF.
- TOUBON, J. (1994). *Loi relative à l'emploi de la langue française*.
- WEINREICH, U. (1953). *Languages in Contact*. New York.
- XHUVANI, A. (1956). *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*. Tiranë.

PËRTEJ MIGRIMIT:  
PAPËRKTHYESHMËRIA, TRAUMA  
DHE IDENTITETI HIBRID NË VEPRËN E SHKRIMTARIT  
PAJTIM STATOVCI

**Dr. Albana Lilaj**

Departamenti i Gjuhës Angleze  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: albana.lilaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky punim analizon mënyrën se si letërsia e migracionit rikoncepton identitetin, përkatësinë dhe subjektivitetin përmes një leximi kritik të romanit *Macja ime Jugosllavia* (My Cat Jugosllavia) të shkrimtarit Pajtim Statovci. Në fokus qëndron përvoja e migrimit jo si një proces linear integrimi, por si një gjendje e vazhdueshme fragmentimi dhe negocimi identitar. Analiza tregon se romani e paraqet migrimin si një përvojë thyerjeje që trashëgohet ndër breza, ku trauma dhe kujtesa ndërthuren në formimin e subjektivitetit. Në të njëjtën kohë, vepra nxjerr në pah tensionet kulturore dhe papërkthyeshmërinë e disa koncepteve, duke treguar kufijtë e përkthimit dhe të përfshirjes në një kontekst të ri. Përvoja e protagonistit komplikohet më tej nga ndërthurja e migrimit me identitetin seksual, duke ekspozuar forma të shumëfishta përjashtimi dhe tjetërsimi. Në përfundim, argumentohet se romani nuk ofron një narrativë të stabilizuar të përkatësisë, por e paraqet migrimin si një gjendje të hapur, të paqëndrueshme dhe të pambyllur, ku identiteti mbetet vazhdimisht në proces formimi.

Fjalët çelës: identiteti, identiteti homoseksual, kujtesa ndërbreznore, letërsia e migracionit, papërkthyeshmëria, përkatësia, tjetërsimi, trauma.

ABSTRACT

This paper examines how migration literature reconfigures identity, belonging, and subjectivity through a critical reading of the novel *My Cat Yugoslavia* (My Cat Jugosllavia) by Pajtim Statovci. It approaches migration not as a linear process of integration, but as an ongoing condition marked by fragmentation and continuous identity negotiation. The analysis demonstrates that the novel portrays migration as an experience of rupture transmitted across generations, in which trauma and memory intersect in the formation of subjectivity. At the same time, the text foregrounds cultural tensions and the untranslatability of certain concepts, thereby revealing the limits of translation and

inclusion within a new context. The protagonist's experience is further complicated by the intersection of migration and sexual identity, exposing multiple forms of exclusion and othering. In conclusion, the paper argues that the novel does not offer a stable narrative of belonging; rather it presents migration as an open, unstable, and unresolved condition in which identity remains in a constant process of becoming.

Keywords: migration literature, identity, trauma, intergenerational memory, untranslatability, belonging, otherness, queer identity.

## Hyrje

Letërsia e migracionit shfaqet tashmë si një fushë e rëndësishme në studimet letrare bashkëkohore, duke sfiduar kështu konceptet tradicionale të identitetit, përkatësisë dhe kombit. Konteksti i zhvillimeve të vullshme globalizuese dhe lëvizjeve migratore të shumta me të drejtë e përforcojnë këtë prirje. Kjo fushë studimore e trajton migrimin jo thjesht si një zhvendosje fizike nga një hapësirë në tjetrën, por si një proces kompleks transformimi të vetëdijes së individit, ku identiteti i tij negociohet vazhdimisht ndërmjet kulturave, gjuhëve dhe historive të ndryshme. Njohja e teorive të ndryshme mbi kulturën dhe letërsinë e migracionit shërben si kornizë konceptuale që ndihmon në interpretimin e proceseve komplekse identitare, kulturore dhe historike që ngërthen kjo letërsi. Në këtë kuptim ato ofrojnë mjetet e nevojshme për të lexuar edhe veprën e shkrimtarit kosovar Pajtim Statovci, përtej dimensionit të saj narrativ, i cili pa këtë ndërmjetësim teorik rrezikon të reduktohet në një rrëfim biografik të zhvendosjes, duke humbur karakteristikën më radikale: destabilizimin e kategorive të qëndrueshme të identitetit, përkatësisë dhe vetëdijes. Në këtë kuptim, vepra e Statovcit nuk është thjesht një ilustrim i teorive të migracionit, por një ndërhyrje në to, për vetë faktin se ajo nxjerr në pah kufizimet e modeleve ekzistuese interpretative dhe e ekspozon përvojën migratore si thelbësisht të papërkthyeshme, të fragmentuar dhe të pambyllur.

Teori si ato të Homi K. Bhabha-s mbi hapësirën e ndërmjetme, të Stuart Hall-it mbi identitetin si proces dinamik, apo të Marianne Hirsch-it mbi postkujtesën, ofrojnë mjete analitike për të kuptuar se si përvoja e migrimit shkon përtej zhvendosjes fizike dhe shndërrohet në një gjendje të vazhdueshme negocimi, fragmentimi dhe trashëgimie ndërbreznore.

## Identiteti si hapësirë negocimi: përtej origjinës dhe përkatësisë

Një nga kontributet më me ndikim në leximin e identitetit hibrid vjen nga Homi K. Bhabha, i cili zhvillon konceptin e “hapësirës së tretë” dhe “gjendjes së ndërmjetme”, sipas të cilit identiteti nuk është i qëndrueshëm apo thelbësor.

Përkundrazi, sipas tij, ky identitet njerëzor i migrantëve formohet në hapësira të ndërmjetme, ku kuptimet kulturore dialogohen dhe negociohen në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë kuptim, letërsia e migracionit nuk përfaqëson thjesht gjendjen e ndërmjetme të të qenit “mes dy botëve” apo “dy kulturave”, po ofron një mundësi ku shtresëzimet e identitetit tronditen dhe destabilizohen.<sup>1</sup>

Në një optikë të përafërt, studiuesi Stuart Hall e koncepton identitetin jo si një thelb të pandryshueshëm, por si proces dinamik të ndërtimit dhe rindërtimit të vazhdueshëm të tij. Hall argumenton se identiteti migrator ndikohet nga historia, ndërtohet nga kultura dhe transformohet nga përvoja, veçanërisht ajo migratore, duke hedhur poshtë, kështu, idenë e origjinës së pastër apo të rikuperueshme. Kjo qasje na ndihmon të kuptojmë se si subjektet migratore nuk “kthehen” kurrë në identitetin e mëparshëm, por vazhdimisht e rindërtojnë dhe transformojnë atë.<sup>2</sup>

Po aq interesant dhe i rëndësishëm në kuptimin e letërsisë së migracionit është edhe këndvështrimi që ofron Mariane Hirsch-i, e cila vë në qendër të diskutimit traumat dhe kujtesën ndërbreznore. Hirsch argumenton se brezat e mëvonshëm trashëgojnë trauma që nuk i kanë përjetuar drejtpërdrejt, por që ndikojnë thellësisht në formimin e vetëdijes së tyre identitare. Rrjedhimisht, sipas Hirsch-it, përvoja e zhvendosjes nuk kufizohet vetëm te brezi i parë, i cili ka përvojën e përjetimit të drejtpërdrejtë të migracionit dhe përballjes me kulturën e vendit pritës, por vazhdon të strukturojë identitetin përtej përvojës individuale.<sup>3</sup>

Studimet në fushën e letërsisë së migracionit veçojnë si të rëndësishme edhe çështjen e gjuhës dhe përkthimit. Emily Apter thekson rolin e “papërkthyeshmërisë”, duke argumentuar se disa koncepte kulturore i rezistojnë përkthimit dhe mbeten të lidhura ngushtë me kontekstin e tyre origjinal. Sipas saj, në letërsinë e migracionit, kjo krijon tension midis përfshirjes dhe përjashtimit, pasi gjuha bëhet njëkohësisht mjet komunikimi dhe kufi identitar.<sup>4</sup>

Së fundmi, ndërthurja e migrimit me seksualitetin është trajtuar nga Eithne Luibhéid, e cila tregon se përvojat migratore të homoseksualitetit, nuk janë gjithnjë çliruese, pasi ato shpesh kushtëzohen nga struktura racore, kulturore dhe politike. Kjo qasje bie në kundërshtim me narrativat perëndimore që e lidhin migrimin me hapjen, progresin dhe emancipimin, duke dëshmuar se përjashtimi mund të rishfaqet në forma të reja edhe në ato kultura që konsiderohen të hapura.<sup>5</sup>

1 BHABHA, H., K. (1994), *The Location of Culture*, London: Routledge, f.2-58.

2 HALL, S., (1990), *Cultural Identity and Diaspora*, London: Lawrence & Wishart, f.225-227.

3 HIRSCH, M., (2012), *The Generation of Postmemory: Writing and Visual Culture After the Holocaust*, New York: Columbia University Press, f. 45-47.

4 APTER, E., (2013), *Against World Literature*, London: Verso, f. 12-14.

5 LUIBHÉID, E., (2002), *Entry Denied*, Minneapolis: University of Minnesota Press, f. 9-12.

### **Migrimi si thyerje e trashëguar: trauma, kujtesa dhe përkatësia e pamundur**

Në këtë kuadër teorik, letërsia e migracionit nuk mund të kuptohet si një rrëfim linear i zhvendosjes, por si një hapësirë ku identiteti mbetet i fragmentuar, kujtesa e paqëndrueshme dhe përkatësia thelbësisht e pasigurt.

E gjejmë të shpërfaqur në këtë formë identitetin edhe në veprën e Statovcit, brenda së cilës përvoja e zhvendosjes ndërthuret me përpjekjet për eksplorimin e identitetit, trupit dhe përkatësisë kulturore. Largimi i tij nga vetëdija e vendit të origjinës drejt asaj të mërgimitarit mbetet një proces i papërmyllur dhe thellësisht i fragmentuar.

Në këtë kuptim, letërsia e tij nuk kufizohet në përshkrimin e migrimit si fenomen social, por e trajton atë si një proces kompleks riformësimi ekzistencial dhe simbolik.

Në veprën e Statovcit, përvoja e migracionit shpesh materializohet përmes personazheve që jetojnë në kufi të dy kulturave, pa arritur të pozicionohen, mes hapësirave gjeografike dhe sistemeve kulturore që nuk përpunohen plotësisht. Kjo ndjesi e “të qenurit diku në mes” prodhon jo vetëm ndarje dhe tjetërsim, por edhe mundësi për shprehje alternative të vetvetes. Identiteti në këto tekste shfaqet si i lëvizshëm, artificial deri në pavërtetësi dhe, shpesh i paqëndrueshëm, duke reflektuar tensionet midis kujtesës së vendlindjes dhe realitetit të vendit pritës.<sup>6</sup>

Koncepti i hibriditetit kulturor na ndihmon të analizojmë dhe kuptojmë dinamikat e mësipërme duke pranuar si pikënisje teorike idenë se identitetet formohen përmes ndërveprimit dhe shkrirjes së kulturave të ndryshme. Nocioni i hapësirës së ndërmjetme ofron mekanizmin analitik për të kuptuar zonat ku këto identitete negociohen dhe riformësohen, duke sfiduar kufijtë e përcaktuar midis “vendit të origjinës” dhe “vendit të pritjes”. Paralelisht, teoritë e diasporës dhe të përkatësisë së shumëfishtë na vijnë në ndihmë që ta shohim përvojën migratore si thelbësisht transnacionale, ku përkatësia nuk është më e lidhur me një hapësirë të vetme, por shpërndahet në rrjete të shumta kulturore dhe simbolike.

Në këtë prizëm, vepra e Statovcit mund të lexohet si një ndërhyrje kritike në diskursin e letërsisë së migracionit, duke e zhvendosur fokusin nga narrativat lineare të integritetit drejt një kuptimi më kompleks të identitetit si proces i vazhdueshëm negociimi. Ajo shërben njëherazi si pikëtakimi për disa nga teoritë më të rëndësishme mbi migrimin, por edhe si kritikë ndaj kufijve që secila prej tyre mbart në vetvete.

Koncepti i “in-betweenness” – “të qenit diku në mes” i Homi K. Bhabha-s<sup>7</sup> bazohet në idenë se identiteti migrator formohet në një hapësirë të ndërmjetme,

6 STATOVCI, P., (2018), *My Cat Yugoslavia*, London: Pushkin Press, f.31-35.

7 BHABHA, H., K. (1994), *The Location of Culture*, London: Routledge, f.7.

e cila lejon mundësinë e rikonfigurimit kulturor. Megjithatë, kjo mundësi në romanin e Statovciit “Macja ime, Jugosllavia” kthehet në mundim të pafund, për shkak se Bekimi, personazhi kryesor i romanit, e përjeton hapësirën e ndërmjetme si një gjendje pasigurie dhe fragmentimi të tejzgjatur. Dimensionin e traumës së trashëguar, i cili mund të kuptohet përmes konceptit të “postmemory” (postkujtesa) të Marianne Hirsch-it, e përforcon këtë gjendje pa zgjidhje: përvoja e Emines, nënës së Bekimit, nuk mbetet në të kaluarën, por vazhdon të strukturojë vetëdijen e Bekimit, duke e kthyer identitetin në produkt të kujtesës së trashëguar dhe jo të zgjedhjes së lirë.

Ndryshe nga shumë histori tradicionale të migracionit, Statovci nuk ndjek rrugëtimin nga largimi te integrimi. Në vend të kësaj, romani e ndan përvojën e migrimit në dy kohë dhe dy personazhe: Bekimin, student filozofie homoseksual nga Kosova që jeton në Finlandë, dhe nënën e tij, Eminenë, historia e së cilës fillon në Kosovë dhe vazhdon në Finlandë. Duke vendosur përballë jetën e Eminesë, ku gjithçka ka shkuar keq: dhuna patriarkale, martesë e detyruar dhe mërgimi me përvojën e Bekimit që shenjohej tërësisht nga ksenofobia dhe izolimi homoseksual, Statovci e paraqet migrimin si një traumë që kalon nga një brez te tjetri. Për të migrimi nuk është thjesht zhvendosje, por një krisje e brendshme që trashëgohet dhe ripërsëritet në formë të ndryshuar, pa u zhdukur kurrë.<sup>8</sup>

Nëse historia e Bekimit tregon vështirësinë e ndjenjës së përkatësisë, historia e Emines e përforcon më tej dimensionin e ndërbreznor të migrimit. Martesa e saj e detyruar në Kosovë, sjellja autoritare e bashkëshortit dhe mungesa e lirisë janë karakteristike për familjet patriarkale shqiptare. Zhvendosja në Finlandë jo domosdoshmërisht shoqërohet me zhdukjen e këtyre strukturave, pasi ato vazhdojnë të ekzistojnë si kujtime, zakone dhe pritshmëri që ndikojnë mënyrën si personazhi edukon fëmijët dhe ndërvepron me shoqërinë e re.

Emine mishëron atë që Marianne Hirsch e quan “postmemory” (postkujtesa), pra mënyra se si trauma kalon te brezi i ardhshëm jo përmes përvojës direkte, por përmes peshës së heshtur të historive dhe emocioneve të trashëguara. Heshtja e saj bëhet trashëgimia e Bekimit. Ai e ndjen këtë në bisedat e paplota, në të pathënat e historisë familjare dhe në rregullat e nënkuptuara që i kushtëzojnë jetën.

Kujtesa njerëzore dhe mënyra e funksionimit të saj trajtohet në roman edhe në një dritë tjetër. Historia e Eminesë tregon se heshtjet që imponohen nga lufta, patriarkati dhe migrimi shërbejnë si një mekanizëm mbrojtjeje dhe harrese. Jeta në Kosovë formësohet nga konceptet e *marres* dhe *nderit*, kode të kulturës shqiptare që diktojnë sjelljen dhe shpesh e detyrojnë individin të heshtë. Në

8 STATOVCI, P., (2018), *My Cat Yugoslavia*, London: Pushkin Press, f.57.

Finlandë, heshtja për të bëhet njëherazi mënyrë mbijetese dhe barrë. Bekimi e trashëgon këtë heshtje; paaftësia e tij për të shprehur ndjenjat dhe për të gjetur përkatësi lidhet si me natyrën e tërhequr të nënës së tij, ashtu edhe me ftohtësinë e shoqërisë finlandeze. Kujtesa këtu nuk transmetohet përmes rrëfimeve të qarta, por përmes heshtjes, frikës dhe turpit të brendësuar.

Përmes këtij rrëfimi të dyfishtë, romani tregon se mërgimi nuk është vetëm zhvendosje fizike, por edhe një thyerje e brendshme psikologjike. Homoseksualiteti i Bekimit e bën atë të përjetojë një izolim të dyfishtë: ai ndihet i huaj në Finlandë për shkak të prejardhjes dhe pamundësisë për t'u ndjerë pjesë e asaj bote. Po ashtu edhe ndaj kulturës shqiptare përjeton të njëjtën ndjesi largësie dhe ftohtësie, edhe për shkak të homoseksualitetit të papranueshëm për shoqëritë e mbyllura.

Nga ana tjetër, heshtja e Emines tregon se trauma nuk mund të shprehet gjithmonë me fjalë, por shpesh kalon si një trashëgimi e heshtur duke dëshmuar se migrimi nuk është një përvojë unike dhe e fundme, por një proces i ndërlikuar që zhvillohet përmes dhe përtej kulturave, brezave dhe dëshirave.

### **Midis gjuhës dhe trupit: papërkthyeshmëria dhe tjetërsimi i dyfishtë**

Identiteti i dyfishtë gjuhësor reflekton pamundësinë e personazhit për të jetuar në një realitet të vetëm duke konfirmuar atë që studiuesja Emily Apter e ka emërtuar si “Koncepti i papërkthyeshmërisë”. Sipas saj përkthimi nuk është kurrë një proces neutral; ai gjithmonë përfshin humbje, shtrembërim dhe, në disa raste, pamundësi të plotë për të transferuar kuptime kulturore nga një kontekst në tjetrin. Në këtë kuptim, ajo që mbetet e papërkthyeshme nuk është një dështim i gjuhës, por një tregues i dallimeve të thella kulturore.<sup>9</sup>

Kjo ide bëhet veçanërisht e dukshme në romanin e Statovcit përmes përdorimit të koncepteve shqiptare si *marrë*, *nderi* dhe *besa* të cilat autori i lë në gjuhën shqipe dhe që mbeten të papërkthyer edhe në përkthimin e romanit në gjuhën angleze. Kjo sepse konceptet e mësipërme nuk funksionojnë thjesht si elemente gjuhësore, por si struktura etike dhe sociale që diktojnë vetëdijen e personazheve. Edhe në kontekstin finlandez, këto koncepte nuk zhduken dhe as nuk përkthehen plotësisht; ato vazhdojnë të veprojnë si mbetje kulturore që i rezistojnë integritetit. Mbeten përcaktuese në historinë e Eminesë dhe ndikojnë vendimet, heshtjen dhe mënyrën si ajo përballon jetën. Për Bekimin, këto koncepte bëhen shpesh shtypëse, sepse lidhen me një kulturë që e përcakton, por edhe e përjashton. Veçanërisht ndjenja e turpit (*marrë*) është shumë e pranishme në roman: Emine ndjen turp për martesën e detyruar, për dhunën që përjeton dhe për pamundësinë për të përmbushur pritshmëritë, ndjesi të cilën nuk e largon as

9 APTER, E., (2013), *Against World Literature*, London: Verso, f. 12.

zhvendosja në Finlandë.<sup>10</sup>

Bekimi e trashëgon këtë turp, por ai lidhet kryesisht me identitetin seksual. Homoseksualiteti shihet si diçka e papranueshme në komunitetin shqiptar, duke e bërë atë të ndihet i përjashtuar si nga familja, ashtu edhe nga kultura e tij.

Tema e heshtjes është gjithashtu qendrore. Heshtja e Emines nuk është thjesht mungesë fjalësh, por një mënyrë për të mbijetuar në një botë të dhunshme. Megjithatë, kjo heshtje kalon te Bekimi si një barrë. Ai e ka të vështirë të shprehë veten dhe të kuptojë vendin e tij në botë. Kjo lidhet edhe me heshtjet më të gjera të migrimit, me traumat që nuk tregohen dhe dhimbjet që mbeten të pashprehura.

Përmes këtyre detajeve, romani tregon se asimilimi i plotë është pothuajse i pamundur. Edhe kur personazhet mësojnë gjuhën dhe përshtaten me jetën e re, identiteti i tyre i mëparshëm vazhdon të ekzistojë. Migrimi rezulton të mos jetë zëvendësim i një identiteti me një tjetër, por bashkëjetesë e vështirë mes tyre.

Megjithatë, Statovci nuk e përdor papërkthyeshmërinë vetëm për të theksuar dallimet kulturore mes Kosovës, Ballkanit dhe Evropës të cilat e bëjnë të pamundur për njeriun të përjetojë ndjenjën e përkatësisë ndaj një vendi apo kulture. Ai e radikalizon këtë koncept duke treguar se ajo që nuk përkthehet nuk është vetëm gjuha, por vetë përvoja e migrimit. Bekimi nuk e arrin ndjesinë e përkatësisë jo sepse nuk zotëron gjuhën apo normat sociale, por sepse përvoja e tij, e diktuar nga trauma, historia dhe seksualiteti nuk mund të përkthehet në kategoritë e shoqërisë pritëse.

Në këtë mënyrë, romani hedh poshtë idenë se njohja e gjuhës apo kulturës pritëse çon domosdoshmërisht në përkatësi. Përkundrazi në roman del qartë se një pjesë e përvojës i reziston çdo forme përkthimi. Kjo e zhvendos argumentin e Apter-it nga niveli gjuhësor në një nivel ekzistencial: papërkthyeshmëria nuk është vetëm një problem i tekstit, por një kusht për mbijetësen identitare të personazhit.

### **Alegoria e përjashtimit dhe dështimi i asimilimit**

Romani nuk është thjesht një rrëfim autobiografik për zhvendosjen, por një histori e ndërlikuar që përzien alegorinë, surrealizmin dhe realizmin psikologjik për të shprehur përvojën e fragmentuar të mërgimit. Ai trajton mënyrën se si individët përballen me kodet kulturore, seksualitetin, kujtesën dhe heshtjen nëpër hapësira të ndryshme të traumës dhe përkatësisë.

Që në fillim, migrimi paraqitet si ndjesi e të qenit i huaj. Bekimi mban një piron në apartamentin e tij, një krijesë që njëkohësisht e frikëson dhe e qetëson, dhe më vonë ndeshet me një mace që flet dhe që sillet në mënyrë mizore. Këto

10 STATOVCI, P., (2018), *My Cat Jugoslavia*, London: Pushkin Press, f.48.

figura surrealiste simbolizojnë ksenofobinë, dëshirën e ndaluar dhe armiqësinë që përjetojnë migrantët. Macja e vë vazhdimisht në lojë, duke i kujtuar Bekimit se është i ndryshëm, i huaj dhe i papranueshëm për shkak të dëshirës së tij.<sup>11</sup>

Po aq e rëndësishme është mënyra se si romani trajton homoseksualitetin. Dëshira e Bekimit lidhet ngushtë me përvojën e tij si migrant. Në ambientet që frekuentohen nga homoseksualët në Helsinki ai gjen njëfarë lehtësimi, por gjithashtu përballet me racizëm dhe fetishizim. Pitoni që mban si kafshë shtëpiake simbolizon njëkohësisht frikën dhe dëshirën: një marrëdhënie që është intime, por edhe e rrezikshme. Tërheqja ndaj burrave nuk paraqitet si çlirim, por si një tjetër formë izolimi: ai nuk i përket plotësisht as traditave shqiptare dhe as kulturës homoseskuale finlandeze.

Statovci e lidh kështu homoseksualitetin me mërgimin, duke sugjeruar se të kesh këtë orientim seksual në një kontekst migrimi do të thotë të përjetosh një tjetërsim të dyfishtë. Dashuria bëhet e rrezikshme, intimiteti i pasigurt dhe dëshira e mbushur me frikë refuzimi. Letërsia e migracionit këtu nuk ofron histori të thjeshta çlirimi, por tregon sa e ndërlikuar dhe ambivalente është përvoja homoseksuale në një ambient armiqësor.

Dimensioni alegorik i romanit e thellon këtë ndjenjë. Macja që flet, mizore dhe tallëse, nuk është thjesht një element surreal. Ajo bëhet një simbol i armiqësisë ksenofobe, një figurë që nxjerr në pah pasiguritë e Bekimit dhe e bën edhe më të fortë ndjenjën e përjashtimit. Kur macja e tall, kjo nuk është vetëm një fantazi, por një mënyrë për të treguar se si racizmi dhe homofobia depërtojnë në psikikën e një migranti.<sup>12</sup>

Nga ana tjetër, pitoni i ofron njëfarë ngushëllimi, por gjithmonë i shoqëruar me frikë. Ai është një kujtesë se edhe intimiteti mund të jetë i rrezikshëm. Marrëdhënia e Bekimit me këtë krijesë tregon njëkohësisht mundësitë dhe kufizimet e dëshirës në një botë përjashtuese. Intimiteti është sa real, aq edhe i mbushur me ankth, duke treguar se edhe dashuria mund të ndikohet nga trauma.

Përdorimi i alegorisë e vendos Statovcin në një traditë më të gjerë të letërsisë evropiane të migracionit, ku figura surrealiste apo mitike përdoren për të shprehur përvojën e çuditshme dhe shpesh të frikshme të mërgimit. Megjithatë, vepra e tij është e veçantë, sepse ndërthur kodet kulturore ballkanike me kontekstin nordik, duke krijuar një letërsi që është njëkohësisht personale dhe ndërkombëtare.

Stili surrealist i Statovcit e bën të pamundur një lexim të thjeshtë të romanit si dëshmi apo kritikë sociale. Përkundrazi, romani “Macja ime Jugosllavia” e vendos përvojën e migrimit në një pikë ku ndërthuren miti, kujtesa dhe dëshira. Pitoni dhe macja nuk kanë një kuptim të vetëm: ato janë të paqarta, kontradiktore

11 STATOVCI, P., (2018), *My Cat Jugoslavia*, London: Pushkin Press, f.75-82.

12 STATOVCI, P., (2018), *My Cat Jugoslavia*, London: Pushkin Press, f.75-82.

dhe ndryshojnë, ashtu si vetë përvoja e migrantit.

Duke mos ofruar një përfundim të qartë, Statovci refuzon idenë se historitë e migrimit duhet të përfundojnë me integrim ose kthim në vendlindje. Kjo e vendos atë në një traditë më të gjerë të autorëve evropianë bashkëkohorë, por njëkohësisht e bën zërin e tij unik. Ai sjell një perspektivë të rrënjosur në historinë dhe kulturën shqiptare të Kosovës, ndërkohe që konteksti finlandez i jep këndvështrimin nga shoqëria pritëse, kombinim ky që krijon një letërsi që është njëkohësisht lokale dhe ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, Statovci kontribuon në atë që quhet “letërsi botërore”, jo si një diçka e përgjithshme dhe e pidentitet, por si një shkrim që ruan specifikën kulturore ndërkohë që i përgjigjet çdo lexuesi.

### **Përfundime**

Përfundimi i romanit e thekson këtë gjendje të dyfishtë. Bekimi nuk gjen një zgjidhje të thjeshtë: kthimi në Kosovë nuk e shëron, por as përfshirja në jetën finlandeze nuk e zgjidh ndjenjën e të qenit i huaj. Ai mbetet “në mes”, në një hapësirë të paqëndrueshme, por reale. Statovci sugjeron se kjo gjendje nuk është dështim, por vetë përvoja e migrimit: e fragmentuar, e paqartë dhe e papërfunduar.

Romani *Macja ime Jugosllavia* tregon se mërgimi nuk përjetohet vetëm në nivel gjeografik apo politik, por edhe në nivel të brendshëm: në kujtesë, heshtje dhe dëshirë. Është një histori e mbijetesës mes gjuhëve, kulturave dhe identiteteve.

Në këtë mënyrë, Statovci zgjeron kuptimin e letërsisë së migracionit duke treguar se ajo nuk ka të bëjë vetëm me lëvizjen e njerëzve, por edhe me lëvizjen e kujtesës, traumës dhe identitetit. Vepra e tij na ndihmon të kuptojmë ngarkesat, shpesh të padukshme që mbartin migrantët dhe krijon një letërsi që është njëkohësisht shqiptare, finlandeze, dhe globale.

Në fund, Statovci na fton të rishikojmë vetë idenë e letërsisë së migracionit e cila nuk është thjesht dëshmi personale, por një hapësirë ku diskutohen çështje të mëdha si identiteti, kujtesa dhe përkatësia. Duke ndërthurur alegorinë me realizmin dhe përvojën personale me kontekstin global, romani *Macja ime Jugosllavia* renditet si një nga romanet rëndësishme të migracionit në shekullin XXI.

**BIBLIOGRAFIA**

- AHMED, S., (2000). *Strange Encounters: Embodied Others in Post-Coloniality*. London: Routledge.
- APTER, E., (2013). *Against World Literature: On the Politics of Untranslatability*. London: Verso. (Apter)
- BAUMAN, Z., (2000). *Liquid Modernity*. Cambridge: Polity Press.
- BHABHA, H. K., (1994). *The Location of Culture*. London: Routledge.
- BRAH, A., (1996). *Cartographies of Diaspora: Contesting Identities*. London: Routledge.
- BUTLER, J., (2004). *Undoing Gender*. New York: Routledge.
- COHEN, R., (2008). *Global Diasporas: An Introduction*. 2nd ed. London: Routledge.
- GILROY, P., (1993). *The Black Atlantic: Modernity and Double Consciousness*. London: Verso. (Gilroy)
- HALL, S., (1990). *Cultural Identity and Diaspora*. In: Rutherford, J. (ed.), *Identity: Community, Culture, Difference*. London: Lawrence & Wishart, pp. 222–237. (Hall, “Cultural Identity”)
- HIRSCH, M., (2012). *The Generation of Postmemory: Writing and Visual Culture After the Holocaust*. New York: Columbia University Press.
- LUIBHÉID, E., (2002). *Entry Denied: Controlling Sexuality at the Border*. Minneapolis: University of Minnesota Press. (Luibhéid)

# DIDAKTIKA E PËRKTHIMIT NË SHEKULLIN XXI: KURRIKULA DHE KOMPETENCA NË EPOKËN DIGJITALE

**Doktorante Anna Maria Vasili**

Departamenti i Gjuhës Angleze  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: anna.maria@unitir.edu.al

**Prof. Dr. Viktor Ristani**

Departamenti i Gjuhës Angleze  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: viktor.ristani@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Në shekullin XXI, transformimet teknologjike dhe proceset e globalizimit kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si konceptohet dhe praktikohet përkthimi. Didaktika e përkthimit, si fushë ndërdisiplinore, po përballlet me sfida të reja që lidhen me integrimin e mjeteve teknologjike, kompetencave digjitale dhe dimensioneve etike në trajnim. Ky artikull synon të analizojë evolucionin e kurrikulës së përkthimit dhe të identifikojë kompetencat kyçe që kërkohen në epokën digjitale. Përmes një rishikimi të literaturës dhe analizës krahasimore të qasjeve bashkëkohore vlerësohen modelet më efektive të formimit akademik. Gjetjet sugjerojnë se kurrikula e suksesshme duhet të kombinojë njohuritë teorike, aftësitë praktike, shfrytëzimin e mjeteve të inteligjencës artificiale, si dhe etikën. Artikulli përfundon me rekomandime konkrete për rishikimin e kurrikulave universitare, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të kompetencave ndërkulturore, digjitale dhe bashkëpunuese për përkthyesit e së ardhmes.

Fjalët çelës: didaktika e përkthimit, kompetenca digjitale, kurrikula, inteligjenca artificiale, epoka digjitale

## ABSTRACT

Technological transformations and globalization have created the need for a profound revision of translation curricula in higher education. This article explores the latest challenges and trends in translation didactics, focusing on the competences required by the modern labor market: advanced linguistic and cultural skills, mastery of technological tools (including CAT tools, machine translation, and post-editing), and

interdisciplinary abilities (such as project management, intercultural communication, and ethical and critical skills). The study draws on practices from European and international universities, offering an overview of effective strategies for integrating technology into teaching. It argues that 21st-century didactics must move beyond the traditional model of text translation toward a holistic approach in which translation is understood as a professional, cultural, and technological practice. Ultimately, the article emphasizes the need for flexible and adaptive curricula that prepare future translators to meet the challenges of an ever-changing market.

**Keywords:** didactics of translation, digital competence, curriculum, artificial intelligence, digital era

## 1. Hyrje

Në dekadat e fundit, dinamika e komunikimit ndërkulturor ka marrë një dimension të ri për shkak të zhvillimeve teknologjike, digjitalizimit të informacionit dhe rritjes së kërkesës për shërbime përkthimore sa më të shpejta dhe të sakta. Përkthimi nuk është më vetëm një proces i bazuar në njohjen e dy gjuhëve, por një praktikë komplekse që përfshin përdorimin e mjeteve teknologjike, menaxhimin e burimeve dhe ndërveprimin me platforma globale. Si rrjedhojë, didaktika e përkthimit duhet të reflektojë këto ndryshime, duke ofruar kurrikula të përditësuara dhe kompetenca që i përgjigjen realitetëve të tregut.

Që nga fundi i shekullit të XX-të, studiues të ndryshëm kanë theksuar rëndësinë e kompetencës përkthimore si një konstrukt shumëdimensional që përfshin aftësi gjuhësore, kulturore, teknike dhe strategjike (PACTE Group, 2005). Në kontekstin aktual, kjo kompetencë duhet të rishikohet duke përfshirë aftësitë digjitale dhe njohuritë mbi përdorimin e inteligjencës artificiale dhe mjeteve të përkthimit me ndihmë të kompjuterit (CAT tools) (Rico, 2017). Për më tepër, përfshirja e teknologjive të reja ngre edhe çështje etike, si transparenca e proceseve, e drejta e autorit dhe ndikimi i inteligjencës artificiale në rritjen e aftësisë krijuese të përkthyesit (O'Hagan, 2016).

Qëllimi i këtij artikulli është të shqyrtojë didaktikën e përkthimit në shekullin XXI duke u përqendruar në dy dimensione kryesore: (1) transformimin e kurrikulave universitare në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe (2) përcaktimin e kompetencave dhe aftësive që janë shumë të rëndësishme për përkthyesit në epokën digjitale. Artikulli mbështetet në rishikimin e literaturës së zgjeruar dhe në analizën krahasimore të modeleve pedagogjike të përdorura në kontekste të ndryshme akademike.

## **2. Qasja bibliografike**

### **2.1 Didaktika tradicionale e përkthimit**

Didaktika e përkthimit ka kaluar një proces të gjatë evolucioni. Në modelet tradicionale, fokusi kryesor ishte tek aftësia gjuhësore dhe përkthimi i tekstit i bazuar në teori leksiko-gramatikore. Për shumë vite, programet universitare e trajtonin përkthimin si një aftësi gjuhësore të zgjeruar dhe më pak si një kompetencë shumëdimensionale (Kelly, 2005). Kjo qasje, edhe pse krijoi bazat e formimit akademik, u kritikua për mungesën e përgatitjes praktike të studentëve për tregun real të punës (Király, 2012).

### **2.2 Koncepti i kompetencës përkthimore**

Në vitet 1990–2000, u shfaq koncepti i “kompetencës përkthimore” si një konstrukt kompleks që përfshin njohuritë gjuhësore, kulturore, teknike dhe strategjike. Grupi PACTE (2005) e përkufizoi kompetencën përkthimore si një bashkëveprim të disa nënkompetencave: gjuhësore, ndërkulturore, instrumentale, strategjike dhe psiko-fiziologjike. Ky model shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të ndërtimit të kurrikulave që nuk kufizohen vetëm në aspektin gjuhësor, por zhvillojnë aftësi të plota profesionale.

### **2.3 Teknologjia dhe transformimi i didaktikës së përkthimit**

Me zhvillimin e mjeteve të përkthimit të asistuar nga kompjuteri (CAT tools), bazave të të dhënave terminologjike dhe sistemeve të përkthimit automatik (machine translation, MT), didaktika e përkthimit u përball me nevojën për të përfshirë kompetenca teknologjike. Studimet e Király (2012) dhe Rico (2017) theksojnë se trajnimi i përkthyesve duhet të përfshijë përdorimin e teknologjive bashkëkohore, si dhe zhvillimin e aftësive për të menaxhuar projektet përkthimore në mënyrë bashkëpunuese. Kjo kërkon një ndryshim nga “klasa me mësimdhënie tradicionale” drejt një mësimdhënieje të bazuar në projekte dhe praktikë reale.

### **2.4 Kompetencat digjitale në shekullin XXI**

Sipas European Masters in Translation (EMT, 2017), kompetencat e përkthyesit në shekullin XXI përfshijnë jo vetëm aftësitë gjuhësore dhe ndërkulturore, por edhe:

- kompetencën teknologjike (përdorimi i CAT tools, softuerët terminologjikë, platformat e përkthimit automatik);
- kompetencën menaxheriale (organizimi i projekteve dhe komunikimi me klientët);
- kompetencën digjitale (përdorimi i burimeve online, menaxhimi i të dhënave dhe siguria kibernetike).

Në këtë kontekst, studimet e Pym (2013) dhe O'Hagan (2016) tregojnë se përkthyesit e së ardhmes duhet të trajnohen jo vetëm si përdorues të teknologjisë, por edhe si ndërmjetës kulturorë dhe etikë, të aftë për të vlerësuar kufizimet dhe ndikimet e inteligjencës artificiale.

### **2.5 Inteligjenca artificiale dhe etika në përkthim**

Me futjen e inteligjencës artificiale (AI) në përkthim, roli i përkthyesit po ndryshon nga “prodhues” në “përpunues” i teksteve. Ky realitet ka sjellë diskutime mbi rrezikun e humbjes së aftësisë krijuese, rënien e standardeve profesionale dhe sfidat etike (Kenny, 2017). Përkthyesit duhet të zotërojnë kompetenca që të bëhet e mundur të balancojnë përdorimin e teknologjisë me ruajtjen e cilësisë dhe të të drejtave të autorit.

### **2.6 Tendencat e reja pedagogjike**

Literatura bashkëkohore sugjeron një zhvendosje nga mësimdhënia tradicionale drejt një pedagogjie të orientuar tek studentët, e bazuar në projekte dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve (Király, 2016). Kjo qasje i lejon studentët të punojnë në mjedise që imitojnë realitetin profesional, duke kombinuar aftësitë teorike me praktikën digjitale. Po ashtu, theksohet rëndësia e zhvillimit të kompetencave të buta (soft skills), si puna në grup, komunikimi ndërkulturor dhe aftësia për të mësuar në mënyrë të pavarur (Rico, 2017).

## **3. Metodologjia**

Ky artikull mbështetet në një qasje teorike dhe analitike, duke kombinuar një rishikim të gjerë të literaturës me analizën krahasimore të modeleve didaktike të përkthimit në epokën digjitale. Qëllimi është të nxirren përfundime mbi zhvillimin e kurrikulave dhe kompetencave që janë të domosdoshme për përkthyesit e shekullit XXI.

### **3.1 Lloji i studimit**

Studimi është i natyrës cilësore. Ai mbështetet në:

- analizën e literaturës akademike mbi didaktikën e përkthimit;
- shqyrtimin e raporteve evropiane mbi kompetencat përkthimore (p.sh., EMT framework);
- krahasimin e qasjeve tradicionale dhe bashkëkohore në trajnim.

Ky artikull nuk synon mbledhje të dhënash empirike, por ndërthur dhe sintetizon literaturën ekzistuese për të ndërtuar një kornizë konceptesh mbi didaktikën e përkthimit në epokën digjitale.

### **3.2 Burimet e të dhënave**

Të dhënat janë siguruar kryesisht nga:

- artikuj akademikë të botuar në revista të indeksuara (p.sh. Meta, The Interpreter and Translator Trainer, Babel);
- monografi dhe libra që trajtojnë përkthimin dhe pedagogjinë e tij (O'Hagan, 2016; Kelly, 2005);
- raporte institucionale, si Korniza e Kompetencave të Programit Evropian të Masterit në Përkthim (EMT, 2017).

### 3.3 Korniza teorike

Artikulli mbështetet në tre korniza kryesore:

1. Modeli i kompetencës përkthimore i PACTE Group (2005), i cili ndan kompetencën në disa nënkomponentë;
2. Qasja e pedagogjisë së bazuar në projekte (Kiraly, 2012), e cila sugjeron që mësimdhënia e përkthimit të zhvillohet në kontekste sa më afër praktikës reale;
3. Perspektiva e integritimit të teknologjisë dhe etikës në përkthim (Rico, 2017; O'Hagan, 2016).

Këto korniza ofrojnë bazën për të analizuar se si duhet të ndërtohet kurrikula e përkthimit dhe cilat kompetenca janë më të rëndësishme për epokën digjitale.

### 3.4 Qasja analitike

Metoda analitike e përdorur është analiza krahasimore e literaturës, e cila synon të:

- krahasojë modelet tradicionale dhe digjitale të didaktikës;
- identifikojë boshllëqet mes kërkesave të tregut dhe përmbajtjes së kurrikulës;
- propozojë kompetencat më të rëndësishme për përkthyesit e së ardhmes.

Në këtë mënyrë, metodologjia e studimit synon jo vetëm të ofrojë një panoramë të gjendjes aktuale, por edhe të sugjerojë rrugë të reja për zhvillimin e kurrikulave universitare.

## 4. Rezultatet dhe diskutimi

### 4.1 Kompetencat kyçe për përkthyesit në shekullin XXI

Nga analiza e literaturës rezultojnë se kompetencat e përkthyesit modern nuk mund të kufizohen vetëm në njohuritë gjuhësore. Përkundrazi, ato përfshijnë një paketë të gjerë aftësish që u përgjigjen sfidave të tregut dhe transformimeve teknologjike. Në përputhje me Kornizën e EMT (2017), kompetencat kryesore ndahen në:

- kompetencë gjuhësore dhe ndërkulturore, që mbetet thelbësore për çdo

- përkthyes;
- kompetencë teknologjike, e cila përfshin zotërimin e mjeteve CAT, bazave të të dhënave terminologjike dhe platformave të përkthimit automatik;
  - kompetencë digjitale, që lidhet me aftësinë për të kërkuar burime online, menaxhuar të dhëna dhe siguruar cilësinë e informacionit;
  - kompetencë menaxheriale dhe bashkëpunuese, e cila ka të bëjë me punën në projekte reale dhe komunikimin me klientët në kontekste ndërkombëtare;
  - kompetencë etike dhe kritike, e nevojshme për të marrë vendime mbi përdorimin e inteligjencës artificiale dhe për të garantuar cilësinë e përkthimit.

Këto kompetenca sugjerojnë se formimi i përkthyesve duhet të kombinojë aspektet tradicionale me aftësitë digjitale dhe menaxheriale, duke krijuar një profil të plotë profesional.

#### **4.2 Përmirësimi i kurrikulës universitare**

Analiza e modeleve pedagogjike tregon një zhvendosje graduale nga qasja tradicionale gjuhësore drejt një qasjeje të integruar dhe të bazuar në projekte. Kiraly (2012, 2016) thekson se mësimdhënia e përkthimit duhet të zhvillohet në mjedise që imitojnë praktikën reale të tregut, duke i lejuar studentët të përballen me projekte komplekse, menaxhimin e afateve dhe punën në grup. Në këtë drejtim, disa universitete evropiane tashmë kanë integruar module për redaktim të përkthimit automatik, menaxhim terminologjike, si dhe etikën e përkthimit digjital (Rico, 2017).

Megjithatë, sfida kryesore mbetet përshtatja e kurrikulave tradicionale që shpesh nuk pasqyrojnë realitetin profesional. Siç thekson Pym (2013), ekziston një hendek i qartë mes aftësive që mësohen në universitete dhe atyre që kërkon tregu i punës. Për ta kapërcyer këtë hendek, kurrikulat duhet të ripërditësohen duke kombinuar bazën teorike me praktika të orientuara drejt teknologjisë dhe projekteve reale.

#### **4.3 Roli i inteligjencës artificiale në formimin e përkthyesve**

Përfshirja e inteligjencës artificiale (IA) dhe përkthimit automatik (MT) në procesin e përkthimit ka sjellë ndryshime të mëdha në profesion. Përkthyesit e rinj nuk janë vetëm prodhues tekstesh, por edhe redaktorë dhe menaxherë të përmbajtjes së krijuar nga makina (Kenny, 2017). Kjo nënkupton se formimi i përkthyesve në nivelin universitar duhet të përfshijë krijimin e aftësive për redaktim, si dhe njohuri mbi kufizimet e sistemeve MT. O'Hagan (2016)

argumenton se aftësitë etike dhe të menduarit kritik janë po aq të rëndësishme sa aftësitë teknologjike, pasi përdorimi i IA-së ngre çështje që lidhen me cilësinë, origjinalitetin dhe autorësinë e tekstit.

#### 4.4 Ndikimi i qasjes së mbështetur në projekte

Një nga gjetjet kryesore të analizës është se pedagogjia e bazuar në projekte është më efektive për përgatitjen e përkthyesve modernë. Përmes saj, studentët përfshihen në situata të ngjashme me ato të tregut të punës, ku mësojnë të përdorin mjete teknologjike, të bashkëpunojnë dhe të menaxhojnë afate reale. Studimet e Kiraly (2012) dhe Risku (2016) tregojnë se kjo metodë jo vetëm që zhvillon kompetencat teknike, por gjithashtu nxit aftësitë e buta (soft skills), si komunikimi ndërkulturor dhe puna në grup.

#### 4.5 Diskutim

Nga analiza del qartë se didaktika e përkthimit në shekullin XXI duhet të konceptohet si një ndërthurje e aftësive tradicionale me ato digjitale. Kompetencat gjuhësore dhe ndërkulturore mbeten thelbësore, por nuk janë më të mjaftueshme. Në epokën digjitale, përkthyesi duhet të jetë një profesionist i shumanshëm, i aftë të përdorë teknologjinë, të marrë vendime etike dhe të punojë në mjedise bashkëpunuese.

Kjo kërkon një riformulim të kurrikulave universitare, duke përfshirë:

- module mbi inteligjencën artificiale dhe etikën e saj;
- trajnim në menaxhim projektesh dhe aftësi bashkëpunimi;
- përdorim të gjerë të teknologjisë në mësimdhënie;
- metoda të mbështetura në praktika reale dhe projekte të integruara.

### 5. Përfundime

Analiza e zhvillimeve në didaktikën e përkthimit në shekullin XXI tregon qartë se kurrikula tradicionale, e përqendruar kryesisht në aspektet gjuhësore, nuk është më e mjaftueshme për të përgatitur përkthyesit për tregun global të sotëm. Epoka digjitale ka sjellë transformime të thella që prekin mënyrën se si përkthyesit punojnë, mjetet që ata përdorin dhe pritshmëritë që kanë bashkëpunëtorët.

Gjetjet kryesore mund të përmblihen si më poshtë:

- Kompetencat përkthimore janë zgjeruar duke përfshirë jo vetëm aftësitë gjuhësore dhe ndërkulturore, por edhe kompetenca digjitale, teknologjike, menaxheriale dhe etike.
- Kurrikulat universitare po transformohen drejt një modeli më praktik, ku përdorimi i mjeteve teknologjike, inteligjencës artificiale dhe menaxhimit të projekteve po zënë një vend qendror.

- Pedagogjia e bazuar në projekte është provuar si një nga qasjet më efektive për të afruar procesin e mësimdhënies me realitetin profesional.
- Etika e përkthimit në epokën digjitale është një fushë që kërkon vëmendje të veçantë, pasi përdorimi i inteligjencës artificiale sjell dilema mbi origjinalitetin, autorësinë dhe cilësinë e tekstit.

Në përfundim, didaktika e përkthimit në shekullin XXI duhet të shihet si një fushë dinamike dhe shumëdimensionale, ku aftësitë tradicionale bashkohen me teknologjinë, etikën dhe bashkëpunimin në nivel global. Vetëm në këtë mënyrë përkthyesit e ardhshëm mund të jenë të përgatitur për sfidat e tregut ndërkombëtar dhe për rolin e tyre si ndërmjetës gjuhësorë dhe kulturorë në epokën digjitale.

## BIBLIOGRAFIA

- European Masters in Translation (EMT). (2017). *EMT competence framework 2017*. European Commission, Directorate-General for Translation.
- KELLY, D. (2005). *A handbook for translator trainers: A guide to reflective practice*. St. Jerome Publishing.
- KENNY, D. (2017). Machine translation and translators: A meta-analysis. *Translation Spaces*, 6(1), 1–24.
- KIRALY, D. (2012). Growing a project-based translation pedagogy: A fractal perspective. *Meta: Journal des traducteurs*, 57(1), 82–95.
- KIRALY, D. (2016). Beyond the static competence impasse in translator education. *Trans-Kom*, 9(1), 66–88.
- O'HAGAN, M. (2016). *Massively open translation: Unpacking the potential of crowdsourcing in translation*. Routledge.
- PACTE Group. (2005). Investigating translation competence: Conceptual and methodological issues. *Meta: Journal des traducteurs*, 50(2), 609–619.
- PYM, A. (2013). *Translation skill-sets in a machine-translation age*. *Meta: Journal des traducteurs*, 58(3), 487–503.
- RICO, C. (2017). Training translators in the 21st century: New challenges and opportunities. *The Interpreter and Translator Trainer*, 11(2–3), 167–184.
- RISKU, H. (2016). Translationsmanagement: Interkulturelle Fachkommunikation im Informationszeitalter. In M. Olohan (Ed.), *Scientific and technical translation* (pp. 25–45). Routledge.

# LE RÔLE DU PATRIMOINE CULTUREL DANS LES PROGRAMMES ÉDUCATIFS DU TOURISME

**MSc. Simonyan Narinee**

Département du Tourisme et des Services

Faculté de Communication et service publics, Université d'État V. Brusov

E-mail: narinesimonyan1@gmail.com

## RESUME

Cet article examine les interactions entre le patrimoine culturel et le tourisme dans le contexte de l'enseignement supérieur, en prenant appui sur le cas arménien. Il analyse l'équilibre complexe entre valorisation touristique et sauvegarde authentique, en soulignant l'impact significatif du tourisme sur la construction de l'identité culturelle, la préservation de la diversité et le développement d'une compréhension interculturelle durable.

L'étude évalue le rôle médiateur des professionnels du secteur dans la transmission et la protection active des héritages culturels face aux risques de standardisation et de marchandisation excessive. S'appuyant sur une méthodologie mixte — revue systématique de la littérature et enquête empirique auprès de 80 répondants issus d'institutions culturelles et universitaires arméniennes —, l'article plaide pour l'intégration systématique du patrimoine culturel, tant matériel qu'immatériel, au cœur des cursus universitaires en tourisme.

Une telle approche académique est fondamentale pour former des gestionnaires capables de concevoir des modèles de tourisme culturel économiquement viables, socialement inclusifs et écologiquement responsables, assurant ainsi la pérennité des richesses patrimoniales pour les générations futures.

Mots-clés : tourisme, culture, patrimoine, compétences, formation.

## ABSTRACT

This article examines the relationships between cultural heritage and tourism within the context of higher education, with particular reference to the Armenian case. It explores the delicate balance between the tourism-driven valorization of heritage and the need for its authentic preservation, highlighting the significant role of tourism in shaping cultural identities, safeguarding cultural diversity, and promoting intercultural understanding.

The study assesses the essential mediating role of tourism and heritage professionals in the transmission and active protection of cultural assets in the face of increasing risks

of standardization and excessive commodification. Drawing on a mixed methodology that combines a systematic literature review with an empirical survey of 80 respondents from Armenian cultural institutions and universities, the article argues for the systematic integration of both tangible and intangible heritage into the core curricula of university tourism programs.

Such a curriculum-based approach is presented as fundamental for educating a new generation of professionals capable of designing and managing cultural tourism models that are economically viable, socially inclusive, and environmentally responsible, ensuring the long-term sustainability of heritage assets for future generations.

Keywords: tourism, culture, heritage, competence, education.

## Introduction

La préservation du patrimoine culturel s'impose comme un enjeu stratégique pour les sociétés contemporaines, au croisement des impératifs économiques, identitaires et environnementaux. Les sites et pratiques culturels — qu'ils soient matériels ou immatériels — constituent une ressource centrale pour la diversification de l'offre touristique et la compétitivité des destinations. Selon les résultats du programme de recherche européen CORDIS (2024), le tourisme culturel représente près de 40 % de l'ensemble du tourisme européen, et les touristes culturels dépensent en moyenne 38 % de plus par jour tout en prolongeant leur séjour de 22 % par rapport aux autres catégories de visiteurs. Ces données illustrent la valeur économique considérable que recèle ce segment, mais elles soulèvent également des questions fondamentales quant aux conditions de sa durabilité.

Dans un contexte de mondialisation accélérée, l'articulation entre valorisation touristique et préservation patrimoniale constitue un défi structurel pour les acteurs du secteur. Les récents travaux de l'Organisation mondiale du tourisme (OMT/UNWTO, 2024) et les recommandations de l'UNESCO (2023) convergent pour souligner que ce défi exige une réponse en amont, ancrée dans la formation des professionnels. C'est précisément cette dimension — la préparation académique des futurs acteurs du tourisme culturel — qui fonde la pertinence scientifique et sociale de la présente étude.

Si l'intégration du patrimoine culturel dans les produits touristiques contribue à sa mise en valeur et à la sensibilisation du public aux enjeux de conservation, une gestion inappropriée des flux touristiques peut, à l'inverse, représenter une menace sérieuse pour ces ressources vulnérables. La surpopulation des sites, la commercialisation excessive et la distorsion des identités locales figurent parmi les risques les mieux documentés dans la littérature (Li et al., 2020 ; Safaa et El

Housni, 2025). Face à ces tensions, les professionnels du tourisme occupent une position charnière : formés à reconnaître et à médiatiser la valeur du patrimoine, ils peuvent agir comme un rempart contre sa dégradation.

C'est cette tension productive entre valorisation et préservation qui structure notre démarche analytique. Notre approche repose sur une analyse systémique des interactions entre héritage culturel et tourisme dans le contexte spécifique de l'enseignement supérieur, en prenant appui sur le cas arménien. Nous postulons que l'ancrage patrimonial dans les programmes universitaires de tourisme est susceptible d'améliorer significativement la qualité des formations, de renforcer la sensibilité éthique des futurs spécialistes et de contribuer, en définitive, à une gestion plus durable des ressources patrimoniales.

L'objectif principal de cette étude est de justifier la nécessité d'une telle intégration curriculaire. L'analyse s'articule autour de trois axes complémentaires : (1) les dynamiques entre patrimoine culturel et développement touristique ; (2) le rôle médiateur des professionnels dans sa sauvegarde ; (3) les conditions pédagogiques d'une intégration effective dans les formations universitaires en tourisme.

À partir de ces constats, cette étude s'articule autour de la question de recherche suivante : dans quelle mesure l'intégration systématique du patrimoine culturel — matériel et immatériel — dans les programmes universitaires de tourisme contribue-t-elle au développement de compétences professionnelles durables et éthiquement ancrées ? Cette interrogation nous conduit à examiner conjointement les dynamiques entre ce champ et le tourisme, le rôle médiateur des acteurs du secteur, et les conditions pédagogiques favorables à une telle intégration dans le contexte de l'enseignement supérieur arménien.

### **Méthodologie**

Pour mener cette recherche, une approche méthodologique mixte a été adoptée. Dans un premier temps, une revue systématique de la littérature scientifique récente a été effectuée afin d'établir le cadre théorique des interactions entre tourisme et héritage culturel.

Dans un second temps, une enquête par questionnaire a été administrée en ligne (via Google Forms) entre mars et avril 2025. L'échantillon, d'une taille de 80 répondants, a été sélectionné de manière raisonnée (*échantillonnage raisonné*) selon deux critères principaux :

**Des experts du secteur culturel (n=60)** : employés d'institutions culturelles majeures de l'Arménie connaissant un flux touristique élevé et directement concernés par ces interactions. Les institutions ciblées étaient : le Matenadaran, le Musée d'histoire de l'Arménie, la Galerie nationale d'Arménie, la Réserve-

musée archéologique et historique « Erebuni », le Centre d'art Cafesjian, ainsi qu'une sélection de maisons-musées d'artistes.

**Des enseignants-chercheurs (n=20)** : professeurs du Département du tourisme et des services de l'Université d'État V. Brusov, dont les enseignements abordent explicitement les enjeux du patrimoine. Le questionnaire, composé de questions à choix multiples et de champs ouverts, visait deux objectifs : (a) évaluer le rôle perçu des praticiens du tourisme dans la médiation du patrimoine, et (b) identifier les leviers et obstacles à une meilleure inscription curriculaire de ces enjeux dans les cursus de tourisme. Pour une présentation synthétique et systématique des résultats, les réponses ont été regroupées par thématiques avant d'être visualisées sous forme de graphiques à colonnes.

### **Analyse de la littérature scientifique**

Les études existantes sur les interactions entre le tourisme et le patrimoine culturel abordent ce sujet sous différents angles.

**Le patrimoine culturel, moteur du développement touristique** Le patrimoine culturel constitue l'une des ressources les plus importantes du tourisme (Panzera et al., 2020). Grâce à lui, l'offre touristique se diversifie, créant ainsi des conditions favorables au développement du secteur. Les chercheurs le considèrent comme un vecteur d'autonomisation économique des communautés locales : les habitants prennent conscience de la valeur de la culture de leur destination, s'impliquent davantage dans les activités touristiques et valorisent les formes durables d'organisation de celles-ci (Timothy, 2024).

### **Le patrimoine culturel, fondement de l'identité**

L'UNESCO définit le patrimoine culturel comme l'ensemble des valeurs héritées du passé, avec lesquelles nous vivons aujourd'hui et que nous transmettons aux générations futures. Dans le contexte de la mondialisation, il joue un rôle particulièrement important dans la formation d'une société éduquée et la préservation de l'identité ethnique (Di Giovine, 2018).

Sa connaissance est également essentielle pour la diplomatie culturelle et la communication interculturelle. Sa valorisation et sa préservation sont l'une des garanties de la diversité culturelle mondiale : il est considéré non seulement comme une ressource touristique, mais aussi comme un élément constitutif de l'identité collective (Safaa et El Housni, 2025). Les professionnels du tourisme, en tant qu'« ambassadeurs » de la culture de leur pays, ont un impact direct sur la formation d'une attitude positive envers celle-ci, sur sa popularisation et sur les enjeux de conservation (Timothy, 2024).

### **Valoriser le rôle des professionnels dans le développement du tourisme durable**

Les recherches soulignent également le rôle du patrimoine culturel dans la formation touristique. La connaissance des caractéristiques et des traditions culturelles de différentes régions permet aux praticiens de communiquer efficacement avec des touristes d'horizons culturels divers, et constitue ainsi une compétence professionnelle à part entière.


Face à l'augmentation du nombre de touristes et à l'évolution des attentes des consommateurs, le tourisme durable devient une priorité. Son développement contribue à minimiser les impacts négatifs sur les ressources naturelles et culturelles (Li et al., 2020), à favoriser le développement équilibré des régions, ainsi que les échanges socioculturels et la compréhension mutuelle entre différents groupes culturels (Timothy, 2024 ; Xu et al., 2022).

En définitive, le patrimoine culturel est un élément structurant du développement touristique. Une organisation compétente de leurs interactions constitue un levier essentiel pour répondre aux défis du secteur et renforcer sa durabilité.

### **Résultats. Analyse d'enquête**


Les résultats de l'enquête menée auprès d'organisations culturelles et touristiques confirment que le patrimoine culturel joue un rôle essentiel dans la formation professionnelle des acteurs du tourisme (Figure 1). La grande majorité des répondants (82 %) ont souligné l'importance des connaissances en la matière, et 89 % ont reconnu le rôle actif des praticiens dans sa promotion et sa conservation. Une partie des répondants, tout en souscrivant à ces constats, a précisé dans les champs ouverts que ces enjeux requièrent une réponse plus systémique. Ces données soulignent le caractère transversal de la connaissance patrimoniale dans les activités conjointes des représentants de la culture et du tourisme.

**Fig. 1-Impact de la connaissance du patrimoine culturel sur les activités des professionnels du tourisme**




La deuxième partie de l'enquête, menée auprès de représentants de l'enseignement supérieur, visait à identifier les facteurs nécessaires à l'intégration effective du patrimoine dans les programmes éducatifs (Figure 2). Pour les cours théoriques, les répondants ont identifié les méthodes d'apprentissage interactives et l'analyse de cas comme leviers prioritaires. Pour les volets pratiques, ils ont mis en avant le choix de partenaires institutionnels à vocation patrimoniale. L'utilisation de technologies immersives — intelligence artificielle (IA), réalité augmentée (RA), réalité virtuelle (RV) — et l'organisation d'excursions ont été soulignées comme dispositifs à double portée: théorique et pratique. La coopération de l'université avec des organisations partenaires — qu'il s'agisse d'entreprises touristiques, de musées, de musées-réserves ou de monuments anciens — est apparue comme un facteur d'efficacité déterminant. Parmi les modalités de collaboration efficaces figurent l'organisation d'activités éducatives et culturelles communes ainsi que la promotion de projets de recherche partagés.

**Fig. 2 - Facteurs d'efficacité pédagogique / Efficacité de l'organisation du processus éducatif**



Les obstacles à l'efficacité des cours se structurent différemment selon le type d'enseignement. Pour les cours théoriques, les répondants ont mentionné l'impossibilité d'utiliser les technologies d'innovation et le déficit d'équipement technique des salles. Pour les cours pratiques, ils ont pointé la liste restreinte de sites culturels intégrés aux programmes, ainsi que l'insuffisance de la coopération avec les entreprises de tourisme et les institutions patrimoniales. L'absence de liens structurés entre l'université et le secteur professionnel a également été relevée (Figure 3).

**Fig. 3 - Obstacles à l'efficacité de l'apprentissage**



Ces résultats confirment l'importance centrale du patrimoine culturel dans la formation touristique, tout en révélant des contraintes structurelles qui en freinent la pleine réalisation.

### **Menaces et défis**

Il est fondamental que les futurs professionnels reconnaissent que les activités touristiques peuvent également mettre en péril le patrimoine culturel, notamment par la surpopulation des sites, la commercialisation excessive et la distorsion de l'identité locale. Ces défis doivent être explicitement intégrés dans l'élaboration de stratégies durables de médiation et de sauvegarde patrimoniales au sein des programmes éducatifs, afin de développer chez les étudiants une posture critique et éthiquement responsable.

### **Recommandations pour l'intégration dans les programmes éducatifs**

#### **Augmentation du nombre de cours pratiques**

Les stages en milieu professionnel permettent de développer des compétences ancrées dans la réalité du secteur. Ils renforcent également les liens entre les institutions universitaires et l'industrie, contribuant à la construction de partenariats durables et mutuellement bénéfiques.

#### **Développement de nouvelles orientations curriculaires**

L'intégration de modules dédiés au patrimoine culturel peut stimuler l'émergence de nouvelles perspectives de recherche et de pratique, notamment autour de la gestion des attractions culturelles, de leur intégration dans de nouvelles destinations touristiques, de leur promotion et de leur conservation. Ces orientations constituent également un terreau favorable à des projets de recherche appliquée menés en collaboration avec les institutions patrimoniales.

#### **Transformation numérique de l'enseignement du tourisme**

L'intégration des nouvelles technologies dans le processus éducatif facilite la médiation du patrimoine culturel et favorise un apprentissage plus interactif et efficace. Dans le champ de la pédagogie touristique, des outils tels que la réalité virtuelle (RV), la réalité augmentée (RA) et les plateformes d'apprentissage adaptatives contribuent à créer un environnement éducatif flexible, engageant et accessible. Leur adoption répond aux exigences contemporaines de la formation professionnelle tout en ouvrant de nouvelles perspectives pour l'innovation pédagogique.

## Discussion

Les résultats de cette enquête révèlent un consensus fort parmi les experts quant à l'importance centrale du patrimoine culturel dans la formation touristique. Le taux élevé de réponses positives — 82 % concernant l'importance des connaissances patrimoniales et 89 % quant au rôle actif des praticiens dans la médiation culturelle — vient étayer empiriquement les postulats théoriques de la littérature scientifique. Ces données corroborent notamment les travaux de Timothy (2024) sur la fonction d'« ambassadeur » des professionnels du tourisme, en les ancrant dans un contexte institutionnel précis : celui de grandes institutions culturelles arméniennes directement exposées aux flux touristiques.

Ce consensus de terrain contraste cependant avec les défis structurels mis en évidence par la même enquête. L'identification d'obstacles tels que l'insuffisance des équipements technologiques, la faiblesse des partenariats université-industrie et la liste restreinte de sites culturels intégrés aux cursus renvoie aux tensions analysées par Li et al. (2020) dans leur étude des conflits entre parties prenantes dans les sites du patrimoine mondial : la volonté pédagogique ne suffit pas sans un écosystème institutionnel collaboratif et durablement soutenu.

Par ailleurs, la demande exprimée pour des méthodes d'apprentissage actives — études de cas, technologies immersives, partenariats avec les institutions culturelles — rejoint les préconisations contemporaines d'une pédagogie du tourisme fondée sur l'expérience (Li et al., 2020; Xu et al., 2022). Elle va également dans le sens des réflexions de Safaa et El Housni (2025) sur le patrimoine comme vecteur de dialogue interculturel : former des professionnels capables de le médiatiser exige une immersion pratique, et non une simple transmission théorique de connaissances.

Ces convergences entre résultats empiriques et littérature scientifique permettent de dégager une implication centrale : les programmes universitaires en tourisme doivent évoluer vers un modèle hybride, articulant fondements théoriques rigoureux, mise en situation pratique via des partenariats institutionnels structurés, et exploitation des outils numériques comme dispositifs de médiation patrimoniale. Une telle recomposition curriculaire apparaît comme une condition nécessaire — bien que non suffisante — pour former une nouvelle génération de praticiens aptes à concilier valorisation touristique et préservation durable du patrimoine culturel, en réponse aux impératifs définis par l'OMT (2024).

Sur le plan des implications pratiques, ces résultats interpellent directement les décideurs universitaires et les responsables de politiques culturelles en Arménie. Ils suggèrent que le renforcement des partenariats entre établissements d'enseignement supérieur et institutions patrimoniales — sous forme de conventions pédagogiques, de stages encadrés ou de projets de recherche appliquée — constituerait un levier prioritaire pour combler les lacunes identifiées.

## Conclusion

Cette étude a démontré que le patrimoine culturel — qu’il soit matériel ou immatériel — constitue un pilier fondamental de la formation touristique contemporaine. En définissant le caractère singulier des destinations et en incarnant un socle de valeurs partagées, il représente à la fois une ressource pédagogique indispensable et un enjeu éthique pour les futurs professionnels du secteur. Les résultats de l’enquête menée auprès d’experts culturels et d’enseignants-chercheurs en Arménie confirment la pertinence de cette intégration, tout en révélant des obstacles structurels — technologiques, organisationnels et partenariaux — qui en freinent la pleine réalisation.

En réponse à la question de recherche initiale, il apparaît que l’intégration du patrimoine culturel dans les programmes universitaires de tourisme contribue effectivement au développement de compétences professionnelles durables, à condition qu’elle s’opère dans un cadre pédagogique hybride, ancré dans la pratique et soutenu par des partenariats institutionnels solides. Les praticiens du tourisme, en tant que médiateurs culturels, jouent un rôle irremplaçable dans la transmission et la protection active du patrimoine culturel, face aux risques de standardisation et de marchandisation excessive.

### Limites de l’étude.

Plusieurs limites méritent d’être signalées. D’abord, l’échantillon, bien que raisonné, reste limité à 80 répondants issus d’un seul contexte géographique et institutionnel. Ce choix n’est toutefois pas arbitraire : l’étude se voulant exploratoire et ancrée dans un terrain spécifique (le cas arménien), un échantillon plus large ou comparatif aurait exigé des moyens financiers et logistiques dépassant le cadre de cette recherche. Ainsi, la généralisabilité des résultats à d’autres contextes nationaux ou universitaires n’est pas revendiquée ; l’objectif est plutôt de fournir une analyse approfondie d’un cas exemplaire.

Par ailleurs, l’absence de données désagrégées par sous-groupe (praticiens culturels vs enseignants-chercheurs) limite la portée des comparaisons intergroupes. Cette limitation tient à la taille modeste de l’échantillon des enseignants-chercheurs (n=20), qui ne permettait pas de comparaisons statistiquement robustes.

Le recours exclusif à un questionnaire auto-administré en ligne ne permet pas de saisir la complexité des pratiques pédagogiques effectives. L’étude privilégie ici une approche quantitative large (80 répondants) pour dégager des tendances générales ; des entretiens semi-directifs auraient certes enrichi l’analyse, mais ils auraient réduit le nombre de participants et modifié l’objet de l’étude (passant de

la mesure à la compréhension en profondeur). Ce choix méthodologique est donc délibéré et cohérent avec la question de recherche.

Enfin, l'absence de données longitudinales empêche d'évaluer l'impact réel, dans le temps, d'une intégration renforcée du patrimoine. Une telle approche nécessiterait un suivi de cohortes sur plusieurs années, ce qui excède le temps imparti à cette recherche (réalisation en moins d'un an).

**Perspectives de recherche.** Ces limites ouvrent des pistes fructueuses pour de futures recherches. Il serait notamment pertinent de mener des études comparatives entre plusieurs pays de la francophonie ou du Caucase du Sud afin d'identifier des modèles curriculaires transférables. Des approches qualitatives — entretiens approfondis, observations de terrain — permettraient par ailleurs de mieux cerner les mécanismes concrets par lesquels la formation patrimoniale transforme les pratiques professionnelles. Enfin, le rôle croissant des technologies numériques dans la médiation du patrimoine culturel mériterait une investigation empirique spécifique dans le champ de la pédagogie touristique.

## BIBLIOGRAPHIE

CORDIS, (2024), *Résultats de la recherche de l'UE, Conserver la culture et le patrimoine culturel grâce à un développement inclusif et durable*, [https://publications.europa.eu/resource/cellar/9e481375-02be-11ef-a251-01aa75ed71a1.0001.01/DOC\\_1](https://publications.europa.eu/resource/cellar/9e481375-02be-11ef-a251-01aa75ed71a1.0001.01/DOC_1), consulté le 01 mars 2025.

DI GIOVINE, M., (2018) « Le heritage-scape : origines, éléments théoriques et examen critique d'un modèle de compréhension du Programme du patrimoine mondial de l'UNESCO », *Via Tourism review*, 13, <https://doi.org/10.4000/viatourism.2048>, consulté le 08 mars 2025.

LI, YIPING, L. Chammy, Su, Ping, (2020), « Heritage tourism stakeholder conflict: a case of a world heritage site in China », *Journal of Tourism and Cultural Change*, 18(3), p. 267-287, <https://bit.ly/3zP0lnl>, consulté le 01 avril 2025.

OMT, (2024), *International tourism recovers pre-pandemic levels in 2024*, <https://www.unwto.org/news/international-tourism-recovers-pre-pandemic-levels-in-2024>, consulté le 20 mars 2025.

PANZERA, E., DE GRAAFF, T., DE GROOT, H., (2020), « European cultural heritage and tourism flows: the magnetic role of superstar world heritage sites », *Papers in Regional Science*, 100(1), p. 101-122, <https://re.public.polimi.it/retrieve/39127019-10f6-42cc-9ea4->

25a7dea4560d/11311-1231608\_Panzer.pdf, consulté le 25 mars 2025.

SAFAA, L., et El Housni, Khalid, (2025), « Articuler tourisme et patrimoine : enjeux globaux et résiliences territoriales », *Études caribéennes*, 13,

<http://journals.openedition.org/etudescaribeennes/33930>, consulté le 30 mars 2025.

TIMOTHY, D. J., (2024). « Heritage and Destination Conscience: Empowering Communities and Enhancing Tourism Experiences », In *Destination Conscience: Seeking Meaning and Purpose in the Travel Experience*, p. 51-63, <<https://doi.org/10.1108/978-1-80455-960-420241007>>, consulté le 25 mars 2025.

UNESCO, (2023), *Patrimoine Mondial, Convention pour la Protection du Patrimoine Mondial, Culturel et Naturel*, <https://www.unesco.org/en/world-heritage>, consulté le 10 mars 2025.

UNWTO, (2024), *World Tourism Barometer and Statistical Annex*, January, <https://www.e-unwto.org/doi/epdf/10.18111/wtobarometereng.2024.22.1.1?role=tab>, consulté le 11 mars 2025.

XU, LI, ZHANG, Jie, Nie, Zhenghu, (2022), « Role of Cultural Tendency and Involvement in Heritage Tourism Experience: Developing a Cultural Tourism Tendency--Involvement--Experience (TIE) Model », *Land*, 11(3), 370, <<https://doi.org/10.3390/land11030370>>, consulté le 07 avril 2025

# PRITJA BASHKËKOHORE E VEPRAVE TË PËRKTHYERA NË SHQIP, TË SHKRIMTARIT ITALIAN ITALO CALVINO

**Doktorante Marinela Prifti**  
Departamenti i Gjuhës Italiane  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: marinela.prifti1@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Ky artikull shqyrton pritjen dhe përkthimin e veprave të Italo Calvino në kontekstin kulturor dhe letrar shqiptar nga viti 2011 deri në vitin 2024. Duke u përqendruar në dinamikën e përkthimit si një formë e ndërmjetësimit kulturor, ai analizon se si narrativat metafikzionale dhe alegorike të Calvino janë interpretuar, përshtatur dhe integruar në diskursin letrar shqiptar. Përmes një shqyrtimi të botimeve të përkthyer, eseve kritike dhe studimeve akademike, punimi identifikon sfidat kryesore gjuhësore dhe stilistike me të cilat përballen përkthyesit në interpretimin e sintaksës komplekse, ironisë narrative dhe shtresëzimit semantik të Calvino. Diskutimi gjithashtu i vendos përkthimet brenda transformimit letrar post-komunist të Shqipërisë, ku poetika e Calvino e lehtësisë dhe shumësisë rezonon me vlerat estetike në ndryshim dhe hapjen intelektuale. Duke hartuar si strategjitë tekstuale ashtu edhe pritjen kritike, ky studim thekson përkthimin si një mjet kyç për dialogun ndërkulturor dhe si një akt krijues që ripërcakton universalitetin e Calvino brenda polisistemit letrar shqiptar.

Fjalët çelës: ekuivalencë stilistike, ironi narrative, Italo Calvino, kreativiteti gjuhësor, ndërmjetësim, përkthim, pritje.

## ABSTRACT

This article examines the reception and translation of Italo Calvino's works within the Albanian cultural and literary context between 2011 and 2024. Focusing on translation as a form of cultural mediation, it analyzes how Calvino's metafictional and allegorical narratives have been interpreted, adapted, and integrated into Albanian literary discourse. Drawing on a review of translated editions, critical essays, and academic studies, the paper identifies the principal linguistic and stylistic challenges encountered by translators in rendering Calvino's complex syntax, narrative irony, and layered semantics. The discussion further situates these translations within Albania's post-communist literary transformation, a period in which Calvino's poetics of lightness and multiplicity resonate

with evolving aesthetic values and a growing intellectual openness. By mapping both translation strategies and critical reception, this study highlights translation as a central vehicle for intercultural dialogue and as a creative practice that rearticulates Calvino's universality within the Albanian literary polysystem.

Keywords: Italo Calvino, translation, reception, stylistic equivalence, narrative irony, linguistic creativity, literary mediation.

## Hyrje

Pritja e veprës së Italo Calvino-s në ligjërimin letrar shqiptar është ndikuar thellësisht nga revistat kulturore dhe gazetat, të cilat kanë luajtur një rol vendimtar në shpërndarjen e analizave kritike, informacionit biografik dhe interpretimeve letrare të veprës së tij. Periudha 2011 e deri sot shënon një fazë të rëndësishme në vlerësimin e veprave të Calvino-s në Shqipëri, e karakterizuar nga një rritje e theksuar botimi esesh dhe artikujsh kritikë që shqyrtojnë krijimtarinë e tij nga këndvështrime të ndryshme. Diskursi kritik që rrethon krijimtarinë e Calvino-s ka forcuar pozicionin e tij, duke mundësuar një vlerësim më të thellë të talentit të tij letrar dhe ndikimit të tij të qëndrueshëm në letërsinë bashkëkohore.

Në këtë proces, përkthimi është shndërruar në një hapësirë të rëndësishme ndërmjetëse midis traditës italiane dhe lexuesit shqiptar, ku gjuha përbën një urë dhe një provë njëherazi. Krijimtaria e Calvino-s ka krijuar një laborator gjuhësor e stilistik që ka sfiduar përkthyesit të riprodhojnë ironinë e hollë narrative, kompleksitetin sintaksor dhe shtresëzimet semantike. Përmes këtyre përkthimeve, lexuesi shqiptar është përballur me një estetikë të lehtësisë dhe shumëfishimit, që në njëfarë mënyre pasqyron dinamizmin e vet tranzicional të kulturës sonë letrare pas viteve '90.

Njëkohësisht, rishfaqja e Calvino-s në debatet akademike dhe në platformat kulturore shqiptare dëshmon për një nevojë të re të leximit të autorëve modernë evropianë në një kontekst të pastruar nga ideologjitë përjashtuese. Ai shihet jo vetëm si një shkrimtar i imagjinatës dhe reflektimit metatekstual, por edhe si një simbol i fleksibilitetit kulturor dhe intelektual që kërkon letërsia shqiptare e shekullit të XXI. Ky interes i ri shënon një proces të dytë të "përkthimit": atë të ideve, metodave dhe etikës estetike, përmes të cilit Calvino bëhet pjesë e një dialogu të hapur midis traditës evropiane dhe aspiratave kulturore shqiptare.

2011

Këtë vit, shtëpia botuese "Dituria" botoi të plotë veprën *Leksione amerikane: gjashtë propozime për mijëvjeçarin e ardhshëm*, përkthyer nga Renata Martini, nga origjinali me titull *Italo Calvino: Lezioni americane, The Estate of Italo*

Calvino, 2002. Ky botim përmban esetë *E lehta, Shpejtësia, Saktësia, Dukshmëria dhe Larmia*, bashkë me *Shënimet bibliografike*. Në hyrjen e botimit, nënshkruar nga gruaja e Calvino-s, Esther, parathuhet se botimi është një kopje besnike e daktilografimit të gjetur prej saj në tavolinën e bashkëshortit. Leksioneve të Calvino-s i paraprin riprodhimi i ‘Kronologjisë’ së Mario Barengit dhe Bruno Falsetit, për botimin e *Romane dhe tregime* të Italo Calvino-s në Meridiani, Mondadori, Milano, 1991, ndonëse vetë Calvino-ja, mendonte se për një autor vlejnjë vetëm veprat e tij, prandaj nuk dëshironte të jepte të dhëna biografike. Gjithashtu, botuesit u kujdesën të sillnin edhe bibliografinë me botimet kryesore të Calvino-s, përmes së cilës lexuesit mund të njiheshin me krijimtarinë e plotë të autorit (Calvino, 2011)

Veç botimit të mësipërm, pjesë të *Leksioneve* të Calvino-s, kanë dalë edhe në shtyp. *Toka e premtuar e letërsisë* marrë nga *Leksione amerikane: gjashtë propozime për mijëvjeçarin e ardhshëm* nga Robert Coover, në gazetën “Shqiptare” nr. 5295, 29 maj dhe *Leksione... jo vetëm për amerikanë: Italo Calvino Leksione amerikan, e përgatitur nga Virgjil Muçi*, në revistën “Klan” nr.719, 10 qershor.

2012

Këtë vit, shtëpia botuese “Dudaj”, Tiranë, solli një tjetër vepër të Calvino-s në dispozicion të lexuesve, *Nëse një natë dimri një udhëtar*, përkthyer nga Alban Bobrati, marrë nga origjinali *Se una note d’inverno un viaggiatore*, 2002. Parathënia e romanit, ofron një analizë të thellë të unitetit stilistik të Calvino-s, duke argumentuar idenë e tij pse veprat e tij nuk mund të ndahen në periudha të veçanta. “*Një analizë e tillë nuk qëndron, sepse tek Calvino nuk ka realitet që të mos përshkohet nga fantazia, as fantazi që të mos aludojë për situata të mirëpërcaktuara individuale apo shoqërore: kështu ndodh në çdo vepër të tij, që nga çasti kur ai bindej se atëherë mund ta quante veten shkrimtar*” (Bobrati, 2012). Kopertina e pasme i njeh lexuesit me citime të Calvino-s nga një konferencë shtypi në Buenos Aires në vitin 1984, bashkë me vlerësimet për pritjen globale të romanit dhe nominimet e shumta për çmime. Gjithashtu, premttohej se ky përkthim ruante “*origjinalitetin e stilit, strukturës, shpirtit dhe ideve*” të narrativës postmoderne, duke afirmuar rëndësinë e qëndrueshme të Calvino-s.

Po këtë vit, në shtyp, janë botuar edhe:

*Dua të të dua, duke të shkruar*, gazeta “Shqip” nr.95, 8 prill, përkthyer nga Alda Bardhyli.

*Kopshti magjik dhe Dita e një vëzhguesi zgjedhesh*, përkthyer nga Dritan Çela në gazeta “Shqiptare”, përkatësisht nr.5566, 4 mars dhe nr. 5854, 16 dhjetor.

*Roman në një pikturë*, gazeta “Standard”, nr. 23058, 3 korrik; gazeta “Shekulli” nr. 3717, 29 qershor; revista e poezisë dhe kulturës poetike “POETIKA”, nr.20,

pranverë, me mbështetjen e “Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në kuadrin e projektit ‘STATUS’, përkthyer nga Arian Leka.

*Veprat e Calvino-s sprovë e pafundme krijuese, Italo Calvino. Nëse një natë dimri një udhëtar*, gazeta Mapo, 25 qershor, nr.609, përkthyer nga Alban Bobrati.

Gazeta “Mapo” nr. 662, 20 gusht, nën titullin “Recensë” ka sjellë analizën e Preç Zogaj, *Dedikuar shkrimit dhe leximit ‘Nëse një natë dimri një udhëtar’*, roman nga Italo Calvino, botuar nga Dudaj. Ky artikull, ofroi një shqyrtim të plotë të kompleksitetit të veprës, dhe theksoi qasjen metafiksionale të Calvino-s, duke e përshkruar romanin, si një reflektim mbi aktin e tregimit dhe një kritikë të kufizimeve dhe mundësive letrare. Zogaj përngjasi angazhimin e Calvino-s me Jorge Luis Borges, lidhur me konceptin e ‘librit unik’ që përfshin të gjithë librat. “Si një roman ombrellë i shumë autorëve dhe subjekteve, romani “Nëse një natë dimri një udhëtar” ngjan të jetë produkti perfekt i teorisë së mësipërme të librit unik si shumatore e gjithë librave, parë në profanizimin e Librit të Shenjtë si libër i së vërtetës së zbritur, domethënë të diktuar nga Zoti apo Allahu” (Zogaj, 2012).

*Fjalë të pamjaftueshme për Italo Calvino dhe Pa ju tremb marramendjes dhe erës*, nga Flurans Ilia, mbyllin korpusin e Calvino-s, për këtë vit, botuar nga gazeta “Standard”, nr.2377, nr.2392, 10 dhe 25 shtator,

### 2013

Eksplorimi i jetës dhe punës së Calvino-s vijon edhe këtë vit. Më 28 korrik, gazeta “Shqip”, botoi shkrimin e Alda Bardhyli, *Italo Calvino, pasioni i fshehtë* në të cilin eksploron jetën dhe veprën e Calvino-s. Ajo zbulon marrëdhënien e fshehtë me aktoren Elsa De’ Giorgi dhe se si përvojat e tij personale ushqyen krijimtarinë e tij. Artikulli ofron njohuri bibliografike për ngjarjet më të rëndësishme të jetës së shkrimtarit, të cilat formësuan botëkuptimin dhe shkrimin e tij. Bardhyli shqyrton kontrastin midis privatësisë së Calvino-s dhe pasionit në letrat e tij, duke gjurmuar evolucionin e tij nga neorealizmi në një figurë kyçe të letërsisë italiane, si dhe kompleksitetin e temave filozofike dhe ekzistenciale në veprat e mëvonshme. Në përgjithësi, Calvino-ja portretizohet si një shkrimtar, veprat e të cilit ftojnë reflektim dhe vlerësim të thellë në peizazhin letrar shqiptar (Bardhyli, 2013).

Këtë vit, gazeta “Muzgu” 3 korrik, botoi tregimet *Hëna rend pas hënës* dhe *Eros dhe pavijimësi*, përkthyer nga Rigel Rizaj.

### 2014

Gazeta “Pesëdhjetë e pesë”, nr.186, 233 përkatësisht korrik - gusht, botoi tregimet *Sytë e armiqve*, përkthyer nga Eqrem Basha dhe *Një fshat i pabesë*, përkthyer nga Bujar Doko.

Gazeta “Standard”, nr.3063, 12 gusht botoi tregimin *Gji i zhveshur*, përkthim i Alban Bobratit.

Më 4 nëntor, revista “Class”, në seksionin ‘Kulturë: Libra dhe autorë,’ solli shkrimin e Eni Myrtollarit *Pse duhet të lexojmë Italo Calvino-n?!*, në të cilin konfirmon rëndësinë e leximit të Calvino-s, veçanërisht përmes esesë së tij *Pse duhet të lexojmë klasikët?*. Myrtollari argumentoi se përzjerja unike te Calvino i fantazisë, humorit dhe thellësisë filozofike i fton lexuesit të eksplorojnë tema komplekse. Sipas saj, veprat e Calvino-s, duke përfshirë *Viskonti i përgjysmuar* dhe *Leksione amerikane* ofrojnë një pasqyrim të thellë filozofik dhe thellësi emocionale. Myrtollari i sheh udhëzimet e Calvino-s për shkrimtarët e rinj, si lehtësia, shpejtësia, saktësia dhe shumëllojshmëria thelbësore, për lundrimin në jetë dhe letërsi (Myrtollari, 2014).

2015

Revista “Obelisk” nr.170, botoi *Intervista. Italo Calvino*, përgatitur Adriana Koxha.

Gazeta “Standard” nr.3352, 30 qershor, solli esenë *Roman në një pikturë*, përkthyer nga Arian Leka dhe nr. 3416, 6 tetor, *Pa iu tremb marramendjes dhe erës*, përkthyer nga Flurans Ilia.

Shtëpia botuese “Dudaj”, me ndihmën e “Komisionit Evropian”, botoi trilogjinë *Të parët tanë: Viskonti i përgjysmuar. Baroni rebel. Kalorësi i paqenë, të përkthyer nga Adrian Beshaj nga origjinali I nostri antenati: Il visconte dimezzato, Il barone rampante, Il cavaliere inesistente, 2002. Vepra mbyllet me ‘Shënim 1960’ të vetë Calvino-s, ku shpjegon “Përse i shkrova këto histori? Çfarë doja të thosha? Çfarë kam thënë në fakt? Ç’kuptim ka kjo lloj narrativë në kuadrin e letërsisë së sotme?” (Calvino, *Baroni rebel*, 2015).*

*Mbi përrallën*, është botuar nga “Pika pa sipërfaqe” dhe përkthyer nga Rigel Riza, marrë nga origjinali *Sulla fiaba*, The Estate of Italo Calvino, 2002. Libri vjen me një parathënie nën emërtimin “Paraqitje”, ku botuesit informojnë kronologjinë e botimit të eseve mbi përrallën (Riza, 2015).

2016

Këtë vit, lexuesit shqiptar i ofrohet vetëm eseja *Apolog për ndershmerinë*, postuar më 8 prill, në blogun “Peizazhe të fjalës”. Eseja është përkthyer nga Ardian Vehbiu, nga origjinali *Apologo sull’onestà nel paese dei corrotti*, shkëputur nga *Romanzi e racconti* – volume 3°, *Racconti e apologhi sparsi*, i Meridiani, Arnoldo Mondadori editore, La Repubblica, 15 maj 1980. Në këtë ese, Calvino-ja, ekzaminon një shoqëri, ku ligjet ekzistojnë, por nuk garantojnë drejtësi. Ai nënvizon ndërveprimin kompleks midis korrupsionit dhe integritetit,

me individë të ndershëm që mishërojnë rezistencën e heshtur ndaj paligjshmërisë së përhapur (Vehbiu, 2016)

2017

Më 29 tetor, *Letrat e dashurisë sekrete të Calvino-s* botohen në gazetën “Shqip”, duke sjellë njohuri mbi jetën personale dhe rrugëtimin krijues të Calvino-s. Ndërsa në titull, artikulli lajmëron se në fokus do të ishte një romancë dashurie e tij (me aktoren Elsa De Giorgi), ai gjithashtu eksploroj edhe rrugëtimin më të gjerë biografik dhe krijues të Calvino-s, duke gjurmuar fazat e krijimtarisë së tij nga suksesi i hershëm, deri te format e tij eksperimentale dhe alegorike të tregimit dhe konferencat në SHBA, Cambridge apo Universitetin e Harvardit. “*Nga të gjithë shkrimtarët italianë të pasluftës Italo Calvino është më aventurieri. Ai shkëlqen me brilancën stilistikore të pangatërrueshme*” (Gazeta Shqip, 2017).

2018

Më 21 maj, gazeta “Shqip” publikoi *Këngë sirene për këpucën e Hirushes* nga Rigel Rizaj, një artikull kritik që gërsheton analizën letrare me pikëpamjet filozofike të Calvino-s. Rizaj e portretizoi shkrimtarin, si një studiues dhe artist reflektues, të angazhuar thellësisht me kompleksitetin e strukturave narrative. Artikulli theksoi thellësinë antropologjike dhe filologjike të veprës së Calvino-s, veçanërisht në transkriptimin e përrallave të tij, duke e paraqitur atë, si një ndërveprim kompleks midis saktësisë filologjike dhe lirisë krijuese (Rizaj, 2018).

Ndërkohë, *Përse të lexohen klasikët*, botohet nga “Aleph”, me përkthim të Viola Adhamit nga origjinali *Perché leggere i classici*. Eeve u paraprijnë disa shënime me të dhëna biografike dhe dinamika e krijimtarisë së tij, si dhe një parathënie që njofton se ky është një riprodhim i botimit të parë, më 1991, nga Mondadori, i cili përfshin tridhjetë e pesë shkrime të viteve ’70 dhe ’80 (Adhami, 2018).

Po këtë vit, revista “Aleph”, botoi *Qytetet e padukshme*, gjithashtu nën përkthimin e Viola Adhamit, nga origjinali *Le città invisibili*, shoqëruar nga shënimet e botuesit për shkrimtarin, si dhe një hyrje e këtij të fundit. Romani prezantohet nga një kopertinë interesante që paraqet një ndërveprim intrigues midis ndërtesave të bardha dhe rrjetave ngjyrë kafe, duke simbolizuar temat e ndërlidhjes dhe kompleksitetit. Këta elementë pasqyrojnë qytetet e përshkruara në libër, secili unik, por pjesë e një universi më të madh e të ndërlidhur. Rrathët qiellorë, të lidhur me vija, e theksojnë më tej këtë ide. Sfondi i zi shton ndjenjë misteri, sikur qyteti të zbulohet vetëm pjesërisht, njësoj si qytetet e padukshme të Calvino-s. Ky kaos poetik, përputhet në mënyrë të përkryer me stilin narrativ të Calvino-s, duke ngjallur kuriozitet rreth historive që mbajnë këto ndërtesa (Calvino, 2018).

2019

Më 16 tetor, “ORA News” publikoi artikullin *Italo Calvino, një shikim në informacionin tënd*, që analizonte trilogjinë *Paraardhësit tanë*. Artikulli eksploroj se si Calvino-ja ndërthuri realizmin dhe fantazinë, për të përcjellë dilema morale dhe kritikë sociale. Ai shqyrtoi stilin unik të tregimit të Calvino-s, zhvillimin e personazheve, simbolikën dhe temat filozofike. Analiza i pozicionoi veprat e Calvino-s, si kontribute të rëndësishme në letërsinë botërore, duke sugjeruar se shkrimet e tij shërbejnë, si urë lidhëse midis traditave italiane dhe shqiptare (Ora News, 2019).

2020

Megjithëse *Qytetet e padukshme* janë botuar dy herë nga “Aleph” (2007 dhe 2008), vetëm këtë vit, u shfaq një artikull që analizonte këtë vepër. Më 27 prill, Ardian Vehbiu, në “Peizazhe të fjalës”, në artikullin *Qytete në hapësirë dhe kohë*, eksploroj marrëdhënien komplekse midis qyteteve dhe kujtesës në *Qytetet e padukshme*. Vehbiu shqyrtoi tema të tilla, si: dualiteti i perceptimit, nostalgjia, transformimi dhe vazhdimësia, si dhe simbolika e identitetit urban. Artikulli nënvizoi se si perceptimi ynë për hapësirat urbane është formësuar nga realiteti i tyre aktual dhe kujtesa (Vehbiu, 2020).

Më 19 shtator, gazeta javore letrare dhe kulturore “ExLibris” botoi *Postmodernizmi i Italo Calvino-s*. Ky shkrim i thelluar e pozicionoi Calvino-n, si një figurë udhëheqëse në letërsinë postmoderne, duke nxjerrë në pah aftësinë e tij unike për të ndërthtur formën narrative dhe thellësinë tematike. Artikulli trajtonte identitetin kulturor të Calvino-s, karakteristikat postmoderne, reflektimet filozofike dhe veprat e shquara, si *Baroni rebel*, *Qytetet e padukshme* dhe *Kozmiomika*. Ai e prezantoi Calvino-n, si një produkt të një përzierjeje unike të identitetit kulturor, strategjive novatore, kërkimit filozofik dhe tematikave komplekse (ExLibris, 2020).

2021

Më 14 korrik, gazeta “Koha Jonë” botoi *Letrat sekrete të dashurisë së Calvino-s*, ku shqyrtoheshin letrat e dashurisë së Calvino-s me një qasje biografike dhe letrare-historike. Artikulli përdori 407 letrat, si burime kryesore, për të eksploruar dimensionet personale, emocionale dhe intelektuale të jetës së Calvino-s, veçanërisht duke u fokusuar në romancën e tij sekrete me aktoren Elsa De Giorgi. Ai e lidhi pasionin privat të Calvino-s me personalitetin e tij publik, si një figurë e rëndësishme letrare, duke theksuar se si përvojat e tij personale formësuan imagjinatën e tij letrare dhe proceset krijuese (Koha jonë, 2021).

2023

Ky është viti i 100-vjetorit të Italo Calvino-s dhe botimet dhe vlerësimi i krijimtarisë së tij startuan qysh në janar. Kështu, më datën 6, nën titullin *Tregimi javës / Calvino: Jeta e dy bashkëshortëve*, gazeta “Express” sjell fragment nga tregimi *Jeta e dy bashkëshortëve*, marrë nga botimi i shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1981, të përkthyer nga Shpëtim Çuçka, (Gazeta Express, 2023).

Më 4 mars, “ExLibris” botoi *100 vjet Italo Calvino* nga Xhevair Lleshi. Analiza e gjerë e Lleshit përfaqëson një kulm të angazhimit kritik shqiptar me veprën e Calvino-s. Qasja diakronike e tij gjurmoi evolucionin letrar të Calvino-s nga neorealizmi në postmodernizëm, duke e vendosur veprën e autorit brenda kontekstit më të gjerë të letërsisë dhe kulturës italiane të pasluftës. Paraqitja e tij nxorri në pah një kuptim të thellë të zhvillimit eseistik dhe filozofik të Calvino-s, duke theksuar aftësinë e autorit për të sintetizuar tradita të ndryshme letrare dhe rryma intelektuale. Kritika e Lleshit, ishte veçanërisht e mprehtë në shqyrtimin e mënyrës alegorike të Calvino-s, duke e vendosur atë, si një strategji të sofistikuar narrative që i lejonte autorit të merrej me çështje komplekse socio-politike, duke ruajtur autonominë estetike.” *Alegoria mbush kodrinat dhe malet me rënkim, me terr, ndaj jetës së nënshtruar nga normat shoqërore, por edhe në mendimin e Kalvinos që pikërisht vetmia dhe e pazakonshmja janë ‘kusht’ i jetës së vërtetë*” (Lleshi, 2023). Analiza eksploroj dialektikën midis realizmit dhe fantazisë në veprën e Calvino-s, duke dëshmuar se si ky tension gjeneroi mënyra të reja të shprehjes letrare. Qasja hermeneutike e Lleshit zbuloi natyrën polisemike të teksteve të Calvino-s, duke i pozicionuar ato si vepra që gjenerojnë vazhdimisht kuptime të reja nëpërmjet angazhimit të tyre me lexuesit dhe kritikët.

Më 10 prill, revista “Hejza”, në seksionin ‘Fjala e shkrimtarit’, botoi esenë *Një epokë të ndërmjetme*. Eseja nuk shoqërohej me ndonjë shënim apo koment dhe as me emrin e përkthyesit.

Më 7 shtator, biblioteka dhe shtëpia botuese “Shtëpia e librit” në Blogun e saj postoi *Italo Calvino, mjeshtër i fantazisë alegorike* nga Liu. Kjo analizë e detajuar gjurmoi evolucionin e Calvino-s si shkrimar, kontributet e tij të rëndësishme në letërsi dhe trashëgiminë e tij. Artikulli eksploroj romanet e hershme të Calvino-s, kalimin e tij në fantazi dhe alegori, si dhe strukturat novatore në veprat e mëvonshme. Ai theksoi përzierjen mjeshtërore të alegorisë dhe fantazisë së Calvino-s, e cila i fton lexuesit të eksplorojnë tema komplekse, duke shijuar pasigurinë e imagjinatës (Shtëpia e librit, 2023).

2024

Beti Njuma, në “ObserverKult”, më 27 shtator solli *Italo Calvino: Jam një romantik për të qarë hallin, e pranoj* marrë nga vëllimi me tregime *Dashuritë e*

*vështira*, ku shkrimtari rrëfen për historitë e një çifti që nuk takohet, por dhe për dashurinë e mungesën.

E dhëna e fundit që mbyll këtë kronologji të botimit dhe vlerësimit të krijimtarisë së Italo Calvino-s në Shqipëri është arkivi i Brenton Kotorrit, në faqen e tij të internetit, në të cilin ruhet një koment për *Qytetet e padukshme*. Autori pohonte largimin e romanit nga realizmi socialist dhe theksonte rezonancën e tij në kritikën shqiptare. Kotorri nënvizonte se si vepra e Calvino-s sfidon konvencionet tradicionale narrative, duke përdorur thellësi filozofike dhe simbolike, për të eksploruar temat e perceptimit, kujtesës dhe kohës. Ai, gjithashtu, e vlerësoi romanin *Qytetet e padukshme*, si një mjet të vlefshëm për të reflektuar mbi përvojat personale dhe kolektive në peizazhin kulturor në zhvillim të Shqipërisë (Kotorri, n.d.).

Nga sa pamë, periudha 2011-2024 shënon një fazë të gjallë dhe transformuese në pritjen e veprave të Italo Calvino-s në Shqipëri. Këto vite kanë dëshmuar një rritje të angazhimit kritik, me ese dhe analiza të shumta që pasurojnë diskursin rreth krijimtarisë së tij. Revistat kulturore dhe gazetat me promovimin e rrëfimeve të larmishme të Calvino-s, u kanë mundësuar lexuesve të vlerësojnë thellësinë e tij filozofike dhe teknikat novatore të rrëfimit. Ndërsa studiuesit dhe kritikët vijnë të eksplorojnë kontributet e Calvino-s, trashëgimia e tij është vendosur fort brenda peizazhit letrar bashkëkohor, duke reflektuar një njohje në rritje të rëndësisë së tij në formësimin e mendimit dhe krijimtarisë moderne.

Zgjerimi i horizonteve në tranzicionin postkomunist

Rënia e regjimit komunist në Shqipëri, në fillim të viteve 1990, solli një epokë të re të lirisë intelektuale dhe kulturore, duke ndikuar ndjeshëm në pritjen dhe interpretimin e veprave letrare të Italo Calvino-s brenda vendit. Ndërsa barrierat ndaj letërsisë së huaj u çmontuan gradualisht, lexuesit dhe studiuesit shqiptarë fituan qasje në një gamë më të gjerë të shkrimeve kryesore të Calvino-s, duke përfshirë vepra të mirënjohura si *Qytetet e padukshme* dhe *Nëse në një natë dimri një udhëtar*.

Riinterpretimi dhe ripozicionimi i këtyre rrëfimeve brenda peizazhit kulturor dhe intelektual në ndryshim të Shqipërisë postkomuniste, ishte një proces i thellë dhe i shumëanshëm. Kritikët iu qasën shkrimeve të Calvino-s të lirë nga kufizimet e realizmit socialist, duke i lejuar ata të përfshiheshin me elementët më të thellë filozofikë, metafiksionalë dhe postmodernë që më parë ishin errësuar ose marginalizuar.

Për shembull, strukturat komplekse dhe dimensionet alegorike të romanit *Qytetet e padukshme*, konvergjuan fuqishëm me intelektualët shqiptarë që po përballëshin vetë me tranzicionin e vendit nga kontrolli autoritar në hapjen

demokratike. Studiuesit analizuan eksplorimin e Calvino-s për kujtesën, identitetin dhe natyrën e fluide të hapësirave urbane, si metafora për transformimet e thella shoqërore në Shqipëri. Në mënyrë të ngjashme, eksperimentimi postmodern dhe elementët metafiksionalë të romanit *Nëse në një natë dimri një udhëtar* zbuluan para lexuesve dhe kritikëve shqiptarë narrativën e fragmentuar të Calvino-s dhe vënien në pyetje të rregullave të tregimit, si një pasqyrim i përpjekjeve të shqiptarëve për të ripërcaktuar kulturën dhe identitetin e tyre letrar pas komunizmit.

Rikontekstualizimi i këtyre veprave brenda ligjërimit intelektual shqiptar çoi, gjithashtu, në një rivlerësim të trashëgimisë së tij letrare më të gjerë. Kritikët e pozicionuan autorin si pionier të letërsisë postmoderne dhe avangarde, duke theksuar se si teknikat e tij novatore narrative dhe eksplorimet filozofike parashikuan dhe ndikuan në zhvillimin e shkrimit bashkëkohor shqiptar.

Kjo analizë e narrativës së Calvino-s, gjatë epokës postkomuniste, shënoi një largim domethënës nga interpretimet e kufizuara dhe ideologjike të dekadave të mëparshme. Lexuesit dhe studiuesit shqiptarë tani u fuqizuan të eksploronin kompleksitetin e shumëanshëm të talentit letrar të Calvino-s, duke e pozicionuar atë, si një bashkëbisedues jetik në peizazhin kulturor dhe intelektual shqiptar në zhvillim.

### **Përfundime**

Studimi mbi veprat e përkthyer të Italo Calvino-s në gjuhën shqipe thekson rolin thelbësor të përkthimit si urë lidhëse ndërmjet sistemeve letrare dhe ndjeshmërive kulturore. Përkthimet e veprave kryesore si: *Qytetet e padukshme*, *Nëse në një natë dimri një udhëtar* dhe *Gjashtë memo për mijëvjeçarin e ardhshëm* dëshmojnë zhvillimin e strategjive dhe ndërgjegjësimit gjuhësor të përkthyesve shqiptarë në kapjen e saktësisë stilistike, ironisë narrative dhe imagjinatës metafizike të Calvino-s. Çdo version i përkthyer reflekton jo vetëm qëndrimin interpretues të përkthyesit, por edhe transformimin e ligjërimit letrar shqiptar në dialog me postmodernizmin perëndimor. Akti i përkthimit të Calvino-s bëhet një angazhim krijues dhe kritik, duke zbuluar se si gjuha shqipe ndërmjetëson kompleksitetin, ritmin dhe nuancat kulturore. Në fund, këto përkthime pasurojnë fushën letrare shqiptare, duke riafirmuar rolin e përkthyesit si ndërmjetës kulturor dhe duke zgjeruar humanizmin universal të Calvino-s në një hapësirë të re gjuhësore dhe estetike.

**BIBLIOGRAFIA**

- ADHAMI, V. (2018). Parathënie. In I. Calvino, *Përse të lexohen klasikët* (p. 3). Tiranë: Aleph.
- BARDHYLI, A. (2013, korrik 28). *Italo Calvino, Pasioni i fshehtë*. Retrieved from Gazeta Shqip: <https://gazeta-shqip.com/2013/07/28/italo-calvino-pasioni-i-fshehte/calvino-italo-2/>
- BOBRATI, A. (2012). Parathënie. In I. Calvino, *Nëse në një natë dimri një udhëtar...* (pp. 8-11). Tiranë: Dudaj.
- CALVINO, I. (2011). *Leksione amerikane: gjashtë propozime për mijëvjeçarin e ardhshëm*. Tiranë: Dituria.
- CALVINO, I. (2015). *Baroni rebel*. Tiranë: Dudaj.
- CALVINO, I. (2018). *Qytetet e padukshme*. Tiranë: Aleph.
- EXLIBRIS. (2020, shtator 19). *Postmodernizmi i Italo Calvinos, përgatitur nga A.D.* Retrieved from EXLIBRIS: <https://exlibris.al/postmodernizmi-i-italo-calvinos/>
- Gazeta Express. (2023, janar 06). *Calvino: Jeta e dy bashkëshortëve*. Retrieved from Gazeta express: <https://www.gazetaexpress.com/tregimi-javes-calvino-jeta-e-dy-bashkeshorteve/>
- Gazeta Shqip. (2017, tetor 29). *Letrat e fshehta të dashurisë së Calvinos*. Retrieved from Gazeta Shqip: <https://gazeta-shqip.com/ndryshe/letrat-e-fshehta-te-dashurise-se-calvinos/>
- Koha jonë. (2021, korrik 14). *Letrat e fshehta të dashurisë së Calvinos”, 14 korrik 2021*. Retrieved from Gazeta Koha jonë: <https://kohajone.com/lajme/letrat-e-fshehta-te-dashurise-se-calvinos/>
- KOTORRI, B. (n.d.). *Koment mbi ‘Qytetet e padukshme’ nga Italo Calvino*. Retrieved from Brenton Kotorri, Personal Archive: <https://brentonkotorri.com/koment-mbi-qytetet-e-padukshme-nga-italo-calvino/>
- LLESHI, X. (2023). 100 vjet Italo Calvino. *ExLibris*, 21.
- MYRTOLLARI, E. (2014, nëntor 4). *Pse duhet të lexojmë Italo Calvino-n?! .* Retrieved from Revista Class: <https://www.classlifestyle.com/d/84/87/474/perse-duhet-te-lexojme-italo-calvino-n/>
- Ora News. (2019, tetor 16). *Italo Calvino, Pasioni i fshehtë*. Retrieved from Ora News: <https://www.oranews.tv/article/italo-calvino-nje-udhetim-ne-historine-tende>
- RIZA, R. (2015). Paraqitje. In I. Calvino, *Mbi përrallën* (p. 7). Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- RIZAJ, R. (2018, maj 21). *Një këngë sirenash për këpucëzën e Hirushes*. Retrieved from Gazeta Shqip: <https://gazeta-shqip.com/2018/05/21/nje-kenge-sirenash-per-kepucezen-e-hirushes/>
- Shtëpia e librit. (2023, shtator 7). *Italo Calvino, mjeshtri i fantazisë alegorike..* Retrieved from Blogu Shtëpiaelibr.com: <https://www.shtepiaelibr.com/blog/italo->

calvino-mjeshtri-i-fantazise-alegorike/

VEHBUI, A. (2016, prill 8). *Apolog për ndershmërinë*. Retrieved from Peizazhe të fjalës: <https://peizazhe.com/2016/04/08/apologji-per-ndershmerine/>

VEHBUI, A. (2020, prill 27). *Qytete në hapësirë dhe kohë*. Retrieved from Peizazhe të fjalës: <https://peizazhe.com/2020/04/27/qytete-ne-hapesire-dhe-ne-kohe/>

ZOGAJ, P. (2012, gusht 20). *Dedikuar shkrimit dhe leximit 'Nëse një natë dimri një udhëtar', roman nga Italo Calvino, botuar nga "Dudaj"*. Retrieved from Gazeta Mapo, nr. 662: <https://issuu.com/gazetamapo/docs/20gusht>

LEXICAL AND GRAMMATICAL INTERFERENCE:  
A LINGUISTIC PROBLEM ASSESSED  
THROUGH TRANSLATION

**PhD Candidate Ksenja Ferro**

Department of English Language

Faculty of Foreign Languages, University of Tirana

E-mail: ksenja.ferro@unitir.edu.al

**PËRMBLEDHJE**

Përdorimi i përkthimit në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze (MGJA) ka qenë prej kohësh një çështje e debatueshme. Pavarësisht se përkthimi fitoi popullaritet përmes lidhjes që krijoi me Metodën Gramatikë-Përkthim, shekulli XIX shënoi largimin e tij gradual nga kurrikulat e mësimdhënies së gjuhëve. Roli i përkthimit në MGJA mund të përshkruhet si lëkundje lavjerrësi që lëviz nga një skaj në tjetrin. Në të vërtetë, pasi u përdor në mënyrë të tepruar, kjo metodë u zhduk plotësisht nga procesi mësimor.

Megjithatë, ky studim mbron parimin e “mesatares së artë”, i cili në këtë kontekst nënkupton qasje më të ekuilibruar ndaj përdorimit të përkthimit në mësimdhënie, në ato raste kur konsiderohet pedagogjikisht i nevojshëm. Kryesisht, studimi përqendrohet në mënyrën se si përkthimi mund t’i ndihmojë nxënësit të identifikojnë dhe shmangin gabimet e shkaktuara nga interferencat gjuhësore.

Ky studim përqaes tregon se nxënësit shqiptarë që mësojnë anglishten si gjuhë të dytë bëjnë gabime leksikore dhe gramatikore si pasojë e interferencës, gabime këto që shpesh kalojnë pa u vënë re, përveç rasteve kur njohuritë e tyre vlerësohen përmes ushtrimeve të përkthimit. Studimi paraqet gjithashtu qëndrimet e nxënësve ndaj përdorimit të përkthimit si mjet korrigjues për gabimet e vërejtura. Të dhënat janë mbledhur përmes një ushtrimit përkthimi dhe pyetësori. Rezultatet tregojnë si domosdoshmërinë pedagogjike, ashtu dhe preferencën e qartë nga ana e studentëve për integrimin e përkthimit në procesin mësimor, duke sugjeruar se përjashtimi i tij i privon nxënësit nga ky mjet i dobishëm didaktik.

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, gabime nga interferenca, mësimdhënie, përkthim.

**ABSTRACT**

The use of translation in English Language Teaching (ELT) has long been a topic of considerable controversy. Despite the popularity translation gained through its association with the Grammar-Translation Method, the nineteenth century saw its gradual

removal from language teaching curricula. The role of translation in ELT could therefore be described as a pendulum, swinging from one extreme to the other. Indeed, once used excessively, it later disappeared from the teaching process altogether.

However, this study advocates for the principle of the ‘golden mean’, which in this context implies a balanced approach to the use of translation in teaching whenever it is deemed pedagogically necessary. In particular, the study focuses on how translation can help students identify and avoid errors caused by linguistic interference.

This contrastive study reveals that Albanian students learning English as a Second Language (ESL) produce lexical and grammatical interference errors that often remain unnoticed unless their knowledge is assessed through translation exercises. The study also presents students’ attitudes toward the use of translation as a tool for error correction. Data were collected through a translation exercise and a questionnaire. The results indicate both a pedagogical necessity and a clear student preference for the integration into the teaching process, suggesting that its exclusion deprives learners of a helpful instructional tool.

Keywords: Albanian, English, interference errors, teaching, translation

## 1. Introduction

In the context of English Language Teaching (ELT) the use of translation has undergone a drastic shift. Its rapid rise and subsequent decline can largely be attributed to its association with the Grammar-Translation Method, which received considerable criticism due to its repetitive nature.

Sweet (1964, p. 73) provides his insight on the topic by criticizing the excessive reliance on translating artificial sentences that have little chance of occurring in everyday communication. He argues that this tiresome activity cannot produce fruitful results in foreign language learning. Consequently, such arguments contributed to condemning translation and diminishing its perceived value in the teaching process.

However, this is not the only criticism translation has faced. Because translation implies the use of the mother tongue (MT) as a means of navigating the second language, many scholars have viewed it as an obstacle to achieving second language proficiency.

Suffice it to say that almost every Albanian student has been prompted at some point during their English learning experience to ‘think in English’. Inevitably, while striving to achieve language proficiency, students learning ESL are often susceptible to interference errors resulting from the influence that the MT exerts on their thought processes. This influence, which is the main focus of this study, will be referred to as *linguistic interference*.

In fact, the occurrence of interference is not limited to Albanian students; rather, it is a universal experience among bilingual and multilingual speakers. In a study concerning the error analysis of a Swiss German speaker of Greek, Georgiou (2020, p. 120) identifies phonetic, semantic, syntactic and morphological errors, attributing them to rule overgeneralization and first-language (L1) interference in the second language (L2).

For the purposes of this study, two types of interference were examined: lexical and grammatical interference.

Lexical interference, which often manifests as a result of false friends between languages, "...is the source of many errors in translation, as well as common misunderstandings occasioned when a speaker attempts to express him- or herself in a language other than his or her native one – often including those with some competence in the foreign language concerned..." (Chamizo-Domínguez, 2008, p. 1).

Similarly, Gass & Selinker (2008, p. 177) argue that grammatical interference occurs because differences between language systems prompt students to transfer familiar syntactic structures from the native language to the target language (TL).

Therefore, this paper aims to explore the opportunities translation offers for overcoming linguistic interference errors.

In order to achieve this aim, the study poses the following research questions:

1. In which linguistic areas do Albanian students most frequently struggle with interference?
2. How can translation help students avoid linguistic interference?
3. What are Albanian students' attitude toward translation?

## **2. Literature review**

This section provides a juxtaposition of arguments between scholars who view translation as a source of interference and those who view it as a solution.

Newson (1998, p. 64) argues that translation contributes to linguistic interference because it encourages learners to operate in their mother tongue, thereby hindering L2 acquisition. According to Newson, because translation is often perceived as a word-for-word correspondence process, learners may mistakenly assume that absolute equivalence exist between L1 and L2, which can lead to errors.

Similarly, Lee and Van Patten (2003, p. 123) assert that language learning is a process of habit formation. From this perspective, acquiring L2 requires abandoning L1 in the classroom environment, including translation practices, because the habits of the mother tongue would impede the formation L2 habits.

However, it is unrealistic to pretend that the student's MT does not exist.

Henry Widdowson argues that language learners “cannot be immunized against the influence of their own language” and that “language learning (...) is a compound bilingual experience.” (Widdowson, 2003, p. 151)

Concerning grammatical interference, Kavaliauskiene & Kaminskene (2007, p. 135) argue that, instead of viewing translation as an activity that leads to interference, teachers should use it as a means of pointing out areas in which L1 and L2 are similar and areas in which they differ. Petrocchi (2014, p. 101) supports this view by providing examples of the translation exercises she uses in her classes. She notes that ‘Reduce speed now’ is translated into Italian as ‘Rallentare’. She further observes that, instead of three words used in the original source sentence, the target sentence makes use of only one. Petrocchi points out that the urgency in English is conveyed through the emphasis on the adverb ‘now’, whereas in Italian the verb ‘rallentare’ alone suffices to express the urgency of the situation.

Halliday considers the issue of lexical interference when he argues that “one can make positive use of the students’ mother tongue; and in such cases, to neglect it may be to throw away one of the tools best adapted to the task in hand” (Halliday, 2007, p 161). This is especially relevant in the cases of false friends between languages, which can only be clarified through a clear juxtaposition between the foreign word and its equivalent in the MT. This is particularly important during the early stages of language acquisition, especially since relying on context alone may place students in a vulnerable position. The following example illustrates this phenomenon:

“‘Look at the sky, it’s going to rain’ was a textbook sentence accompanied by a picture. Half of my class understood ‘sky’ to be the foreign-language word for the dark cloud in the picture.” (Butzkamm & Caldwell, 2009, p. 76)

This example indicates that students with different levels of proficiency are not always able to rely solely on context, and that doing so may lead to the formation of faulty notions that remain undetected unless they surface in different linguistic contexts where, for instance, ‘cloud’ and ‘sky’ cannot be used interchangeably. The question that arises here is this: if seemingly harmless words can be easily misunderstood as having meanings they do not carry, what implications does this have for false friends, which are even more misleading because of their striking resemblance?

In summary, while some scholars view translation and dependence on the mother tongue as causes of interference, others emphasize their value as remedies against it. However, although this juxtaposition of arguments is highly justifiable, it tends to overlook the heterogeneous nature of classrooms and the way language proficiency levels vary from one student to another.

### **3. Methodology**

The study employs a mixed-methods approach. To explain how translation can help teachers minimize the occurrence of linguistic interference, it is necessary to gain a general understanding of the frequency and types of interference errors produced by Albanian students. With this aim in mind, the study was divided into two distinct stages: the testing phase and the explanatory phase.

#### **3.1 Sample**

The study was conducted at “Qemal Stafa” High School, in Tirana, Albania. The sample consisted of 53 participants from two different classes. Both classes were in their senior year, with 26 and 27 students, respectively. The students were expected to have acquired a B2 level of English. It is important to note that the two selected groups were representative of the classes with the highest academic achievements.

#### **3.2 Instrument**

Data in this study was collected through two instruments: a translation exercise and a questionnaire. The exercise contained 15 sentences to be translated from Albanian into English. Its purpose was to identify interference errors and the reasons underlying their occurrence. During the explanatory phase, a questionnaire was distributed to the students after discussing and correcting the mistakes. The purpose of the questionnaire was to identify the students’ attitudes toward translation.

#### **3.3 Procedure**

Before initiating this stage of the study, the students were asked for their consent and were informed that their responses would remain anonymous in order to avoid causing any feelings of stress or anxiety. Firstly, they were instructed to complete the translation exercise independently within 20 minutes. The explanatory phase was then used to discuss the mistakes and gain insight into the students’ thinking process. Afterwards, a questionnaire was administered, which the students were asked to be complete within 10 minutes.

#### **3.4 Data Analysis**

After the data was collected, the papers were reviewed and the different translation versions provided by the students were identified. Using descriptive statistics, the percentages of correct, incorrect and missing translations were calculated in order to identify errors caused by interference. A similar process was applied to the questionnaire responses to determine whether students held

a positive or negative attitude toward the use of translation exercises in the classroom.

#### 4. Results

This section reports the findings of the data collection procedure. It presents the results of both the translation exercise and the questionnaire.

##### 4.1 The Exercise's Results

Sentence 1: 2 javë nuk janë të mjaftueshme për të bërë projektin.

Correct translation: 1

Incorrect translation: 52

No translation: 0

a) 1 student: 2 weeks is not enough to do the project.

b) 52 students: 2 weeks are not enough to do the project.

Explanatory phase: While in Albanian *2 weeks* is treated as a plural noun, in English, it is treated as singular in meaning because it represents an amount or a unit of time. The students applied the noun properties of the MT to the L2 sentence structure, resulting in incorrect subject-verb agreement.

Sentence 2: Kini vëmendjen, sepse kjo është një situatë kritike.

Correct translation: 41

Incorrect translation: 12

No translation: 0

a) 41 students: Pay attention because this is a critical situation.

b) 12 students: Pay attention because this is a critic situation.

Explanatory phase: The Albanian *kritik* resembles the English *critic* phonetically. Emphasis was placed on the fact that a *critic* is someone who provides commentary (e.g a book critic), whereas *critical* is the adjective required in this sentence in order to describe the urgency of a situation.

Sentence 3: Ai është një djalë shumë i edukuar.

Correct translation: 11

Incorrect translation: 42

No translation: 0

a) 11 students: He is a very well behaved/ well-mannered/ polite/ kind boy.

b) 42 students: He is a very educated boy.

Explanatory phase: The Albanian *i edukuar* resembles the English *educated* in pronunciation. However, *educated* corresponds to the Albanian *i arsimuar*, referring to formal education, whereas *i edukuar* refers to a person with good

behavior and manners.

Sentence 4: Ai po më tregonte rreth gjendjes aktuale në vendlindjen e tij.

Correct translation: 11

Incorrect translation: 40

No translation: 2

a) 11 students: He was telling me about the current situation/state in his hometown.

b) 40 students: He was telling me about the actual situation in his hometown.

Explanatory phase: The Albanian *aktual* is in fact an English borrowing. However, it does not carry the same semantic meaning as the English *actual*. *Actual* is a synonym for *factual*, whereas the Albanian *aktual* corresponds to the English adjective *current*. During the explanatory phase, emphasis was placed on the fact that the students should not be misled by the striking phonetic resemblance of such ‘false friends’.

Sentence 5: I thashë që provimi im shkoi mirë.

Correct translation: 42

Incorrect translation: 11

No translation: 0

a) 42 Students: I told him my exam went well. / I told him I did well on my exam.

b) 11 Students: I told him my exam went good/nice. / I told him I did good on my exam.

Explanatory phase: The Albanian adjective *i mirë* (good) and adverb (*mirë*) differ little in form, being distinguished only by the adjectival article. In this context, it came naturally to students to apply the same simplification in English and opt for the use of the adjective rather than the adverb.

Sentence 6: Në ceremoni ai u dekorua me një medalje.

Correct translation: 8

Incorrect translation: verb pattern: 38; preposition: 35;

No translation: 0

a) 1 student: At the ceremony, he was awarded a medal.

b) 7 students: He was given a medal/ earned a medal at the ceremony.

\*First issue: verb pattern

c) 38 students: He was awarded with a medal.

\*Second issue: preposition use

d) 35 students: In the ceremony, he was awarded a medal.

Explanatory phase: Two issues were identified in this translation.

First, the students were cautioned about the distinction between existent and non-existent verb patterns in English. While *be awarded with something* is acceptable in Albanian, English uses the structure *be awarded something*. Students transferred the Albanian verb pattern of *dekoroj* to its English equivalent *award*.

Second, it was observed that students who wrote *in the ceremony* transferred the Albanian preposition *në*, which is used to indicate events in the context of physical location. This transfer resulted in faulty translations.

Sentence 7: Më dha disa informacione të cilat nuk mund t'i zbuloj.

Correct translation: 11

Incorrect translation: uncountable noun: 24; collocation: 36

No translation: 1

a) 11 Students: He gave me information which I cannot disclose/reveal/share.

\*First issue: uncountable noun

b) 24 students: He gave me informations which I cannot tell you.

\*Second issue: collocation

c) 36 students: He gave me some information which I cannot discover/find out/tell.

Explanatory phase: The Albanian noun *informacion*, although phonetically similar to its English equivalent *information*, does not share the same grammatical properties. Students were cautioned that *informacion* can be treated as a countable noun in Albanian, whereas *information* is an uncountable noun in English. As a result, students transferred the countable properties of the Albanian noun to its English equivalent, producing *informations* instead of *information*.

Secondly, it was observed that the collocation *to disclose information* posed difficulty for students, whose first inclination was to find a word-for-word equivalent for the Albanian *zbuloj*, which in English would be *to discover*.

Sentence 8: Shytat shkaktohen nga një virus.

Correct translation: 3

Incorrect translation: 49

No translation: 1

a) 3 students: Mumps is caused by a virus.

b) 49 students: Mumps are caused by a virus.

Explanatory phase: During the explanatory session, students were cautioned about English words such as mumps, meningitis, measles, which, although the ending in *-s*, usually associated with plural nouns, are in fact treated as singular or uncountable nouns in English. Apart from the overgeneralization of this rule,

the difficulty lies in the fact that the Albanian equivalent *shytat* is a noun used only in its plural form. The transfer from the MT led students to produce faulty subject-verb agreement, as observed in their translations.

Sentence 9: Nuk arritëm të gjenim zgjidhjen e problemit në fjalë.

Correct translation: 6

Incorrect translation: 45

No translation: 2

- a) 6 students: We did not manage to find the solution to said problem. /We didn't find the problem's solution.
- b) 45 students: We could not find the solution of/for the problem.

Explanatory phase: As observed in the translations provided, there was a tendency to produce a word-for-word translation to *zgjidhjen e problemit* as *the solution of the problem*, thus preserving the genitive construction of the source sentence. Although the students simplified the translation based on their MT structure, the appropriate noun-preposition combination in English is *the solution to the problem*.

Sentence 10: I sugjerova atij që të shkojë tek ky restorant.

Correct translation: 1

Incorrect translation: 51

No translation: 1

- a) 1 student: I suggested that he go/ should go to this restaurant.
- b) 48 students: I suggested him to go/going to this restaurant.
- c) 3 students: I suggested that he goes to this restaurant.

Explanatory phase: It was observed that the students applied the verb pattern *suggest + -to infinitive*, an Albanian verb pattern that does not exist in English. The students had never questioned the possibility that the verbs *suggest* and *sugjeroj* form different verb patterns, a misunderstanding likely caused by their phonetic similarities.

Sentence 11: Afër hyrjes së kështjellës është një dyqan suveniresh.

Correct translation: 29

Incorrect translation: 21

No translation: 3

- a) 29 students: There is a souvenir's shop near the castle's entrance.
- b) 21 students: Near the entrance of the castle is a souvenir's shop.

Explanatory phase: The Albanian sentence was intentionally structured to contain mixed word order, which is grammatically acceptable in Albanian.

English, however, tends to follow the fixed subject-verb-object (SVO) order. The students stated that they attempted to adhere to the sentence structure of the source sentence. However, doing so resulted in English sentences in which the ‘dummy’ subject *there* is missing. Although Albanian allows the subject to be omitted in certain contexts, English does not. For the sentence to be grammatically accurate in English, the *there is* construction must be used, as both subject and verb are required.

Sentence 12: Hyra qetësisht në librari.

Correct translation: 3

Incorrect translation: verb pattern: 40; vocabulary: 46

No translation: 2

a) 3 students: I entered the bookshop quietly.

\*First issue: verb pattern

b) 40 students: I entered quietly in the bookshop.

\*Second issue: vocabulary

c) 46 students: I entered the library quietly.

Explanatory phase: First, clarification was needed regarding the words *library* and *librari*, which caused confusion due to their phonetic similarity. Emphasis was placed on the fact that *library* corresponds to the Albanian *bibliotekë* (a place where books are borrowed), whereas *librari* (a place where books are purchased) corresponds to the English *bookshop*.

Second, students were cautioned against transferring Albanian verb patterns into English sentence structure. The pattern *enter in a place*, which exists in Albanian, does not apply in English, where *enter* is directly followed by its object.

Sentence 13: Në tekstin e parë përmendet problemi i bullizmit.

Correct translation: 25

Incorrect translation: 22

No translation: 6

a) 25 students: The first text mentions the problem of bullying. / The problem of bullying is mentioned in the first text.

b) 13 students: In the first text is mentioned the problem of bullying.

c) 9 students: It's shown/ it is talked about the problem of bullying.

Explanatory phase: This sentence, intentionally structured with mixed word order, poses a similar problem to that found in sentence 11. Students attempted to preserve the Albanian word order, but in doing so produced sentences that sound unnatural to native English speakers.

\*Sentence 14: *Kopje e babait – sikur e ka nxjerrë nga hundët.*

Correct translation: 16

Incorrect translation: 24

No translation: 13

a) 16 students: Her father's copy – as if she had been spit out of his mouth/ the apple doesn't fall far from the tree/ like father like son.

b) 24 students: Her father's copy – as if he spit him from his nose.

\*Sentence 15: *Fëmija im është drita e syve të mi.*

Correct translation: 6;

Incorrect translation: 39;

No translation: 8

a) 6 students: My child is the apple of my eye.

b) 39 students: My child is the light of my eyes.

\*Explanatory phase: It was observed that, rather than opting for approximate equivalents, students relied heavily on direct translations in the cases of the idiomatic expressions listed above. However, it is important to note that idioms in English are numerous and learning to understand them and use them appropriately takes time and practice.

#### 4.2 The Predominant Errors

On average, 66% of students displayed cases of lexical interference when translating words such as *kritik*, *i edukuar*, *aktual* and *library* - everyday words considered part of a high school student's vocabulary.

An equally problematic linguistic area is the concept of the uncountable noun. While English grammar distinguishes between countable and uncountable nouns, Albanian does not operate in the same way. This resulted in incorrect subject-verb agreement – an uncountable noun followed by a verb in 1st /2nd /3rd person plural – as demonstrated by an average of 78% incorrect translations. Students were particularly surprised by the fact that *two weeks* is treated as a singular unit in English. The sentence containing this noun phrase was translated correctly by only one student out of 53, which demonstrates a clear gap in knowledge resulting from grammatical interference.

Similarly, an average of 81% of Albanian students struggle with verb patterns. The examples included in the exercise demonstrate that students tend to overuse the to-infinitive, influenced by Albanian structures, and often add unnecessary prepositions after verbs that should be followed directly by an object.

The issue of preposition use is closely related to this problem. Prepositions have always been challenging for Albanian students – approximately 76%

provided incorrect translations. The most common mistake was the overuse of *in* to refer to adverbials of place, a phenomenon that occurs in Albanian but not in English in the same way.


Surprisingly, word order within the sentence posed difficulties for an estimated 41% of students, which is quite significant figure.

In the translation of collocations and idioms, there were average error rates of 68% and 60%, respectively, mainly due to interference and literal translation.

The linguistic area in which little interference was observed was the use of adverbs, with an estimated average of 21%.

The findings of the exercise, as summarized in Figure 1, suggest that Albanian students of English face the greatest difficulties in several linguistic areas: vocabulary, uncountable nouns, verb patterns, and prepositional use.

**Figure 1.** Types and Frequency of Linguistic Interference Errors




**1.3 The Questionnaire’s Results**

The students sampled in this study had started learning English in the third grade, amounting to an estimated ten years of formal education. A striking 88% of students stated that they had also received additional instruction through various private courses. Despite this extensive exposure to the language - which includes


both formal education and exposure through social and mass media - the students were not immune to errors caused by linguistic interference, as indicated by the results in the translation exercise. We believe that a contrastive analysis through the use of translation could help address this issue. Therefore, the questionnaire sought to gather students' insights on the matter.

It was important to understand the students' attitudes toward the exercise used in this study, with particular emphasis on its ability to highlight cases of interference. The results presented in Figure 2 indicate that the translation exercise was beneficial, with 68% of students reporting that they were surprised to have their previously acquired knowledge questioned. In fact, the primary examples mentioned in the open-ended responses involved the translation of false friends (*librari* – library, *actual* – actual, *i edukuar* – educated). When explaining the reasons underlying these incorrect translations, students reported that, due to the strong resemblance between the words, it had never occurred to them that the correct translation might differ from the one they had assumed. In other words, they had simply never questioned their knowledge.

**Figure 2.** Answers to Question 2: Reflection on the use of the translation exercise



It is important to mention that the students showed willingness to have translation integrated in future classes. As presented in Figure 3, 66% of students' responses show that they would like to be periodically assessed through translation exercises.

**Figure 3.** Answers to Question 5: Attitudes on future use of translation

Generally, the findings of the questionnaire suggest a positive attitude toward translation, which challenges its longstanding academic stigma. With regard to linguistic issues caused by interference, students acknowledge the benefits of using translation.

#### 4 Discussions

The results obtained from this study suggest that there is, indeed, a high frequency of linguistic interference errors that persist even until the final year of high school. The areas in which Albanian students experience difficulties are varies, ranging from basic vocabulary to collocations and verb patterns.

The underlying issue is that students are often unaware of what they do not know, “a problem of ignorance”, as claimed by Newmark & Reibel (1968, p. 158). Although the sentences used in the exercise appeared to pose no significant difficulty, this impression proved deceptive.

Therefore, the judicious integration of the MT into the teaching process, together with the careful selection of appropriate translation exercises, can assist English teachers in helping students become aware of and avoid interference errors as much as possible.

It is important to note that although this study advocates the use of translation in ELT, it does not suggest that translation should become the sole pedagogical tool used in the classroom, thereby undermining the importance of students’ direct exposure to the TL. Instead, the study supports a balanced teaching approach - a combination of the monolingual and bilingual approach - which can better address the diverse needs of students.

As indicated by the questionnaire, Albanian students generally display a

positive attitude toward the use of translation in language. In particular, when addressing linguistic issues caused by interference, students recognize translation as a useful learning tool.

### **5.1 Suggestions on the incorporation of translation in the ELT curriculum**

The current state of ELT has largely excluded translation from the teaching curriculum. However, students' performance in this study indicates that it may be time for educators to reconsider the integration of translation into the foreign language teaching process.

Nevertheless, before translation is systematically incorporated into ELT, further research should be conducted to evaluate its pedagogical effectiveness. In order to determine whether translation contributes to improved language acquisition, a useful approach would be to conduct a pilot study in which translation is implemented as one of the teaching tools. The performance of Albanian students in such a class could then be compared with that of students in classes where translation practice is absent, particularly with regard to vocabulary and grammar acquisition.

Additionally, future research should involve larger samples than the one used in this study and should focus on more heterogeneous groups of students. These groups may include students with varying levels of academic achievement, students with different first languages within the same classroom, students with special educational needs, and students from different age groups. Considering these variables is essential in order to determine how translation can effectively address the diverse needs of language learners.

## **6. Conclusions**

The study has emphasized the importance of translation as a means of addressing linguistic interference in English Language Teaching. The use of translation as a complementary pedagogical tool may assist Albanian teachers of English in raising students' awareness of the differences between the native language and the target language.

One of the main challenges of this study was to critically examine the long-standing arguments against the use of translation, arguments often associated with the well-known Italian saying "Traduttore, traditore" ("translator, traitor"). The findings of the present research support the arguments advocating for the pedagogical value of translation, suggesting that it can help mitigate the effects of linguistic interference.

Using translation judiciously in the classroom means employing one of the most precise and unambiguous tools for overcoming the barriers created by

incorrect assumptions and misunderstandings on the part of students. Owing to its transparency and explanatory potential, translation should not be viewed as a traitor, but rather as a valuable ally in the language learning process.

## REFERENCES

- BUTZKAMM, W. and CALDWELL, J. A. W. (2009), *The Bilingual Reform: A Paradigm Shift in Foreign Language Teaching*. Tübingen, Germany: Gunter Narr Verlag, [Online]. Available: <https://doi.org/978-3-8233-6492-4>
- CHAMIZO-DOMÍNGUEZ, P.J. (2012), *Semantics and Pragmatics of False Friends*, 1st ed. New York, NY: Routledge. [Online]. Available: <https://doi.org/10.4324/9780203941775>
- GASS, S. M. and SELINKER, L. (2008), *Second Language Acquisition: An Introductory Course*, 3rd ed. New York, NY: Routledge.
- GEORGIU, G. (2020), "The language errors of a Swiss German speaker of Greek as an L2: A case study," *Athens Journal of Philology*, vol. 7, no. 2, pp. 115–124.
- HALLIDAY, M. A. K., (2007), "Language and education," in *The Collected Works of M. A. K. Halliday*, J. J. Webster, Ed. London, UK: Continuum.
- KAVALIAUSKIENĖ G. and KAMINSKIENĖ, L. (2007), "Translation as a learning tool in English for specific purposes," *Kalbotyra*, vol. 57, pp. 132–139.
- LEE, J. F. and VAN PATTEN, B. (2003), *Making Communicative Language Teaching Happen*, 2nd ed. New York, NY: McGraw-Hill.
- NEWMARK, L. and REIBEL, D. A., (1968), "Necessity and sufficiency in language learning," *IRAL: International Review of Applied Linguistics in Language Teaching*, vol. 6, no. 2, pp. 145–164.
- NEWSON, D. (1998), "Translation and foreign language learning," in *K. Malmkjær (Ed.), Translation and Language Teaching: Language Teaching and Translation*, Manchester, UK: St. Jerome Publishing, pp. 63–68.
- PETROCCHI, V. (2014), "Pedagogic translation vs. translation teaching: A compromise between theory and practice," *Italica*, vol. 91, no. 1, pp. 95–109,
- SWEET, H., (1964), *The Practical Study of Languages: A Guide for Teachers and Learners* (Language and Language Learning Series No. 1). Oxford, UK: Oxford University Press.
- WIDDOWSON, H. G. (2003), *Defining Issues in English Language Teaching*. Oxford, UK: Oxford University Press.

MORALIZMI FETAR DHE PËRJASHTIMI SHOQËROR NË  
ROMANIN *MARTA AJALA* [*L'ESCLUSA*] TË SHKRIMTARIT  
ITALIAN LUIGI PIRANDELLO

**Doktorante Serxha (Kolaj) Gjinaj**

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: serxha.kolaj.fgjhdr@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Pas leximit dhe studimit të romanit *L'esclusa* të Luigi Pirandello-s, bëhet e qartë pse autori e ka titulluar veprën *E përjashtuara*: Marta, protagonistja, refuzohet nga shoqëria në çdo nivel, madje edhe nga institucioni i kishës, i cili teorikisht përfaqëson mëshirën, faljen dhe paqen shpirtërore. Për këtë arsye, ky studim analizon rolin e kishës dhe të rrëfyestores në roman, duke i parë jo thjesht si hapësira fetare, por si mekanizma të kontrollit dhe gjykimit shoqëror. Analiza tregon se institucioni i kishës luan një rol krejt tjetër, atë të hipokrizisë, duke ushqyer dhe legjitimuar paragjykimin kolektiv, dhe duke e shndërruar kishën nga vend shpëtimi në një mjet përjashtimi. Si hapësirë fizike dhe simbolike, ajo nuk shërben vetëm si sfond narrativ, por si një autoritet që ndikon drejtpërdrejt në fatin e individit dhe në izolimin e Martës. Megjithatë, lind një pyetje thelbësore: nëse kisha përfaqëson gjykimin kolektiv dhe përjashtimin, përse Pirandello zgjedh pikërisht kambanat e saj për të artikuluar një thirrje për ndryshim kolektiv?

Fjalët çelës: godina fetare, hipokrizi, paragjykim, përjashtim.

ABSTRACT

After reading and studying the novel *L'esclusa* by Luigi Pirandello, it becomes clear why the author titled the work "*The Outcast*": Marta, the protagonist, is rejected by society at every level, including by the institution of the Church, which theoretically represents mercy, forgiveness, and spiritual peace. For this reason, this study analyzes the role of the Church and the confessional in the novel, considering them not merely as religious spaces, but as mechanisms of social control and judgment. The analysis demonstrates that the Church assumes a markedly different role - that of hypocrisy - by nurturing and legitimizing collective prejudice and by transforming itself from a place of salvation into a tool of exclusion. As both a physical and symbolic space, the Church does not serve merely as a narrative backdrop, but as an authority that directly influences the fate of the individual and reinforces Marta's isolation. However, a fundamental question arises: if the Church represents collective judgment and exclusion, why does Pirandello choose its bells as the medium through which to articulate a call for collective change?

Keywords: religious buildings, hypocrisy, prejudice, exclusion.

## Hyrje

*Marta Ajala*<sup>1</sup> [*L'esclusa*]<sup>2</sup> është romani i parë i autorit italian Luigi Pirandello<sup>3</sup>, i publikuar në 1901. Edhe pse ka më shumë se një shekull, tematika që trajton është mjaft aktuale edhe sot e kësaj dite. Hipokrizia e një shoqërie fanatike dhe paragjykimet në të cilat jeton një grua siçiliane në shekullin XIX, janë elementë që kanë fuqinë të shkatërrojnë jetën e një individi, ky është edhe rasti i Martës. Me shumë mundësi Pirandello mund të jetë ndikuar nga kronika e kohës, pasi në Siçili mund të vrisje të dashurin e gruas për të mbrojtur nderin, dhe kishte rrethana lehtësuese dënimi, pasi tradhtia bashkëshortore konsiderohej një njollë morale dhe shoqërore. Përmes hulumtimeve dhe studimeve të përqendruara tek hapësirat fizike, kryesisht ato fetare, autori i paraqet në roman, jo vetëm si sfond i ngjarjeve, por si elemente thelbësore në përcaktimin e fatit të personazheve si edhe ndikimin që këto institucione kanë pasur në jetën e tyre. Ambientet e ndryshme si: qyteza, kisha, rrëfyestorja, sheshi marrin një funksion simbolik dhe moral, duke reflektuar paragjykimin dhe dhunën e heshtur ndaj individit që devijon nga normat e masës. Përpjekjet e Martës drejt emancipimit profesional dhe moral, në një shoqëri si ajo e Siçilisë në shekullin XIX, të cilat janë thellësisht të prapambetura dhe patriarkale, duket që dështojnë. Ky artikull synon të analizojë rolin e institucioneve fetare në romanin *Marta Ajala*, duke u ndalur veçanërisht tek funksioni i Kishës, rrëfyestores, kambanave të kishës dhe festës fetare në sheshin e kishës. Nëpërmjet këtyre hapësirave Pirandello vë në pah krizën morale të shoqërisë italiane dhe përplasjen mes ndërgjegjes individuale dhe gjykimit kolektiv, duke e shndërruar historinë e Martës në një reflektim mbi dinjitetin, të vërtetën dhe lirinë e njeriut.

## Kriza e besimit në romanin *Marta Ajala*

Botimi i romanit *Marta Ajala* ka kaluar nëpër një kalvar të gjatë krijimi dhe

- 1 Romani është përkthyer në gjuhën shqipe nga Zija Vukaj me titullin: *Marta Ajala* dhe poshtë titullit në kopertinë shkruhet: *Një grua që e ndjen veten të braktisur nga shoqëria në të cilën jeton*, shtëpia botuese ELITE, Tiranë 1999.
- 2 Ngjarja përqendrohet në historinë e Martës, e cila dëbohet nga shtëpia prej bashkëshortit të saj, Roko Pentàgora, nën akuzën për tradhti bashkëshortore, pasi ai gjen një letër të shkruar nga Gregorio Alvignani. Edhe pse Marta nuk ka kryer asnjë akt tradhtie, dënimi ndaj saj është i menjëhershëm dhe unanim: e gjithë bashkësia e shpall fajtores. Përballë stigmatizimit publik dhe rrënimit ekonomik që godet familjen e saj, Marta ruan një qëndrim të palëkundur, duke pohuar me vendosmëri pafajësinë e vet.
- 3 Luigi Pirandello lindi më 28.06.1867 në Agrigento, Itali, dhe vdiq më 10.12.1936 në Romë. Pirandello ishte shkrimtar, dramaturg dhe poet italian. Romani i tij i parë është *Marta Ajala*, i botuar në 1901, por u bë i njohur me romanin *Il fu Mattia Pascal*. Pirandello studioi letërsi në Palermo e Romë dhe u diplomua në Gjermani në vitin 1891.

rishkrimesh të njëpasnjëshme, nga viti 1893 deri më 1927. Fillimisht, Pirandello kishte menduar ta titullonte veprën *L'infedele*, e më pas *Destinati*, por shpejt këto tituj u zëvendësuan me titullin *Marta Ajala*, pasi asnjëri nuk i pëlqente autorit. Përfundimisht, romani u botua me titullin *L'esclusa* në vitin 1901 në gazetën *La Tribuna*. Botimi i dytë u realizua në vitin 1908 nga shtëpia botuese Treves në Milano, ndërsa botimi i tretë, pas nëntëmbëdhjetë vjetësh, u publikua në Firence nga Bemporad. Ajo që bie veçanërisht në sy janë ndryshimet thelbësore në strukturën narrative dhe në trajtimin tematik të veprës ndërmjet botimeve të ndryshme. Për shembull, në edicionin e dytë Pirandello shton elementin e errësirës, të shprehur përmes termit *il buio*, i përdorur me synimin për të pasqyruar “errësirën e ekzistencës”. Ky element kontribuon në forcimin e dimensionit dramatik dhe ekzistencial të romanit, duke zhvendosur theksin narrativ nga ngjarja e jashtme drejt përjetimit të brendshëm të personazheve. Në të njëjtën linjë ndërhyrjesh domethënëse, në edicionin e dytë qëndron edhe mohimi i së drejtës së rrëfimit në kishë për Martën. Këshilla e priftit që ajo të kthehet vetëm pas një pendese më të thellë, duke e larguar Martën pa u rrëfyer, e përjashton atë jo vetëm nga komuniteti shoqëror, por edhe nga hapësira shpirtërore, e cila deri në atë moment përfaqësonte një mundësi shprese dhe shpëtimi. Si pasojë, besimi humbet funksionin e tij si burim ngushëllimi dhe mbështetjeje morale për personazhin. Nuk është rastësi që, në botimet pasuese, autori heq frazën “Zoti nuk dëshironte të hynte tek ajo”, duke zbutur kështu tonin e refuzimit absolut dhe duke rikonfiguruar raportin ndërmjet Martës dhe dimensionit fetar. Me eliminimin e kësaj shprehjeje, Pirandello paraqet një Martë më të vetëdijshme për pafajësinë e saj dhe më të gatshme për të luftuar për drejtësinë që i mohohet. Gjatë pritjes për t’u rrëfyer, Marta analizon gjendjen e saj dhe arrin gradualisht në vetëdijen se nuk ka nevojë për rrëfim, pasi nuk ndjen faj. Vendimi për t’u larguar pa u rrëfyer përbën një akt rebelimi ndaj imponimeve shoqërore dhe fetare, duke vënë në plan të parë temat e kërkimit të identitetit dhe të autonomisë personale. Imazhi i të moshuarës që lutet në kishë simbolizon nevojën universale të njeriut për besim, ndërsa largimi i Martës nga kisha pa u rrëfyer dëshmon distancimin e saj nga ky dimension. Në këtë kontekst, përforcohet zgjedhja e saj për të jetuar pa Zot dhe pa besim, duke e paraqitur personazhin si më të fortë dhe të vendosur për të kapërcyer përjashtimin e saj përmes forcave të veta, e jo përmes ndërmjetësimit fetar. Ky aspekt nënvizon një proces emancipimi moral që lind nga vetëdija dhe rezistenca individuale, si dhe sugjeron një formë të heshtur solidariteti femëror përballë normave shtypëse shoqërore.

### **Topografia e paragjyimit në romanin *Marta Ajala***

Romani *Marta Ajala* zhvillohet në dy ambiente kryesore. Pjesa e parë e romanit vendoset në një qytezë anonime, ndërsa pjesa e dytë në Palermo, i cili përmendet që në fillim të veprës, duke i paraprirë ngjarjeve që do të zhvillohen më vonë. Sa i përket ambientit të pjesës së parë të romanit, është e pamundur të ndiqet një itinerar i saktë hapësinor, pasi autori tregohet i kujdesshëm të mos përmendë jo vetëm emrin e qytetit, por as emrat e godinave të ndryshme, në mënyrë që të shmangë çdo aludim topografik. Megjithatë, është e vështirë të mendohet se Pirandello do ta ambientonte romanin e tij të parë në një vend tjetër përveç Sicilisë, konkretisht në kryeqytetin e saj, Palermo. Kjo lidhet edhe me faktin se kemi të bëjmë me një roman realist, ku ngjarjet dhe hapësirat priren të jenë të besueshme dhe të lidhura ngushtë me realitetin shoqëror të kohës. Siç u përmend më lart, Pirandello shmang çdo tregues të drejtpërdrejtë gjeografik, edhe pse godinat ku zhvillohet ngjarja në pjesën e parë janë jo vetëm të rëndësishme, por thelbësore për rrjedhën narrative. Një shembull domethënës është kisha, një hapësirë fizike që përmendet shpesh në roman dhe që luan një rol vendimtar në procesin e përjashtimit të Martës nga shoqëria. Në parim, kisha duhet të përfaqësojë mëshirën dhe pranimin. Megjithatë, në roman, kisha e percepton Martën si mëkatore dhe kontribuon në stigmatizimin e saj shoqëror, pasi vetë prania e saj në kishë interpretohet si shenjë pendese për një faj të supozuar. Në këtë mënyrë, ambienti fizik nuk paraqitet si një hapësirë reale e identifikueshme, por merr kryesisht një funksion simbolik. Ambientet e hapura përfshijnë rrugën, sheshin dhe qytezën, ndërsa ambientet e mbyllura përfshijnë kishën, rrëfyestoren dhe kolegjin. Paradoksalisht, liria e individit verifikohet vetëm brenda një ambienti të mbyllur, duke përforcuar tensionin ndërmjet kontrollit shoqëror dhe autonomisë personale. Kisha nuk mund të konsiderohet plotësisht si një hapësirë e mëshirës dhe pranimit, pasi janë vetë njerëzit ata që etiketojnë individin si mëkatar ose jo. Vepra paraqet një sfond tipik të letërsisë veriste, ku Pirandello, si gjithmonë, trajton tematika sociale dhe ekzistenciale. Sjellja e individit ndërtohet mbi parimin “çfarë do të mendojnë të tjerët”, ndërsa frika nga skandali dhe paragjykimet shndërrohen në boshtin qendror të jetës shoqërore. Marta përjeton katër përjashtime themelore në jetën e saj, të cilat cenojnë drejtpërdrejt identitetin dhe dinjitetin e individit:

1. Nga familja: i ati i Martës vendos të mos e shohë më Martën deri në vdekje. Nga një baba pritët mbrojtje ndaj armiqësive të botës, por edhe ai rezulton të jetë skllav i paragjykimëve shoqërore.
2. Nga qyteza: e cila, e mbështetur në thashetheme dhe gjykime kolektive, e konsideron Martën fajtoreshë për një tradhti të supozuar.
3. Nga kolegji: pavarësisht se fiton konkursin për mësimdhënie falë

meritave personale, Marta përjashtohet me arsyetimin se një individ me një “njollë morale” nuk mund të edukojë brezin e ri.

4. Nga kisha: frekuentimi i kishës shihet më tepër si një akt pendese publike sesa si shprehje e një besimi të lirë, gjë që e bën Martën të mos kthehet më kurrë aty.

Pas gjithë përjashtimeve që pëson Marta, lind një pyetje thelbësore: si është e mundur që edhe Kisha, institucioni që predikon mëshirë dhe drejtësi, të mos e pranojë atë? Në roman, kisha është mjaft e pranishme dhe fillimisht krijon iluzionin se mund të jetë një vend prehjeje dhe drejtësie për Martën. Megjithatë, kjo shpresë rezulton e rreme, sepse as aty ajo nuk pranohet për atë që është. Përtej figurave familjare, si të nënës dhe motrës, pranë Martës qëndron Ana Veronika, një tjetër grua e marginalizuar, e cila luan një rol të rëndësishëm në afrimin e saj me Kkishën. Me shtysën e Ana Veronikës, pas padrejtësisë që i bëhet, Marta nis ta frekuentojë Kishën me shpresën se do të pranohet pavarësisht akuzave dhe përjashtimit shoqëror. Ajo nuk kërkon falje për një mëkat që nuk e njeh si të tillë, por kërkon njohjen e dinjitetit të saj si individ. Në realitet, frekuentimi i kishës nga Marta interpretohet ndryshe nga komuniteti: *“Njerëzit, tani, duke e parë aty në kishë, të përlurur dhe të gjunjësuar, nuk do të kishin supozuar se ajo e kishte pranuar si të drejtë dënimin dhe se gjunjëszohej para Zotit për të kërkuar ngushëllim dhe strehë, sepse nuk ia njihte më vetes të drejtën për t’u ngritur në këmbë me ballin lart përpara njerëzve?”*<sup>4</sup> Ky fragment tregon qartë se Marta humbet jo vetëm të drejtën për t’u mbrojtur, por edhe mundësinë për të qëndruar “me ballin lart” përpara të tjerëve. Në këtë mënyrë, Kisha shndërrohet në një hapësirë gjykimi, ajo shfaqet si një hapësirë e mbushur me hipokrizi, ku morali shoqëror mbizotëron mbi mëshirën fetare. Janë njerëzit, dhe jo Zoti, ata që vendosin se kush është mëkatar dhe kush jo. Sa i përket hapësirës fizike, mund të thuhet se nuk ekziston asnjë vend që ta pranojë plotësisht Martën.

### Rrëfyestorja

Rolin e vërtetë të ambientit të mbyllur e merr rrëfyestorja, e vetmja hapësirë ku e vërteta mund të shprehet pa kompromis, duke u bërë një vend për shprehjen e lirë të individit, edhe pse jo absolut, pasi njeriu ndodhet në praninë e një individi tjetër, si prifti. Kështu, Marta nuk ka asgjë për të cilën të pendohet; për këtë arsye, ajo refuzon të shkojë në rrëfyestore, duke u larguar pa u rrëfyer, e bindur se nuk ka nevojë për atë besim sipas moralit të përbashkët. Refuzimi i saj përbën një akt të qartë vetëdijeje dhe rezistence morale. Marta percepton hipokrizinë e këtij vendi të shenjtë, i cili, në vend që të ofrojë dritë dhe paqe shpirtërore, riprodhon

4 PIRANDELLO, L., (1919) *L’esclusa*, Milano, Fratelli Treves, fq 84

mekanizmat e përjashtimit dhe fajësimit “... e kishte lënë veten të bindej nga Ana që të vinte në kishë për t’u rrëfyer; por për veten e saj, për të marrë dritë dhe paqe nga Zoti. Po çfarë do t’i thoshte, pak më vonë, atij rrëfimtari të moshuar? Për çfarë duhej të pendohej? Çfarë kishte bërë, çfarë mëkati kishte kryer që të meritonte të gjitha ato ndëshkime, ato vuajtje, dhe turpin, fatkeqësinë e babait dhe të djalit, zinë e përhershme në shtëpi, dhe ndoshta varfërinë, nesër? Të akuzohej? Të pendohej?”<sup>5</sup> Në këtë perspektivë, aspirata për një botë më fisnike dhe më të përqendruar te vlerat shpirtërore duket e largët dhe e paarritshme.

### Festa e Kozimos dhe Damianos në sheshin e kishës



Festa e shenjtoreve Kozimo dhe Damiano është një rast i rëndësishëm bashkimi për besimtarët, të cilët ecin në një kortezh pas dy ikonave të shenjtoreve. Megjithatë, në roman pikërisht ky moment kthehet në çastin kulminant të ngjarjes. Ky kortezh zhvillohet në sheshin e kishës së një qyteti të madh, emri i të cilit mbetet i pathënë. Populli, me ferkolon në krahë, papritmas shfaq sjellje demoniake; turma ecën përpara mes shtyrjeve, në një drejtim të paditur, me një sjellje shtazore, të pushtuar nga deliri mistik. Turma zhvendoset nga një lagje buzë detit (emri i së cilës nuk dihet) drejt pjesës së lartë, ku ndodhet kisha e shenjtoreve mbrojtës. Përgjatë sheshit të kishës regjistrohet një marrëdhënie mes pjesës së poshtme të popullsisë dhe ballkoneve sipër, të cilat janë të mbipopulluara, ku gratë hidhnin nga dritaret bukë të zezë dhe mbajtësit e ferkolos deheshin me shishe vere. Në këtë pikë, turma bëhet armiku i Martës, duke marrë rolin e gjykuesit të Zotit, dhe shkon në drejtim të saj bashkë me shenjtoret. Turma ndalet përpara ballkonit të

Martës, duke përplasur kokat e shenjtorëve; ky veprim nënkuptohet si dëshira e Zotit për të përjashtuar mëkatarët që nuk janë penduar. Vetëm mjeshtëria e shkrimtarit siçilian arrin të krijojë mizorinë e këtij akti dhe ta bëjë Martën të duket, në sytë e të gjithëve, si e braktisura e Zotit. Jo rastësisht, Pirandello vendos të paraqesë figurën e *Ecce Homo*-s pranë shtratit të Martës, ku paraqitet Jezu Krishti i vuajtur, me kurorë gjembash, i poshtëruar nga një turmë që pranon akuza të përgjithshme kundër tij, vetëm për ta kryqëzuar. René Girard thotë se: “*Vetëm Ungjijtë janë në gjendje të dëshmojnë se viktimi është një pre sakrifikimi, duke i njohur pafajësinë Krishtit. Megjithatë, në atë kortezh shenjtorësh nuk ka dhembshuri ungjillore dhe asnjë drejtësi hyjnore, përveç dëshirës njerëzore për hakmarrje*”.<sup>6</sup> Kjo lloj shfaqje fetare shndërrohet në një sjellje instinktive dhe primitive të turmës, e cila shkatërron shpirtërisht individin e konsideruar të huaj nga shoqëria. Veprimi i lirë i njeriut nuk ekziston realisht; ai duhet të kontrollohet dhe të frenohet, sepse çdo ndryshim perceptohet si i ndaluar.

### Funksioni i këmbanës së kishës

Gjatë festës së shenjtorëve Kozima dhe Damian, turma shfrenohet duke shfaqur sjellje të dhunshme dhe të egra, ndërsa gjatë kohës në sfond dëgjohet në mënyrë të pandërprerë zhurma e kambanave të kishës. Në çastin e trazimit maksimal të turmës, kambanat bien me forcë maksimale duke krijuar një ndjesi sikur kambanat e kishave hyjnë në një garë të ndërsjellë, ku ato të kishave poshtë duket sikur i përgjigjen kishave lart: “*Kambanat lart binin me të gjitha fuqitë mbi atë gjallëri, dhe kambanat e kishave të tjera përgjigjeshin në largësi. Papritur, e gjithë turma u trazua, u shty e shtypur nga mijëra forca të kundërta, pa u kushtuar vëmendje përplasjeve, mavijosjeve, mbytyjes, vetëm për të parë. - Ja ai! Ja ai! Po del! Gratë qanin me ngashërim, shumë mallkonin të tërbuar, duke u përpjekur me zemërim të çliroheshin nga turma që ua pengonte shikimin; të gjithë bërtisnin të pushtuar nga deliriumi. Dhe kambanat binin pareshtur, sikur të ishin çmendur nga britmat e turmës.*”<sup>7</sup> Ky fenomen ilustron jo vetëm intensitetin e ngjarjes, por edhe ndikimin psikologjik dhe dramatik që tingulli i kambanave ushtron mbi individët e përfshirë në turmë.

Simbolika e kambanave në veprat pirandeliane ka një rëndësi të theksuar shoqërore dhe narrative. Zhurma e tyre përfaqëson një lloj thirrjeje të jetës kolektive, duke sinjalizuar ritmet dhe mekanizmat e shoqërisë, të cilat individët nuk mund t’i injorojnë, pavarësisht izolimit ose përjashtimit të këtyre individëve. Kambanat simbolizojnë një mundësi zgjimi moral dhe një kthesë kolektive të

6 SCHEPIS, M.F., *Dietro la maschera dell’ordine. Innocenza, colpa e sacrificio ne L’esclusa di Luigi Pirandello* (2018), Cosmopolis, fq. 5

7 PIRANDELLO, L. (1919) *L’esclusa*, Milano, Fratelli Treves, fq 97-98.

shoqërisë, duke lënë hapësirë për reflektim mbi hipokrizinë shoqërore dhe nevojën për rishikim të normave morale. Në romanin *Marta Ajala*, tingulli i kabanave shënon çastet e para të rifillimit të jetës sociale pas trazimit, duke krijuar një lidhje mes ngjarjes së turmës dhe rifillimit të rutinës së përditshme, ndërsa vështrimi i personazheve të izoluar, si vështrimi Françesko Ajala pas një nate pa gjumë, shikon rifillimin e jetës shoqërore, nga e cila me vendimin e vet është vetëpërfunduar, ky moment thekson kontrastin mes jetës kolektive dhe përjetimit individual. Në një kontekst më të gjerë, Pirandello përdor zhurmën e kabanave edhe në romanin *Një, asnjë dhe njëqindmijë* [*Uno, nessuno e centomila*], ku protagonistin lë pas qytetin dhe tingulli i kabanave duket sikur po e thërret për herë të fundit. “*Jashtë, dita... puna... Punëtorët, të ulur njëri pranë tjetrit në trotuar, presin që të hapet porta e fabrikës së lëkurës. Ja, bie kambana, hyjnë, dy nga dy, tre nga tre, të gëzuar ose të heshtur, me një trastë të vogël nën shqetull.*”<sup>8</sup> Pirandello zgjedh pikërisht tingullin e kabanave të kishave për ti bërë thirrje shoqërisë, sepse kambanat bien për të gjithë dhe le të themi, nuk është një zë individual, por një zë kolektiv.

### Filozofia e fenerit të vogël

Filozofia e fenerit të vogël [*Lanterninosofia*] është një shpikje letrare dhe filozofike e Luigi Pirandello-s, me të cilën autori nënkupton se çdo njeri ecën në errësirën e jetës me “fanarin” e tij të vogël; pra, janë bindjet personale ato që i japin dritë dhe kuptim jetës së secilit individ. Ky term i cili shpreh relativizmin e së vërtetës dhe subjektivitetin e perceptimit njerëzor, përdoret për herë të parë në romanin *I ndjeri Matia Paskal* [*Il fu Mattia Pascal*], megjithatë ai shfaqet edhe në romanin *Marta Ajala*. Filozofia e fenerit të vogël aludon në përdorimin e dritës sipas teorisë së Blumerit (1969)<sup>9</sup>, sipas së cilës njerëzit veprojnë në bazë të kuptimeve që gjërat kanë për ta. Në këtë kontekst, drita simbolizon të vërtetën. Marta shkon në kishë në mëngjes, pra gjatë ditës, dhe rrezet e diellit që depërtojnë në ambientin e kishës simbolizojnë, para së gjithash, të vërtetën e Martës dhe pastërtinë morale që ajo mbart gjatë gjithë historisë. Njëkohësisht, ato përfaqësojnë shpresën dhe ekzistencën e Zotit. Shpresa është elementi që e mbështet Martën në kohët e errëta të jetës së saj, të shkaktuara nga veprat e djallit, si gënjeshtat, shpifjet dhe xhelozitë. Këtë dimension shpirtëror e përforcon edhe fragmenti i mëposhtëm: “*E palodhur, Ana Veronika, pas kaq shumë netësh pa gjumë, i sillte tani çdo mëngjes të sëmurës në rikuperim figura të vogla aromatike shenjtorësh, të rrethuara me letër të shpuar, të zbukuruar me pika ari, me*

8 Po aty, fq 39

9 ROMANIA, V. *Dalle variabili alla sociologia lirica: percorsi metodologici da Blumer ad Abbott* (2017), fq 201.

*aureola të arta. - Ja, - thoshte, - brenda zarfit, nën jastëk: do të të shërojnë; janë të bekuara.*"<sup>10</sup> Përsa i përket errësirës, ajo simbolizon vdekjen dhe dëshpërimin, ndërsa hija simbolizon trishtimin që pritet të vijë pas fatkeqësive, ndërsa drita aludon butësinë. Për shembull babai i Martës vdes në një dhomë të vetmuar në mes të errësirës, gjë që tregon mungesë ngrohtësie dhe lidhjeje familjare, ndërsa drita simbolizon lidhjet empatike përmes të cilave çdo problem mund të zgjidhet.

### Përfundime

Narrativa e romanit *Marta Ajala* paraqet një reflektim kritik mbi të gjithë mekanizmat e përjashtimit shoqëror. Hapësirat fetare dhe ritualet publike, në vend që të mbrojnë individin, shpesh legjitimojnë paragjykimin dhe dhunën morale, duke penguar çdo formë vetërealizimi të individit. Feja në roman ka një rol ambivalent, pasi për personazhe si Maria (motra e Martës) dhe Ana Veronika simbolizon ende shpëtimin dhe shpresën, ndërsa për Martën përfaqëson hipokrizinë shoqërore dhe konformizmin. Ngjarja e festës së shenjtoreve Kozimo dhe Damiano nxjerr në pah transformimin e fesë në instrument të dhunës kolektive, ku turma merr rolin e gjykatësit hyjnor. Në këtë kuadër, *Marta Ajala* paraqitet si një vepër që denoncon hipokrizinë e shoqërisë veriste dhe problematizon raportin midis individit dhe institucioneve. Pirandello e shndërron historinë e Martës në një paradigmë të kërkimit të dinjitetit dhe të lirisë morale përballë gjykimit kolektiv.

### BIBLIOGRAFIA

- AGIS, D. (2014), «Ruoli svolti da Marta nell'Esclusa di Luigi Pirandello: Una donna forte o una donna debole?» *GRIN*.
- BONGHI, G. (8 Maggio 2025). «Introduzione a "L'esclusa".» *Pirandello Web*.
- COLLEVECCHIO, M. (2023). «Dalla parte di Marta: L'esclusa attraverso il paesaggio.» *Atti del XXVI Congresso dell'ADI*.
- GERMINI, S. (12 Maggio 2025). «L'esclusa»: La lotta di Marta Ajala contro il fango.» *PirandelloWeb*.
- GIUFFRIDA, M. (2023), «L' esclusa, Pirandello, Appunti di Filologia.» *doccity*.
- GIURDANELLA, L. (2024), «L'esclusa; Il tentativo di affermazione di Marta .» *Percorso Didattico*.
- GRASSO, A. (2016), «Analisi de «L'esclusa»: i pregiudizi della società secondo Pirandello.» *PirandelloWeb*.
- GROSSI, L., RUSSO, R. (2024), «La crisi della coppia nel romanzo L'esclusa di Pirandello: la letteratura come consapevolezza di sé.» *Annali online della Didattica e*

10 PIRANDELLO, L. (1919) *L'esclusa*, Milano, Fratelli Treves, fq 71

*della Formazione Docente.*

PALMA, L. (2021), «Tra pregiudizio e paradosso: la figura di Marta Ajala ne L'esclusa di Pirandello.» *Atti del XXIV Congresso dell'ADI.*

PIRANDELLO, L. (1919), «L'esclusa.» (Fratelli Treves).

RAMPINO, I. (2019), «A proposito de «L'esclusa», di Luigi Pirandello.» *PirandelloWeb.*

ROMANIA, V.( 2017), «Dalle variabili alla sociologia lirica: percorsi metodologici da Blumer ad Abbott.» *Sociologia italiana*, n. 10.

SABBATINO, M. (2017), «Il delirio mistico della folla nell'«Esclusa» di Pirandello.» *PirandelloWeb.*

SANGUINATTI, G. (2019), «Il mondo assurdo dell'Esclusa.» *XXIII Congresso dell'ADI.*

SAVINI, S. (2019), ««L'esclusa», gli esclusi – Breve analisi del romanzo.» *PirandelloWeb.*

SCHEPIS, M. F. (2022), «Dietro la maschera dell'ordine. Innocenza, colpa e sacrificio ne L'esclusa di Pirandello.» *COSMOPOLIS.*

NGA RIPRODHIMI DREJT REFLEKTIMIT:  
NJË RAST STUDIMOR MBI ZHVILLIMIN  
E MENDIMIT KRITIK NË MËSIMIN E GJUHËS ANGLEZE  
NË NJË INSTITUCION TË CIKLIT TË MESËM

**MSc. Mikena Bilbili**

Departamenti i Gjuhës Angleze  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: mikena\_bilbili.fgjhstudent@unitir.edu.al

**Prof. Asoc. Dr. Etleva koni**

Departamenti i Gjuhës Angleze  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: etleva.kondi@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Ky studim shqyrton mungesën e zhvillimit të mendimit kritik në orët e mësimit të gjuhës angleze në kontekstin arsimor shqiptar përmes një rasti studimor në një shkollë të mesme në Tiranë, duke analizuar ndikimin e metodave të mësimdhënies, mjedisit të nxënies dhe kulturës arsimore të trashëguar. Të dhënat janë vjelë përmes vëzhgimeve gjatë orëve mësimore, intervistave me mësuesen dhe nxënësit, si dhe analizës së punimeve të tyre. Në fazën eksperimentale, u zhvilluan disa orë me synim nxitjen e mendimit kritik. Nga këto të dhëna rezultoi se një pjesë e mirë e nxënësve mbështeten ende te të mësuarit mekanik, shfaqin vështirësi në argumenti E-mail m apo shqyrtim të çështjeve nga pikëpamje të ndryshme. Megjithatë, pas orëve eksperimentale u vu re një angazhim më aktiv prej tyre, analizë më e thellë dhe ide më të strukturuar. Si shembull praktik, studimi sjell projektin “Mendo para se të ndash me të tjerët”, i cili synon zhvillimin e mendimit kritik përmes reflektimit mbi përmbajtjen digjitale. Në përfundim, studimi thekson nevojën për një qasje të re pedagogjike, përdorimin e materialeve mësimore më të pasura në përmbajtje dhe programe trajnimi për mësuesit, të cilat vendosin në qendër analizën, reflektimin dhe aftësinë krijuese, përtej riprodhimit dhe saktësisë gjuhësore.

Fjalët çelës: mendimi kritik, anglishtja si një gjuhë e huaj, mësimi i bazuar në projekte, pedagogjia post-komuniste, reforma arsimore

### ABSTRACT

This study examines the limited development of critical thinking in English language classes within the Albanian educational context, through a case study conducted at a secondary school in Tirana. It analyzes the impact of teaching methods, the learning

environment, and the inherited educational culture. Data were collected through classroom observations, interviews with the teacher and students, and an analysis of students' written work (essays). During the experimental phase, a series of lessons was designed to foster the development of critical thinking skills. The findings reveal that a considerable number of students still rely on rote learning and experience difficulty with argumentation and examining issues from multiple perspectives. However, following the experimental lessons, students demonstrated greater engagement, deeper analysis, and more structured thinking. As a practical example, the study presents the project "Think Before You Share," which aims to enhance critical thinking through reflection on digital content. In conclusion, the study highlights the need for a renewed pedagogical approach, the use of more meaningful teaching materials, and teacher training programs that emphasise analysis, reflection, and creativity in the learning process, moving beyond mechanical reproduction and linguistic accuracy.

Keywords critical thinking, English as a foreign language, project-based learning, post-communist pedagogy, educational reform.

## Hyrje

Dhjetori i vitit 2024 shënoi publikimin e rezultateve të PISA 2022 dhe njëkohësisht histerinë kolektive të nxitur nga artikujt e shumtë të gazetave me tituj si: "Shqipëria po prek fundin", "Shqipëria me rënien më drastike në fushën e arsimit". Tituj të tillë të krijojnë përshtypjen se në vitet e mëparshme Shqipëria ka pasur rezultate të shkëlqyera në testimin PISA dhe këto rezultate na zunë në befasi. E nëse harresa kolektive nuk do të ishte kaq e theksuar, shumëkush do të mund të kujtonte se kjo dukuri është përsëritur për më shumë se dy dekada e gjysmë, duke u rishfaqur çdo katër vjet. Me sa duket, kujtesa jonë kolektive është e brishtë, aq sa harruam dhe shprehjen tonë të preferuar 'Ç'të mbjellësh, do të korrësh'.

Për shumë vite, 'hijet e komunizmit' kanë funksionuar si një mekanizëm i përligjshëm për vonesat në zhvillim, duke ushqyer perceptimin se vendi mbetet i kushtëzuar nga e kaluara dhe i përqendruar në përmbushjen e nevojave bazë sipas hierarkisë së Maslow-it (1943). Megjithatë, në kushtet aktuale, është absurde të vazhdohet kjo farsë vetëngushëllimi.

Në një botë të globalizuar, ku inteligjenca artificiale po zhvillohet me ritme të përshpejtuara dhe në nivele që para disa vitesh pjesa më e madhe e shoqërisë as nuk do t'i kishte imagjinuar, shkollat tona po mbrujnë nxënës të papërgatitur për të përballuar kërkesat e tregut ndërkombëtar të punës. Në të njëjtën kohë, kur flitet për aftësi të shekullit 21, në klasat tona nxënësve u kërkohet të mësojnë përmendësh rregullat e gramatikës si të ishin poezi të Artur Rembosë. Në këtë kontekst, roli i mësuesit të gjuhës së huaj nuk duhet të kufizohet vetëm në transmetimin e

informacionit, por duhet të shtrihet drejt funksionit të një udhërrëfyese që u vjen në ndihmë nxënësve me analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e informacionit (Brookfield, 2012).

E ndërsa vendet e zhvilluara kanë ndërmarrë masa për të integruar mendimin kritik në mënyrë të vazhdueshme në kurrikula (Ayçiçek & Yel, 2021), në Shqipëri kjo kompetencë mbetet kryesisht në nivel kurrikular (ASCAP, 2024) dhe e kufizuar në praktikën mësimore. Për rrjedhojë, analiza e mënyrës se si konceptohet dhe praktikohet të nxënimit në klasat e gjuhës angleze bëhet thelbësore për të kuptuar shkaqet e këtij hendeku midis kërkesave bashkëkohore dhe praktikës mësimore tradicionale. Në këtë studim synojmë të analizojmë faktorët që pengojnë zhvillimin e mendimit kritik në orët e mësimin të gjuhës angleze në kontekstin e Shqipërisë dhe sugjerojmë qasje praktike për zgjidhjen e kësaj problematike.

### Shqyrtimi i literaturës

Është me rëndësi të përmendim faktin se mendimi kritik nuk është një nocion i ri. Ai ka rrënjë të hershme, që nga koha e Sokratit, i cili ngriti pyetje mbi natyrën e së vërtetës, dhe u zhvillua më tej nga filozofë dhe studiues të njohur duke revolucionarizuar fusha të ndryshme të jetës, përfshirë dhe arsimin. John Dewey ishte i pari që theksoi se procesi i të mësuarit duhet të jetë një proces aktiv që nxit nxënësit të reflektojnë mbi çështje të jetës së përditshme. Studime të mëtejshme në fushën e arsimit dëshmojnë se mendimi kritik nuk mund të zhvillohet në mënyrë rastësore, por duhet të kultivohet me kujdes në mjedise që përfshijnë përdorimin e pyetjeve, dialogut dhe analizës (Brookfield, 2012; Facione, 2015).

Në këtë kontekst, klasat e mësimin të gjuhëve të huaja përbëjnë pikërisht një mjedis të përshtatshëm, duke qenë se mësimi i gjuhës shkon përtej mësimin të përmendsh të rregullave gramatikore e fjalëve të reja. Ky proces kërkon komunikim të efektshëm, i cili karakterizohet nga shprehja e ideve, reflektimi mbi kuptimin dhe të menduarit në mënyrë krijuese. Këtë qasje e thekson edhe Shih (2018), i cili nënvizon rëndësinë e pedagogjisë kritike të Freire-it për nxitjen e mendimit reflektues dhe emancipues, veçanërisht në kontekste arsimore që ende mbartin struktura autoritare të të nxënimit.

Studime të tjera në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja kanë theksuar gjithashtu rolin e mendimit kritik në zhvillimin e aftësive gjuhësore. Siç theksojnë edhe Liaw (2007) dhe Snider (2017), integrimi i aftësive të mendimit kritik në mësimin e gjuhës, përforcon aftësitë konjitive e gjuhësore, duke rritur vetëbesimin e nxënësve e duke nxitur bashkëpunimin e komunikimin e nxënësve në situata reale. Po kështu, qasja “*Meyasu*” (Nazikian & Park, 2023) ka në fokus zhvillimin e aftësisë për të kuptuar, duke argumentuar se zhvillimi i gjuhës duhet

të ecë paralelisht me zhvillimin e aftësisë për të kuptuar shoqërinë, si pjesë e pandashme e procesit mësimor.

Fatkeqësisht, jo të gjitha sistemet arsimore janë të gatshme të mbështesin strategji të tilla. Sistemi arsimor në vendin tonë ende mbart vragat e komunizmit dhe bashkë me to, rezistencën e vazhdueshme ndaj ndryshimit. Për një njohje më të mirë të situatës aktuale, kërkohet një analizë e kontekstit historik.

Regjimi komunist nuk synonte fuqizimin e individit përmes arsimit, por formimin e qytetarëve të bindur, të cilët, ashtu si kafshët e Orwell-it, përsërisnin parulla ‘melodike’. Mësuesit transmetonin informacion, nxënësit e riprodhonin, ndërsa gabimet ndëshkoheshin. Dhe pse analfabetizmi u ul ndjeshëm gjatë kësaj periudhe dhe numri i shkollave u rrit, studiuesit Alesina, Giuliano dhe Reich (2021) i mëshojnë faktit se regjime të tilla e kufizojnë arsimimin në nivele të moderuara për të homogjenizuar popullsinë dhe për të shmangur krijimin e ‘masave rebele’.

Ky model mësimdhënieje, ku mësuesit shiheshin si figura autoritare të pakundërshtueshme që japin informacionin dhe nxënësit mbartin një qëndrim pasiv dhe e pranojnë për të mirëqenë, pa guxuar të dyshojnë mbi vërtetësinë e tij, vijon të ndikojë edhe sot në arsimin tonë, duke përforcuar atë që Paulo Freire (1970) e quan ‘sëmundja e tregimtarisë’.

Rezultatet e testimeve ndërkombëtare, përfshirë PISA-n, e pasqyrojnë qartë këtë realitet. Që nga pjesëmarrja e parë në vitin 2000, nxënësit tanë shfaqën rezultate jo të kënaqshme dhe vazhduan kështu për më shumë se dy dekada. Nuk mund të mohojmë sigurisht faktin se gjatë kësaj periudhe pati përmirësime, por këto mbeten të papërfillshme në krahasim me ecurinë e shteteve të tjera. Viti 2022, për më tepër, shënoi një rënie të ndjeshme, duke theksuar edhe një herë se sistemi ynë ende mbart strukturën e mësimdhënies së centralizuar, të bazuar në riprodhim, jo në analizë e mendim kritik (OECD, 2002; OECD, 2023).

### **Metodologjia**

Ky studim mbështetet në një qasje cilësore për mbledhjen e të dhënave me synim analizimin e praktikës së mësimdhënies së gjuhës angleze në vend dhe ndikimin e saj në zhvillimin e mendimit kritik te nxënësit. Kjo qasje mundëson interpretimin e përvojave, qëndrimeve dhe proceseve në një kontekst sa më të natyrshëm. Të dhënat u mblodhën nëpërmjet vëzhgimeve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale në gjimnazin me orientim gjuhësor ‘Asim Vokshi’ në Tiranë, analizës së 30 testeve dhe eseve të nxënësve, si dhe intervistave me mësuesen e gjuhës angleze, koordinatoren e programit PISA dhe nxënësit pjesëmarrës në këtë studim.

Me synimin e hulumtimit të mundësive konkrete për përmirësim, u përdor

një metodë eksperimentale në klasë gjatë së cilës nxënësve iu kërkua të përkufizonin konceptin e “mendimit kritik”. Më pas u vijua me prezantime të shkurtra teorike mbi mendimin kritik, të shoqëruara këto me aktivitete praktike e lojëra ndërvepruese që synonin zhvillimin e aftësisë analizuese, argumentuese e vlerësuese (Shirkhani & Fahim, 2011; Phillips, 2023; Azamatovna, 2024).

### **Rezultate dhe interpretime**

Nga vëzhgimet u konstatua se pjesa më e madhe e nxënësve parapëlqejnë zgjidhje të shpejta e të lehta edhe në rastet kur veprimtaritë kërkojnë reflektim më të thellë. Gjetjet nga korrigjimi i provimeve treguan se nga 30 nxënës, vetëm 18 e kishin krijuar esenë që kishte si kërkesë propozimin e zgjidhjeve që u vinin në ndihmë të pastrehëve, dhe nga këta 18, asnjë nuk kishte arritur të sillte një zgjidhje të mirëfilltë e praktike. Fakti që kjo ishte klasa me rezultatet më të larta akademike e të gjithë vitit e bën situatën edhe më shqetësuese pasi dëshmon se dhe nxënësit me arritjet më të mira akademike mbështeten kryesisht në të mësuarit përmendësh dhe riprodhimin e informacionit. Kjo tregon gjithashtu se kultura e edukimit në vendin tonë vijon të mbështesë riprodhimin fjalë për fjalë dhe mekanik të informacionit në vend të reflektimit, analizës dhe kureshtjes intelektuale.

Në diskutimet e përditshme mbi tema të ndryshme u vu re se nxënësit shpesh përvetësonin mendimet e të tjerëve si të tyre, pa i vlerësuar ato në mënyrë kritike dhe rrallë ngrinin pyetje mbi informacionin që u jepej. Kjo është dëshmi e mungesës së aftësive metakognitive, duke i bërë nxënësit më të prirur të pranojnë informacionin pa reflektuar dhe më të ekspozuar ndaj keqinformimit dhe propagandës.

Një rol të rëndësishëm në këtë dinamikë luanin edhe strategjitë e menaxhimit të klasës, të cilat ndikonin drejtpërdrejt në mënyrën sesi nxënësit ndërvepronin në veprimtaritë që lidheshin me procesin mësimor. U vu re se shumë nxënës shfaqnin frikë nga bërja e gabimeve, një ndjenjë e përforcuar nga qasjet autoritare të menaxhimit të klasës dhe kërkesa e vazhdueshme për saktësi. Mësuesit e gjuhës angleze shpesh i jepnin përparësi rregullave gramatikore dhe mësimi përmendsh të fjalëve të reja, duke e justifikuar këtë qasje me përvojat e tyre si ish-nxënës të një sistemi tradicional. Veprimtaritë që nxënësin zhvillimin e mendimit kritik ishin të pakta dhe madje dhe kur përdoreshin, nxënësit shmangnin angazhimin në mënyrë aktive, duke zgjedhur sërish përgjigje sa më të shkurtra e të sigurta. Kjo prirje përbën një problem serioz, sepse me kalimin e kohës, këta nxënës të kushtëzuar të qëndrojnë larg rrezikut dhe të ndjekin modele të paracaktuara hasin vështirësi në përballjen me situata që kërkojnë mendim krijues për zgjidhjen e problemeve të ndryshme apo vendimmartje të pavarur. Për rrjedhojë, ata priren

të mbështeten në figura autoritare dhe dështojnë të zhvillojnë autonominë e tyre njohëse dhe emocionale.

I njëjti problem u vu re dhe me projektet e planifikuara, të cilat rrallë nxisin të menduarin kritik dhe përqendroheshin më tepër në aspektet vizuale sesa në përmbajtjen analitike. Nxënësit kalonin një pjesë të konsiderueshme të kohës duke pikturuar, krijuar punime me materiale kartoni, etj., teksa elementi reflektues dhe argumentues pothuajse mungonte. Dy ndër projektet kryesore të planifikuara gjatë periudhës së praktikës profesionale lidheshin me tematika si turizmi dhe kultura. Të dyja temat ofronin mundësi për hartimin e aktiviteteve me bazë krahasimin, analizën kulturore dhe zhvillimin e diskutimeve e debate të ndryshme. Por në praktikë, detyrat e dhëna i mëshonin më shumë krijimtarisë sipërfaqësore sesa analizës së thellë dhe argumentimit bindës. Projekte të tilla gjithashtu nuk ofrojnë mundësi reale për punë në grup, pasi shpesh dy ose tre nxënës, zakonisht ata me aftësitë më të mira për të pikturuar, marrin përsipër realizimin e pjesës kryesore të punës, ndërkohë që pjesa tjetër e klasës qëndrojnë pasivë dhe i mendojnë projekte të tilla si shmangie nga ‘mësimi i vërtetë’ dhe jo si mundësi për të eksploruar e bashkëpunuar.

Nga intervista me mësuesen e gjuhës angleze gjithashtu konstatuam se mësuesit i parapëlqejnë metoda tradicionale edhe për faktin se ato ndihmojnë në menaxhimin më të mirë të klasës. Në këto raste, nxënësit ndjekin një rend të paracaktuar, kopjojnë fjalët e reja dhe rregullat gramatikore në fletore dhe gjithë procesi mësimor zhvillohet me në qendër mësuesin. Mësuesja gjithashtu theksoi se veprimtaritë bashkëvepruese krijojnë pasiguri te nxënësit dhe se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk mund të angazhohen në mënyrë aktive për shkak të nivelit të ulët gjuhësor dhe mungesës së motivimit. Sipas saj, shumë nxënës, veçanërisht djemtë, shfaqin vështirësi me përqendrimin dhe mungesë interesi për të mësuar, çka e vështirëson zbatimin e metodave që kërkojnë pjesëmarrje aktive.

Sa i përket mendimit kritik, mësuesja shprehu gatishmëri për të mësuar dhe zbatuar qasje dhe metoda të reja që do ta ndihmonin në integrimin e kësaj aftësie në mësimdhënie. Sipas saj, nevojitet hartimi i trajnimeve të posaçme për mësuesit, të përshtatura për kontekstin shqiptar, ku ndryshimet në nivelet gjuhësore të nxënësve janë të dukshme, ndërsa mungesa e infrastrukturës e vështirëson dhe më shumë zbatimin efektiv të qasjeve bashkëkohore të mësimdhënies.

Trajnimet e mësuesve u identifikuan gjithashtu si një nga rekomandimet kryesore të koordinatores së Programit Përgatitor të PISA, e cila u ndal te faktorët që ndikojnë në rezultatet e ulëta të nxënësve shqiptarë. Ajo theksoi se nxënësit nuk ishin të familjarizuar me formatin e pyetjeve të PISA-s, duke qenë se këto pyetje ndryshojnë ndjeshëm nga llojet e pyetjeve që hasin në praktikën e përditshme mësimore. Edhe pse tekstet e reja të përshtatura nga modelet e huaja përfshijnë

veprimtari të përshtatshme për zhvillimin e mendimit kritik, shtoi ajo, mësuesit shpesh nuk përfshihen në trajnimet përkatëse dhe, për rrjedhojë, nuk janë të përgatitur si duhet për t'i shfrytëzuar ato në mënyrë efektive. Prandaj, organizimi i trajnimeve të vazhdueshme dhe të përshtatura për mësuesit konsiderohet një domosdoshmëri për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të arritjeve akademike të nxënësve.

Për të kuptuar më shumë rreth qasjes së nxënësve ndaj mendimit kritik zhvilluam një test të thjeshtë me disa klasa të 10-ta, ku vetëm 2% e nxënësve arritën të jepnin një përkufizim të qartë të këtij koncepti, ndërsa edhe nxënësit me kompetenca gjuhësore shumë të mira shfaqnin vështirësi të dukshme konceptuale.

Për ta përmirësuar këtë situatë, zhvilluam një numër prezantimesh të shkurtra mbi mendimin kritik, të shoqëruara këto me aktivitete praktike e lojëra ndërvepruese. Rezultatet ishin inkurajuese: nxënës më aktivë në pjesëmarrje, një nivel më i lartë bashkëpunimi, si dhe një përmirësim në cilësinë e përgjigjeve, të cilat shfaqnin më shumë arsytim logjik, reflektim mbi informacionin e ofruar dhe zgjidhje të problemeve në mënyrë krijuese.

Reagimi pozitiv i nxënësve pati ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përmirësimin e dinamikës së klasës, duke e bërë punën e mësuesve më të lehtë dhe më efektive.

Megjithatë, lind pyetja: çfarë duhet bërë për të siguruar ndryshim të qëndrueshëm dhe afatgjatë?

Bazuar në gjetjet e këtij studimi, propozojmë disa masa konkrete për përmirësimin e praktikës mësimore, si vijon:

- Ndryshime në metodat e mësimdhënies: përfshirja aktive e nxënësve në procesin mësimor përmes ushtrimeve që nxisin bashkëpunimin, arsytimin dhe mendimin e pavarur;
- Materiale mësimore sfiduese: përzgjedhja e burimeve autentike si artikuj nga shtypi i përditshëm, video ose podkaste që ngjallin debat, projekte të mirëmenduara dhe pyetësorë që stimulojnë reflektimin;
- Trajnimi i mësuesve: zhvillimi i kompetencave profesionale për përdorimin e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies, mungesë e cila do të bënte që reformat të mbeten vetëm në letër. Planifikimi i orës së mësimi kërkon përkushtim dhe përgatitje profesionale.

### **Përfundime**

Ky studim synon të analizojë trajtimin e mendimi kritik në orët e mësimi të gjuhës angleze në kontekstin shqiptar. Gjetjet treguan se nxënësit shqiptarë hasin vështirësi në përdorimin e njohurive në mënyrë analitike dhe krijuese. Ata priren të riprodhojnë informacionin e dhënë pa zhvilluar aftësinë për arsytim e reflektim individual apo aftësinë për zgjidhjen e problemeve.

Kjo dukuri nuk është rastësore, por rrjedhë e faktorëve historikë e shoqërorë që kanë formësuar kulturën arsimore në vend, si dhe e praktikave tradicionale të mësimdhënies, të cilat theksojnë saktësinë mbi analizën.

Megjithatë, gjetjet e studimit theksojnë se ekziston mundësia për ndryshim dhe se mungesa e mendimit kritik nuk buron nga paaftësia e nxënësve, por nga metodat dhe strategjitë që formësojnë procesin e mësimnxënies. Kur mësimdhënia orientohet drejt reflektimit, debatit dhe pjesëmarrjes aktive, përfshirja e nxënësve dhe cilësia e mendimit të tyre përmirësohen dukshëm.

Në përmbyllje, nëse synojmë të përgatisim qytetarë globalë të aftë për t'u përballur me sfidat e së ardhmes, duhet të shmangim modelin e të mësuarit përmendësh dhe të vendosim në qendër zhvillimin e mendimit kritik.

Vetëm përmes kësaj qasjeje do të mund të formojmë breza që mendojnë në mënyrë të pavarur dhe dinë të përshtaten në një botë ku parashikimi bëhet gjithnjë e më i vështirë.

## BIBLIOGRAFIA

- ALESINA, A., GIULIANO, P., & REICH, B. (2021). *Nation-building and education. Journal of Economic Growth*, 26(4), 385–420. <https://doi.org/10.1007/s10887-021-09196-0>
- ASCAP. (2024). *Korniza Kurrikulare e përditësuar*. Tiranë: ASCAP
- Azamatovna, N. S. (2024). *Developing Critical Thinking Skills Through Language Learning. Web of Journals*, 1(1), 1-8. <https://webofjournals.com/index.php/1/article/view/2606>
- AYÇİÇEK, B., & YEL, S. (2021). *Integration of critical thinking into curriculum*. <https://psycnet.apa.org/doi/10.1016/j.tsc.2021.100895>
- BROOKFIELD, S. D. (2012). *Teaching for critical thinking: Tools and techniques to help students question their assumptions*. Jossey-Bass.
- FACIONE, P. A. (2015). *Critical thinking: What it is and why it counts*. Insight Assessment. <http://www.ndm.edu/sites/default/files/pdf/Facione-2015.pdf>
- FREIRE, P. (1970). *Pedagogy of the oppressed* (M. B. Ramos, Trans.). Herder and Herder.
- NAZIKIAN, F., & PARK, J. (2023). *How to develop 21st century skills in foreign language education. Foreign Language Annals*, 56(2), 254–276. <https://doi.org/10.1111/flan.12589>
- OECD. (2002). *PISA 2000 results: Reading, mathematics and science knowledge and skills*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/9789264195905-en>
- OECD. (2023). *PISA 2022 results: Creative thinking, student performance, and educational equity*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/9789264986442-en>

PHILLIPS, H. N. (2023). *Developing critical thinking in classrooms: Teacher responses*. *Reading & Writing*, 14(1), 1–17.

<https://rw.org.za/index.php/rw/article/view/401>

SNIDER, D. (2017). *Critical thinking in the foreign language and culture curriculum*. *The NECTFL Review*, 80, 55–74.

SHIH, Y. H. (2018). *Some Critical Thinking on Paulo Freire's Critical Pedagogy and its Educational Implications*. *International Education Studies* 11(9), 81–87. <https://doi.org/10.5539/ies.v11n9p81>

SHIRKHANI, S., & FAHIM, M. (2011). *Enhancing Critical Thinking In Foreign Language Learners*. *Procedia - Social and Behavioral Sciences*, 29, 111-115. <https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2011.11.214>

EARLY EXPOSURE TO A FOREIGN LANGUAGE -  
DEVELOPMENTAL EFFECTS,  
EXPOSURE METHODS AND THE INFLUENCE  
OF PARENTAL MEDIATION

**MSc. Sara Tema**

Department of English Language  
Faculty of Foreign Languages, University of Tirana  
E-mail: sara\_tema.fgjhstudent@unitir.edu.al

**Prof. Asoc. Dr Rovena Vora**

Department of English Language  
Faculty of Foreign Languages, University of Tirana  
E-mail: rovena.vora@unitir.edu.al

**PËRMBLEDHJE**

Ky punim trajton ndikimin që ka ekspozimi i hershëm ndaj një gjuhe të huaj në zhvillimin gjuhësor, njohës dhe social të fëmijëve. Në kohët e sotme, fëmijët janë gjithnjë e më shpesh në kontakt me gjuhët e huaja, jo vetëm në shkollë, por edhe përmes teknologjisë, mediave dhe ndërveprimeve të përditshme. Kjo temë shqyrton jo vetëm nëse ky ekspozim është i dobishëm, por edhe si mënyrat e ndryshme të ekspozimit ndikojnë në rezultatet e mësimit të gjuhës.

Përmes një qasjeje të kombinuar kërkimore, janë mbledhur të dhëna nga një pyetësor me prindër dhe dy intervista: njëra me një mjeke logopede dhe tjetra me një familje emigrante shqiptare që po rrit fëmijët në Shtetet e Bashkuara. Rezultatet treguan se fëmijët që ekspozohen ndaj gjuhës së huaj në moshë të hershme dhe në mënyrë të rregullt e ndërvepruese zhvillojnë më mirë shqiptimin, aftësitë metakognitive dhe përmirësojnë edhe ato sociale. Ndërkohë, fëmijët që mësojnë përmes mënyrave pasive si videot apo filmat vizatimorë tregojnë përparim më të kufizuar.

Gjetjet theksojnë gjithashtu rëndësinë që ka angazhimi aktiv i prindërve në këtë proces. Studimi përmbillet me rekomandime praktike për të mbështetur zhvillimin e hershëm gjuhësor si në shtëpi ashtu edhe në shkollë, duke inkurajuar ndërveprim të drejtpërdrejtë, bashkëpunim më të ngushtë mes familjes dhe institucionit arsimor, si dhe përdorim më të dobishëm të mjeteve digjitale.

Fjalët çelës: ekspozim, përvetësim, fleksibilitet, përfshirje, përshtatje,

## ABSTRACT

This paper explores how early foreign language exposure influences young children’s language skills, cognitive skills, and social development. With early exposure becoming more common, often through media, technology, or daily interactions — this study examines not just whether it helps, but how different methods of exposure shape outcomes. A mixed-methods approach was used, combining survey data from parents, with insights from two interviews: one with a speech-language therapist, and another with an Albanian family raising their children in the United States and navigating between the native and foreign language. The results show that children who are introduced to a foreign language early, especially through regular and meaningful interaction - tend to develop better pronunciation, stronger language awareness, and more social confidence. On the other hand, children exposed only through passive methods like videos or cartoons often show more limited progress. The findings also highlight the importance of active involvement from parents supporting language learning from an early age. The study ends with practical recommendations to help improve early FL learning at home or in the classroom, encouraging interactive methods, stronger home-school collaboration, and more intentional use of digital tools.

Keywords: exposure, acquisition, flexibility, involvement, adaptability.

## Introduction

If there is one thing that has changed dramatically in the past decade, it is how early children start speaking words that their parents do not even understand. From toddlers singing along to *Coco Melon* to pre-schoolers giving instructions to Alexa in English, early exposure to foreign languages has quietly become part of everyday childhood. What used to start in a classroom now often begins in the living room - sometimes even before a child can properly pronounce words in their native tongue.

This rise of early foreign language (FL) exposure is not just a modern trend; it is reshaping how we think about language development. Children are now surrounded by foreign-language input through cartoons, games, songs, and digital devices. Researchers call this “ambient language learning” (Lambert, 2021) - basically, learning without really trying. But the real question is: how much of this exposure actually sticks, and how much floats past them like background noise?

Science has already shown that the early years are a golden window for learning languages (Lenneberg, 1967; Kuhl, 2013). Kids’ brains are like little sponges - but as every parent knows, sponges can soak up both water and mess. So, while many children pick up foreign words naturally from screens and media,

what truly shapes their development may not be just what they hear, but how and with whom they experience it.

That is where the grown-ups come in. Parents are usually the ones holding the remote, the phone, or the bedtime storybook - and often without realizing it, they are also holding the keys to their child's language growth. Studies (De Houwer, 2007; King & Fogle, 2013) show that children's language progress depends strongly on how involved and supportive their parents are. Yet, many parents think exposure is enough: "*He watches English cartoons every day - he'll be fluent in no time!*" (If only Netflix counted as a tutor.)

The truth, as newer research suggests, is a bit more complicated. Passive exposure through screens may boost vocabulary recognition, but it does not teach real communication unless it is paired with meaningful social interaction. In contrast, when children are exposed to a new language through conversation, storytelling, or play - what we might call interaction-based exposure - they develop not only better pronunciation and grammar but also stronger cognitive and social skills.

This study explores exactly that intersection: how the type of early foreign language exposure and the level of parental involvement shape children's development. Using both surveys with parents and interviews with professionals, it examines how different exposure methods - technology-based versus interaction-based affect language, cognition, and social adaptability in young children.

The research is guided by three main questions:

- What developmental changes are most commonly observed in children who are exposed early to a foreign language?
- How does the method of exposure (technology-based vs. interaction-based) affect their language growth?
- What role do parents play in guiding and supporting this process?

By diving into these questions, the study hopes to paint a clearer picture of what early foreign language exposure really does - and what makes it effective. After all, it is not just about starting early; it is about starting right.

### **Literature review**

Research on early foreign language exposure has long shown that the younger a child is, the more naturally they pick up new sounds, words, and structures. But while most experts agree that "earlier is better," they also remind us that the how matters just as much as the when. The following section explores the main perspectives that shape our understanding of this topic - ranging from biological readiness and sociocultural context to children's individual learning traits and the often-overlooked role of parents.

### *1. Early Language Learning: A blend of Nature and Nurture*

Language learning starts before we even realize it. According to García Mayo (2017) and Singleton & Lengyel (15), early instruction sets the foundation for long-term fluency by taking advantage of children’s natural sensitivity to sound and rhythm. The idea goes back to Noam Chomsky’s theory (1972) that children are born with an innate ability to learn language - a kind of built-in “language machine.”

However, later scholars, including Magda Ponce (2021), argue that biology isn’t the full story. In her research on preschool classrooms, she emphasizes that environment, social support, and daily interaction all play a crucial role. This echoes Vygotsky’s Sociocultural Theory (1978), which views language learning as a social act: children do not just absorb words; they co-create meaning through interaction with others. In other words, a child might have the perfect brain for language learning - but without a meaningful environment to activate it, the process can remain dormant. Language, then, grows at the intersection of nature and nurture.

### *2. The Critical Period: Why early exposure works best*

Neurolinguistic research adds a fascinating layer to this discussion. Lenneberg’s (1967) Critical Period Hypothesis suggests that there is a biological window - roughly from birth to puberty - when the brain is most flexible and receptive to new languages. More recent studies confirm that early learners use the same brain regions for both their first and second languages, while adults rely on different and less efficient pathways (Kim, 2020).

Patricia Kuhl’s (2013) work further shows that babies can distinguish between sounds from multiple languages during their first year of life, but this ability fades without continued exposure. Similarly, Dao (2019) and Hartshorne et al. (2018) found that after age seven, the brain’s plasticity begins to decline, making native-like pronunciation harder to achieve. So yes - children really do learn languages more easily than adults. Unfortunately, they also forget socks, lunchboxes, and homework with the same enthusiasm.

### *3. Children’s unique strengths as language learners*

Young children do not just learn languages - they play with them. Hofherr (2020) explains that traits such as curiosity, imagination, and fearlessness make them natural language explorers. They can understand meaning through gestures, tone, and context even before they fully grasp vocabulary. Unlike adults, children do not panic when they do not understand every word - they simply guess, giggle, and move on. This tolerance for uncertainty, combined with their instinct

to interact, allows them to pick up language patterns intuitively. Read (2003) calls this the “window of imagination,” where language learning happens through storytelling, play, and pretend scenarios rather than formal drills. These strengths mean that exposure does not have to look like a traditional lesson. Singing a song, playing with toys, or chatting about a cartoon can be just as powerful as any classroom exercise - if not more so.

#### *4. Parents’ perspectives and real-world challenges*

While biology and curiosity give children a head start, parents often determine whether that advantage truly takes root. De Houwer (2007) and King & Fogle (2013) both highlight that parental attitudes, consistency, and support strongly influence children’s progress. Parents who view foreign languages as important tend to create richer environments - whether through bedtime stories, songs, or daily routines in another language.

However, research also shows a gap between ideals and reality. Schwartz and Moin (2012) found that while many parents believe early foreign language learning is beneficial, their day-to-day practices do not always match those beliefs. Victoria Benz’s (2015) study *Dynamics of Early Bilingual Child Education* goes further, revealing that parents often view language learning as a path to broader opportunities - better jobs, more education, or cultural openness - rather than as a goal in itself. In practice, however, maintaining exposure can be hard. Busy schedules, limited programs, and overreliance on digital content can lead to what Benz calls “symbolic bilingualism” - where the idea of learning a language matters more than the actual learning. As she puts it, families often start with good intentions, but without sustained engagement, progress fades quickly.

### **Methodology**

To explore how early exposure to a foreign language affects children’s development, this study used a mixed-methods design - a combination of quantitative and qualitative approaches. Numbers can tell part of the story, but people’s experiences often fill in the rest. By using both, the research aimed to capture not only measurable patterns but also the emotions, challenges, and context behind them.

The quantitative side consisted of a structured questionnaire for parents of young children who had been exposed to a foreign language. This provided a broad view of exposure types, frequency, and observable developmental changes. The qualitative side added depth through two interviews: one with a speech-language therapist and another with an Albanian family living in the United States, raising bilingual children. Together, these methods offered both statistical

trends and human stories that bring the data to life.

- **Participants**

The participants were 30 parents of children between ages 0 and 8, all of whom had experienced some degree of early foreign language exposure - either through technology (cartoons, games, songs) or direct human interaction (conversation, storytelling, guided play). Parents were reached with the help of local preschool and elementary teachers who distributed the online questionnaire.

For the qualitative part, two interviews were conducted:

*Interview 1:* With an Albanian couple, Alma and Arjan, raising two children in the United States. Their differing experiences with early exposure (one child exposed early through interaction, the other later through media) provided a valuable comparison.

*Interview 2:* With Dr. Nensi Tufa, a licensed speech and language therapist who has extensive experience working with multilingual children and families. Her insights helped interpret the patterns found in the parental data.

- **Procedure**

Data collection followed three main steps:

- Distribution of the questionnaire through preschool networks and online parent groups. Participation was voluntary and anonymous.
- Individual interviews conducted via video call and in person, lasting about 40 - 60 minutes each.
- Data analysis combining descriptive statistics for the questionnaire and thematic analysis for the interviews. The goal was to identify recurring themes such as interaction vs. technology, parental involvement, and developmental outcomes.

- **Ethical considerations**

Ethics were treated with the seriousness the topic deserves - especially since the research involved children's experiences, even if only through their parents' perspectives. All participants were informed about the study's purpose and assured of full anonymity. No personal identifiers were collected, and participants were free to withdraw at any stage. For the case studies discussed by Dr. Tufa, all names and details were anonymized. By combining quantitative breadth with qualitative depth, this study aimed to offer a well-rounded understanding of early foreign language exposure - one that recognizes both the numbers and the nuanced human stories behind them.

## **Results and Discussion**

- **Overview of exposure patterns**

The questionnaire data revealed that early exposure to foreign languages is

becoming increasingly common among Albanian families, even when parents are not fully bilingual. Among the 30 participants, over two-thirds (68%) reported introducing a foreign language - mainly English - before their children turned five.

However, how children were exposed differed sharply. About 45% said their child's main exposure came through technology-based methods such as cartoons, YouTube videos, or mobile games. Meanwhile, 38% relied mostly on interaction-based exposure, including direct conversation, storytelling, or play in a foreign language. The remaining 17% reported a mix of both.

This finding reflects a broader global trend: as technology becomes a natural babysitter, children are absorbing foreign languages earlier - but often passively. As one parent humorously commented in the open-ended section:

*"My daughter speaks English with Peppa Pig's accent but still answers me in Albanian!"*

It's funny, but it also hints at a deeper issue - exposure alone does not guarantee meaningful learning.

#### · *Linguistic and cognitive development*

Across all exposure types, parents noticed positive outcomes in pronunciation, vocabulary, and listening comprehension. Around 73% observed that their children could understand foreign-language phrases or recognize words even before learning to read. Many also noted small but visible cognitive benefits: better memory, focus, and problem-solving. These findings align with previous studies (Dao, 2019; Kuhl, 2013) suggesting that early exposure sharpens phonological awareness and stimulates executive functions. However, the quality of exposure made a big difference. Children who experienced foreign languages through play, dialogue, or shared activities showed richer verbal interaction and more confidence in experimenting with new words.

Dr. Nensi Tufa, the speech-language therapist interviewed, emphasized this distinction clearly:

*"Children don't just need to hear the language - they need to use it, even imperfectly. Language grows through communication, not repetition."*

In other words, Peppa Pig can spark curiosity, but it is the conversation that follows that builds real learning.

#### · *The role of parental involvement*

One of the strongest themes to emerge from both the quantitative data and interviews was the central role of parents. Children whose parents actively engaged - by repeating words, translating phrases, or playing bilingual games - were described as more confident and enthusiastic learners. In contrast, when exposure was left entirely to screens, progress was slower and more superficial.

As Dr. Tufa noted, “*The device can provide sound; the parent provides meaning.*” This distinction echoes Vygotsky’s idea (1978) that learning flourishes through guided social interaction.

Interestingly, even parents who were not fluent themselves managed to contribute effectively. Simple strategies - like watching shows together, asking “What did that mean?”, or singing along - helped transform passive exposure into active learning. This supports De Houwer’s (2007) and King & Fogle’s (2013) findings that attitude and consistency matter more than perfect language skills.

· *Technology vs. Interaction: two sides of the same coin*

While interaction-based exposure produced deeper learning, the study does not portray technology as the villain. Many parents admitted that digital media made early exposure possible in the first place, especially when they could not offer direct language input. The problem, as several noted, was not the screen - it was the absence of follow-up interaction. For example, one family in the U.S. described how their daughter, Siera, began learning English through cartoons and preschool interactions at age three, while their younger son, Siar, was introduced earlier and more intentionally through games and daily conversation. The difference was striking: Siera developed confidence and fluency faster because her exposure combined digital and social learning.

This supports Dao’s (2019) conclusion that successful early foreign language learning depends not just on exposure quantity, but on contextual engagement - that is, whether the language is connected to real experiences. Simply put, watching Dora the Explorer is helpful; actually exploring the world while using the words is better.

· *Social and emotional dimensions*

Beyond language skills, parents observed emotional and social benefits. Children exposed early to foreign languages tended to show greater curiosity, cultural openness, and social adaptability. Some parents mentioned that their children were more confident when meeting foreigners or participating in mixed-language activities.

These findings echo Hofherr’s (2020) and Read’s (2003) work on how language learning enhances social imagination. When children play, sing, or role-play in another language, they are not only learning words - they’re also rehearsing empathy, perspective-taking, and creativity. However, a few parents also mentioned confusion or temporary language mixing, especially in children under four. This “code-switching” phase, though often misunderstood, is a normal part of multilingual development (Genesee, 2008). It does not indicate confusion; rather, it shows that the brain is managing multiple systems at once - a skill that, over time, strengthens cognitive flexibility.

### *Summary of Findings*

The findings suggest that early foreign language exposure can positively influence children’s linguistic, cognitive, and social development, but the benefits depend on how the exposure occurs. Interaction-based exposure leads to stronger pronunciation, richer vocabulary, and higher confidence.

Technology-based exposure can be beneficial, but only when paired with parental guidance or meaningful engagement. Parental involvement consistently emerges as the most influential factor - regardless of the method used. These results reinforce what researchers like Kuhl (2013) and Vygotsky (1978) have long suggested: learning thrives when language is social, interactive, and emotionally meaningful.

### **Conclusions**

This study set out to explore how early exposure to a foreign language shapes children’s linguistic, cognitive, and social development — and what makes that exposure truly effective. The findings make one thing very clear: it’s not only about starting early, but about how and with whom children experience a foreign language.

Children who were exposed to another language through interaction — conversations, storytelling, songs, and play — showed stronger progress than those who learned mainly through technology-based methods like videos or mobile apps. Interaction provided not only linguistic input but also emotional engagement, which helped children build confidence and curiosity. Meanwhile, screen-based exposure, though useful for introducing sounds and vocabulary, often lacked the context and feedback needed for deeper learning.

Perhaps the most important takeaway concerns parents. Regardless of their own fluency, parents who took an active role — talking about what their children watched, repeating words, or playing games together — helped transform exposure into learning. Their involvement made the experience meaningful and connected, turning passive listening into active communication. As Dr. Tufa wisely noted, “*Devices cannot replace dialogue.*” From a broader developmental perspective, the study highlights that early foreign language learning can boost more than just linguistic ability. It can nurture attention, memory, and social adaptability, while also encouraging empathy and cultural openness. These are skills that reach far beyond language itself.

For parents and educators, the implication is simple but powerful: early exposure works best when it is interactive, consistent, and emotionally engaging. Technology can be a useful tool, but only if balanced with genuine human connection. For researchers, the results open space for future studies comparing

how these patterns evolve as children grow — especially as technology continues to play a larger role in early education. In short, early exposure to a foreign language can be a gift for a child’s development — but like any gift, it matters how it is given. A tablet might introduce the words, but it is a parent’s smile, a shared story, or a playful exchange that makes those words come alive.

## REFERENCES

- LAMBERT, W. E. (2021). Ambient language learning in the digital age. *Language Education & Technology*, 36(4), 201–219.
- KUHL, P. K. (2011). Early language learning and the social brain. *Mind, Brain, and Education*, 5(3), 128–142.
- LENNEBERG, E. H. (1967). *Biological foundations of language*. Wiley.
- De Houwer, A. (2007). Parental beliefs and attitudes regarding multilingual development. *International Journal of Bilingualism*, 11(3), 275–293.
- KING, K. A., & FOGLE, L. (2013). Family language policy and bilingual parenting. *Language Teaching*, 46(2), 729–749.
- HOFHERR, N. (2020). Early English learning in multilingual contexts. *International Journal of Early Childhood Language Education*, 8(2), 12–27.
- GARCÍA MAYO, M. P. (2014). *Age and the acquisition of English as a foreign language*. Multilingual Matters.
- SINGLETON, D., & LENGYEL, Z. (1995). *The age factor in second language acquisition*. Multilingual Matters.
- PONCE, M. L. (2021). Language exposure in early childhood classrooms. *Early Childhood Education Review*, 22(1), 1–17.
- VYGOTSKY, L. S. (1978). *Mind in society: The development of higher psychological processes*. Harvard University Press.
- KIM, K., RELKIN, N. R., LEE, K.-M., & HIRSCH, J. (1997). Neural systems for native and second languages. *Nature*, 388, 171–174.
- DAO, T. T. (2019). Child language acquisition and bilingualism. *Language Learning Journal*, 47(3), 290–305.
- SCHWARTZ, M., & MOIN, V. (2012). Parents’ language ideology and language practices: A case study. *Journal of Multilingual and Multicultural Development*, 33(1), 35–55.
- BENZ, V. (2015). *Dynamics of early bilingual child education*. Routledge.

# STILET E TË NXËNIT NË MËSIMNXËNIEN DHE MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ ANGLEZE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

**MSc. Elton Gjurra**

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë  
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës  
E-mail: elton\_gjurra.fshsstudent@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Ky punim synon të theksojë rëndësinë e stileve të të nxënimit gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj angleze në arsimin parauniversitar të Shqipërisë. Në këtë studim, stilet e të nxënimit, përfshijnë kryesisht nxënien pamore, dëgjimore, të shkrim-leximit dhe nxënien kinestetike. Këto stile të të nxënimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mësimdhënien dhe mësimnxënien bashkëkohore të gjuhës së huaj angleze. Hipoteza e këtij punimi paraqet kombinimin e stileve të të nxënimit duke nxitur, lehtësuar dhe përmirësuar mësimdhënien me në qendër nxënësin, mësimdhënien e diferencuar dhe mësimdhënien me bazë kompetencat kyçe të të nxënimit.

Fokusi i këtij studimi është analiza e stileve të të nxënimit në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze në Shqipëri krahasuar me vende të ndryshme të botës. Ky studim trajton problematikat dhe sfidat kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze në arsimin parauniversitar shqiptar. Gjithashtu, në këtë punim përshkruhet rëndësia dhe ndikimi i faktorëve, aktorëve dhe kontekst arsimor shqiptar mbi cilësinë e mësimin të gjuhës angleze. Në këtë studim përfshihen metodat e përziera të kërkimit shkencor. Punimi përfshin të dhëna sasiore nëpërmjet pyetësoreve me nxënësit dhe të dhëna cilësore nëpërmjet një studimi rasti në mësuesit. Konkluzionet theksojnë qasjen e mësimdhënies me në qendër nxënësin duke e përgatitur nxënësin me njohuritë dhe aftësitë e duhura për jetën e përditshme qytetare dhe ofrojnë disa zgjidhje të mundshme në praktikimin e stileve të nxënimit bazuar në kontekstin e arsimit parauniversitar shqiptar.

Fjalët çelës: stilet e të nxënimit, stili pamor, stili dëgjimor, stili i shkrim-leximit, stili kinestetik, mësimdhënien me në qendër nxënësin, mësimdhënien bashkëkohore, mësimdhënien me bazë kompetencat kyçe, mësimnxënien, kontekst arsimor, kurrikula, gjuhë e huaj angleze, mësimdhënien e diferencuar, mjedis shkollor miqësor për nxënësin, mësimdhënien bazuar në kompetencat kyçe të të nxënimit, mundësi për mësimnxënien, mjete didaktike etj..

**ABSTRACT.**

This paper aims to emphasize the importance of learning styles in the teaching and learning of English as a Foreign Language (EFL) in the Albanian pre-university education. The learning styles discussed in this study include the visual, auditory, read/write learning, and kinesthetic learning styles. These learning styles play a significant role in contemporary approaches to teaching and learning English as a Foreign Language. The main hypothesis of this paper is that combining different learning styles can stimulate, facilitate, and enhance student-centered teaching, differentiated instruction and competency-based learning.

The focus of this study is the analysis of learning styles in English language teaching and learning in Albania, compared with practices in other countries. The study examines the main problems and challenges associated with teaching and learning English in Albanian pre-university education. It also explores the importance and influence of various factors, actors, and the Albanian educational context on the quality of the English language learning. The research employs a mixed-methods approach, combining quantitative data collected through student surveys with qualitative data derived from a case study of a pedagogical experience. The findings highlight the importance of student-centred teaching approach that equips learners with the knowledge, skills and competences necessary for everyday life and active citizenship. The study also offers practical recommendations for implementing learning styles effectively within the context of Albanian pre-university education.

Keywords: Learning styles, visual style, auditive style, read-write style, kinesthetic style, student-centred teaching, contemporary teaching, key competency based teaching, learning, educational context, curriculum, English Foreign Language, differentiated teaching, friendly school's environment for children, teaching based on the key competencies of learning, opportunities for learning, didactic means etc..

**1. Hyrje**

Në këtë studim do të trajtohen stilet e të nxënit në mësimnxëniën dhe mësimdhëniën e gjuhës së huaj angleze në arsimin parauniversitar. Stilet kryesore të të nxënit, që trajtohen në këtë punim shkencor, janë: stili vizual, stili dëgjimor, stili verbal i leximit/shkrimit dhe stili kinestetik. Ky punim paraqet në terma praktikë se si mund të zhvillojmë një proces mësimor gjithëpërfshirës nëpërmjet aktiviteteve mësimore që përfaqësojnë këto stile të të nxëni. Stilet e të nxënit janë të lidhura ngushtësisht me aktivitetet mësimore, të cilat forcojnë mësimdhëniën me në qendër nxënësin. Në këtë mënyrë sigurohet një mësimdhënie sa më cilësore dhe gjithëpërfshirëse nga ana e mësuesve.

Studimi i stileve të të nxënit ka zënë një vend të rëndësishëm në kërkimet

bashkëkohore të pedagogjisë dhe të mësimdhënies së gjuhëve të huaja. Në kontekstin e mëimit të gjuhës angleze në arsimin parauniversitar, ku nxënësit paraqesin dallime të shumta në mënyrën e përvetësimit, përpunimit dhe përdorimit të informacionit, njohja e stileve të të nxënësit konsiderohet një element thelbësor për planifikimin e proceseve efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studiues të ndryshëm argumentojnë se përshtatja e metodave pedagogjike me karakteristikat individuale të nxënësve mund të ndikojë pozitivisht në motivimin, përfshirjen dhe arritjet e tyre akademike (Oxford, 2003).

Një ndër modelet që trajton stilet e të nxënësit është modeli i Fleming (2001), i njohur si modeli VARK, i cili klasifikon nxënësit sipas preferencave të tyre shqisore si: *vizual ose pamor* (visual); *dëgjimor* (auditory); *lexues/shkrues* (read/write); *kinestetikë ose të lëvizjes* (kinesthetic). Ky model ka gjetur përdorim të gjerë në mësimdhënien e gjuhës angleze, pasi ndihmon mësuesit të diversifikojnë strategjitë dhe materialet didaktike. Modeli i Flemingut jep një kontribut shumë të madh në lidhje me gjithëpërfshirjen e nxënësve në klasë. Gjithëpërfshirja është një veçori e shkollës së shekullit të njëzetë e një dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj. Gjithashtu, nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi jo vetëm shkencore, por edhe aftësi dhe njohuri qytetare e shoqërore.

Synimi i këtij punimi është që të ndahen e të shkëmbehen përvoja dhe eksperiencia pedagogjike në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës nëpërmjet stileve të të nxënësit dhe aktiviteteve mësimore që lidhen me to. Stilet e të nxënësit përfaqësojnë një grup sjelljes dhe qëndrimesh që ndikojnë në mënyrën se si nxënësit mësojnë në ambientet shkollore. Për më tepër, stilet e të nxënësit përfshijnë disa mënyra me anë të të cilave nxënësit përdorin shqisat e tyre gjatë gjithë procesit të të mësuarit për të fituar njohuri dhe aftësi të reja. Në këtë punim do të paraqiten disa mënyra praktike të mbarëvajtjes së procesit mësimor të gjuhës së huaj angleze në veçanti dhe të funksionimit të rolit të shkollës në edukimin bashkëkohor në përgjithësi. Literatura e përfshirë në pjesën teorike të këtij punimi përmban autorë të ndryshëm të pedagogjisë bashkëkohore.

## 2. Shqyrtimi i literaturës

Mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhës së huaj angleze në arsimin parauniversitar përbëjnë një ndër fushat më të studiuara të pedagogjisë bashkëkohore, për shkak të rolit të rëndësishëm që gjuha angleze luan në komunikimin global, zhvillimin akademik dhe integrimin socio-kulturor të individëve. Në këtë kontekst, studiuesit kanë vënë në dukje se nxënësit nuk mësojnë në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin ritëm, por shfaqin preferenca të ndryshme në përvetësimin, përpunimin dhe përdorimin e informacionit. Këto dallime individuale njihen në literaturë si stile të të nxënësit dhe konsiderohen

faktorë me ndikim në efektivitetin e procesit mësimor (Oxford, 2003).

Literatura ndërkombëtare sugjeron se njohja dhe marrja në konsideratë e stileve të të nxënësve mund të ndihmojë mësuesit në projektimin e praktikave pedagogjike më efektive, të cilat i përgjigjen nevojave dhe karakteristikave të ndryshme të nxënësve (Kolb, 1984; Reid, 1987). Për këtë arsye, shqyrtimi i literaturës mbi stilet e të nxënësve paraqet rëndësi të veçantë për kuptimin e rolit të tyre në mësimnxënien dhe mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin parauniversitar.

**Paraqitja e problemit:** Një nga sfidat kryesore në mësimdhënien e gjuhës së huaj angleze është heterogjeniteti i nxënësve brenda klasës. Nxënësist ndryshojnë jo vetëm për nga niveli i njohurive gjuhësore, por edhe për nga mënyrat e perceptimit, organizimit dhe përpunimit të informacionit. Në praktikën arsimore, shpesh përdoren metoda të standardizuara të mësimdhënies, të cilat nuk arrijnë të adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat individuale të të gjithë nxënësve (Brown, 2007). Sipas Dunn (1993), mospërputhja ndërmjet metodave të mësimdhënies dhe preferencave të nxënësve mund të ndikojë negativisht në motivimin, angazhimin dhe rezultatet e të nxënësve. Në rastin e mësimit të gjuhës angleze, kjo problematikë bëhet edhe më e dukshme për shkak të kompleksitetit të aftësive që kërkon përvetësimi i një gjuhe të huaj, si: *dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi*.

Nga ana tjetër, literatura shkencore paraqet debate lidhur me vlefshmërinë empirike të teorive të stileve të të nxënësve. Disa autorë argumentojnë se nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë se përshtatja e mësimdhënies sipas stileve individuale përmirëson drejtpërdrejt rezultatet akademike (Pashler et al., 2008). Kjo situatë krijon nevojën për analiza të mëtejshme teorike dhe empirike mbi rolin e stileve të të nxënësve në mësimdhënien e gjuhës angleze.

**Konteksti i problemit:** Zhvillimet bashkëkohore në pedagogji kanë zhvendosur fokusin nga mësimdhënien e orientuar te mësuesi drejt qasjeve të përqendruara te nxënësi. Në këtë kuadër, njohja e karakteristikave individuale të nxënësve është bërë një element i rëndësishëm për organizimin e procesit mësimor (Tomlinson, 2014). Në arsimin parauniversitar, klasat karakterizohen nga diversiteti i madh i nxënësve për sa i përket aftësive, interesave, motivimit dhe stileve të të nxënësve. Për këtë arsye, shumë studiues kanë argumentuar se mësuesit duhet të përdorin strategji të diferencuara që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në procesin e të nxënësve (Richards & Rodgers, 2014).

Në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, Reid (1987) identifikoi stile të ndryshme perceptuese, duke përfshirë stilet vizuale, dëgjimore, kinestetike dhe taktike. Në mënyrë të ngjashme, Fleming (2001) zhvilloi modelin VARK, i cili kategorizon nxënësist sipas preferencave të tyre për marrjen dhe përpunimin e

informacionit.

Ndërkohë, teoria e të nxënësve përmes përvijës së Kolb (1984) thekson se individët përvijësojnë njohuritë në mënyra të ndryshme bazuar në kombinimin e përvijës konkrete, reflektimit, konceptualizimit abstrakt dhe eksperimentimit aktiv. Këto qasje teorike kanë ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze.

### 3. Rëndësia e studimit

Studimi i stileve të të nxënësve ka rëndësi teorike dhe praktike për arsimin parauniversitar. Në aspektin teorik, ai kontribuon në kuptimin e dallimeve individuale që karakterizojnë procesin e të nxënësve dhe ndihmon në pasurimin e njohurive pedagogjike mbi mënyrën se si nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore.

Në aspektin praktik, njohja e stileve të të nxënësve mund t'u mundësojë mësuesve të gjuhës angleze të hartojnë aktivitete më gjithëpërfshirëse dhe më të larmishme. Oxford (2003) argumenton se ndërgjegjësimi për stilet e të nxënësve ndihmon në përzgjedhjen e strategjive mësimore që rrisin përfshirjen aktive të nxënësve dhe përmirësojnë efektivitetin e procesit të të nxënësve.

Gjithashtu, studimi është i rëndësishëm për zhvillimin profesional të mësuesve, pasi i ndihmon ata të kuptojnë më mirë nevojat individuale të nxënësve dhe të krijojnë mjedise mësimore fleksibël, motivuese dhe të orientuara drejt nxënësit (Tomlinson, 2014).

Në një kohë kur sistemet arsimore synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, analiza e stileve të të nxënësve paraqet një mjet të vlefshëm për përmirësimin e praktikave pedagogjike në mësimin e gjuhës angleze.

Ky studim analizon dhe shqyrton literaturën bashkëkohore mbi stilet e të nxënësve në mësimdhënien dhe mësimdhënien e gjuhës së huaj angleze në arsimin parauniversitar, duke identifikuar ndikimin e tyre në procesin e përvijësimit të gjuhës dhe në praktikat pedagogjike të mësuesve.

### 4. Metodologjia

Ky studim përfshin metodën e përzier (mixed) nëpërmjet ndërthurjes së studimit sasior dhe studimit cilësor. Në studimin sasior u përdor një pyetësor i standardizuar për nxënësit e klasave të gjashta deri në ato të dymbëdhjeta, të cilët u përkasin shkollave të ndryshme publike të arsimit parauniversitar në qytete të ndryshme të Shqipërisë si: Tiranë, Kamëz etj.. Në këtë pyetësor morën pjesë 110 nxënës të grupmoshës 12-18 vjeç. Në studimin cilësor përfshihet një studim rasti dhe vëzhgim për stilet e të nxënësve në katër klasa të gjashta me 90 nxënës në total

të grupmoshës 12 vjeç në dy shkolla 9-vjeçare periferike të qytetit të Tiranës.

Qëllimi i studimit përfshin paraqitjen e kontekstit shkollor të stileve të të nxënësve në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës së huaj angleze, identifikimin e sfidave bashkëkohore të mësimnxënies me stilet e të nxënësve si dhe dhënien e rekomandimeve për mësuesit e gjuhës angleze për një mësimdhënie cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Objektivi i përgjithshëm i studimit është: të analizojë konceptet teorike dhe modelet kryesore të stileve të të nxënësve të zhvilluara nga studiuesit ndërkombëtarë. Ky studim synon me anë të objektivave më specifike të:

- shqyrtojë marrëdhënien ndërmjet stileve të të nxënësve dhe përvetësimit të kompetencave në gjuhën angleze;
- identifikojë strategjitë pedagogjike që mbështesin stile të ndryshme të të nxënësve në klasat e arsimit parauniversitar;
- evidentojë sfidat dhe debatet shkencore që lidhen me përdorimin e teorisë së stileve të të nxënësve në praktikën arsimore;
- ofrojë një bazë teorike për zhvillimin e praktikave mësimore të diferencuara dhe të orientuara drejt nevojave individuale të nxënësve.

Hipotezat e studimit janë:

1. Nëse stilet e të nxënësve të arsimit parauniversitar lidhen statistikisht me nivelet e arritjeve të tyre akademike të gjuhës së huaj angleze, atëherë nxënësit do të ndihen më të motivuar në orën mësimore, sepse gjatë procesit mësimor nxitet gjithëpërfshirja e nxënësve në mësim.
2. Përdorimi i metodave të diferencuara të mësimdhënies, të përshtatura me stile të ndryshme të të nxënësve, ndikon pozitivisht në motivimin dhe përfshirjen e nxënësve gjatë procesit të mësimnxënies së gjuhës angleze.
3. Nxënësit që mësojnë në një mjedis mësimor ku merren parasysh stilet e tyre të të nxënësve arrijnë rezultate më të larta në zhvillimin e aftësive gjuhësore (dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim) krahasuar me nxënësit që ndjekin mësimdhënie tradicionale.

Pyetjet kërkimore të këtij studimi janë:

1. Cilat janë stilet mbizotëruese të të nxënësve të arsimit parauniversitar gjatë mësimit të gjuhës së huaj angleze?
2. Si arrihet përvetësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave gjuhësore në një klasë heterogjene në lëndën e gjuhës së huaj angleze?
3. Në çfarë mase mësuesit e gjuhës angleze i marrin në konsideratë stilet e të nxënësve gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve mësimore?

Popullata e studimit përfshin: nxënësit, mësuesit, drejtorin e shkollës dhe prindërit e nxënësve, ndërsa popullata e targetuar e studimit përfshin: nxënësit

dhe mësuesit. Kampioni i studimit përfshiu në total 200 nxënës të klasave dhe shkollave të ndryshme të arsimit parauniversitar shqiptar.

Lloji i kampionimit ishte i qëllimshëm dhe përfshiu një larmishmëri të niveleve gjuhësore, klasave, shkollave dhe grupmoshave shkollore. Madhësia e kampionimit në këtë studim ishte e mjaftueshme për shkak të pjesëmarrjes së një numri të konsiderueshëm të nxënësve dhe mësuesve. Avantazhet e kampionimit janë: ka një pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësuesve në studim; të dhënat e mbledhura pasqyrojnë realitetin e stileve të të nxënësve në kontekstin shkollor shqiptar; të dhënat e studimit japin një ndihmesë të madhe në hartimin e politikave të duhura arsimore. Disavantazhi i kampionimit është se studimi përfshin shkolla kryesisht të Shqipërisë së Mesme, ndërkohë që studimi duhet të përfshijë edhe shkollat e Shqipërisë së Veriut dhe të Jugut.

Përshkrimi i kampionit është siç vijon: në pyetësin e standartizuar u përfshinë nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të grupmoshës 12-18 vjeç nga klasa e gjashtë deri në atë të dymbëdhjetë të niveleve gjuhësore A2 deri në nivelin B2. Në studimin e rastit u përfshinë vetëm nxënës të 4 klasave të gjashta në dy shkolla 9- vjeçare të grupmoshës 12 vjeçare dhe mësuesi lëndor i gjuhës angleze. Në studim kishte interes për pjesëmarrje vullnetare të nxënësve dhe mësuesve në studim.

Instrumentet kërkimore që u përdorën në studim janë: pyetësor dhe vëzhgim i nxënësve për stilet e të nxënësve në lëndën e gjuhës angleze. Pyetësorët përmbanin pyetje të mbyllura që japin përgjigjen po/jo, pyetje të hapura dhe pyetje me alternativa të shumëfishta. Vëzhgimi i nxënësve të klasave të gjashta u krye gjatë procesit mësimor të gjuhës së huaj angleze dhe në vëzhgim u përfshi triangulimi i të dhënave me ndërthurje të teorisë, metodës cilësore të vëzhgimit dhe të të dhënave të grumbulluara.

Historiku i studimit është si më poshtë: u planifikuan pyetjet e llojeve të ndryshme të pyetësorit; u përzgjedh kampioni i pjesëmarrësve në studim dhe u vëzhguan nxënës gjatë mësimit të gjuhës angleze si dhe u bashkëpunua ngushtësisht me nxënës, mësues, drejtuesit e shkollave dhe me prindërit e nxënësve. Pikëzimi i instrumenteve përfshiu 15 pyetje në pyetësor dhe aktivitete mësimore me stile të ndryshme të të nxënësve. Avantazhet e pikëzimit të instrumenteve të përdorura janë: u përdor një numër i mjaftueshëm i pyetjeve të hapura, të mbyllura dhe me alternativa të shumëfishta; gjatë vëzhgimit u vu theksi tek aktivitetet mësimore me në qendër nxënës dhe tek dokumentimi i vëzhgimit; të dhënat e grumbulluara nga pyetësi u kryen me Google forms dhe të dhënat e grumbulluara prej vëzhgimit u siguruan nëpërmjet mbajtjes së shënimeve të vëzhguesit dhe listëkontrollit (check list). Disavantazhi i pikëzimit të instrumenteve përfshin mospërdorimin e programeve më të avancuara të

mbledhjes së të dhënave. Metodologjia e analizës së të dhënave lidhet me analizën e statistikave të mbledhura me Google Forms dhe me të dhënat cilësore të mbledhura nëpërmjet listëkontrollit dhe shënimeve. Kufizimet në studim lidhen vetëm me një rajon të caktuar të Shqipërisë dhe duhet të përdoren edhe më shumë instrumente kërkimore. Gjatë studimit të kryer, u realizua aspekti etik duke u ruajtur të dhënat personale të pjesëmarrësve me konfidencialitet të plotë sipas parimeve themelore të kërkimit shkencor dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të nxënit përfshin një proces psiko-social kompleks dhe afatgjatë në të cilin një individ modifikon njohuritë dhe aftësitë, vlerat, qëndrimet e sjelljet nëpërmjet përvojës, praktikës, studimit dhe udhëzimit. Qasja me në qendër nxënësin përqëndrohet në parimin e të mësuarit konstruktivist që vë theksin tek roli i nxënësit për të ndërtuar kuptimin e koncepteve të reja nëpërmjet harmonizimit të informacionit të ri e njohurive paraprake duke zhvilluar pavarësinë, autonominë dhe përgjegjësitë e nxënësve në procesin e të menduarit dhe të të mësuarit. (Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikën së Shqipërisë, e përditësuar, 2024, fq. 60-61).

Gjenden shumë stile të të nxënit, por më kryesoret të cilat trajtohen në këtë punim janë: stili vizual, stili dëgjimor, stili verbal i leximit/shkrimit dhe stili kinestetik. Stili vizual ose pamor mundëson të mësuarit më mirë kur informacioni i njohurive dhe koncepteve të reja shoqërohet me diagrame, foto, pamje, vidjo vizatimore për ilustrimin e mësimit, grafikë etj.. Nxënësit e stilit dëgjimor mësojnë më mirë nëpërmjet mundësisë për të dëgjuar informacionin e ri mësimor. Këto nxënës dëgjojnë mësuesin dhe mbajnë shënime ose dëgjojnë një këngë ose një libër në formatin audio apo dëgjojnë përmbajtjen audiovizive të një dokumentari të caktuar. Nxënësit që mësojnë me stilin verbal të leximit dhe shkrimit pëlqejnë që të mësojnë konceptet e reja mësimore në formën e tekstit, shkrimit dhe prezantimit duke përmbledhur e sintetizuar mësimin me anë të detyrave me shkrim. Stili kinestetik i të nxënit përfshin mësimin fizik nëpërmjet aktiviteteve mësimore me lëvizje nëpër klasë.

Stilet e të nxënit kanë ndryshuar edhe rolin e mësuesit në klasë. Mësimdhënia me në qendër mësuesin i jepte mësuesit rolin si burim kryesor i dijes, gjë që shkaktonte shpesh pasivitet në klasë. Ndërsa, mësimdhënia me në qendër nxënësin i jep mësuesit rolin e orientuesit udhëzuesit dhe menaxherit të burimeve të ndryshme të dijes duke nxitur bashkëpunim dhe përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor. Në mësimdhënien me në qendër nxënësin, roli i mësuesit nuk kufizohet vetëm në transmetimin e njohurive, por përfshin edhe identifikimin e karakteristikave individuale të nxënësve. Tomlinson (2014) argumenton se diferencimi i mësimdhënies përbën një strategji efektive për adresimin e stileve

të ndryshme të të nxënimit në klasë.

Në mësimdhënien e gjuhës angleze, kjo nënkupton përdorimin e aktiviteteve të larmishme si: diskutimet në grup; projektet bashkëpunuese; prezantimet vizuale me vidjo-projektor, me piktura e vizatime; lojërat socio-edukative (dialogje, punë në grupe, konkurse; simulimet dhe dramatizimet; përdorimi i teknologjisë arsimore etj.). Sipas Richards dhe Rodgers (2014), qasjet bashkëkohore komunikuese favorizojnë krijimin e mundësive të shumta të të nxënimit, duke u mundësuar nxënësve të përfshihen në aktivitete që përputhen me preferencat e tyre individuale. Këto stile të të nxënimit japin një kontribut shumë të rëndësishëm në qasjen e mësimdhënies me në qendër nxënësin dhe në qasjen e mësimdhënies së diferencuar. Në këtë studim paraqiten të dhënat statistikore të grumbulluara me anë të pyetësorëve të plotësuar nga nxënësit pjesëmarrës në këtë studim. Studimi përmban gjetje sasiore dhe cilësore në kuadër të stileve të ndryshme të të nxënimit.

## 5. Gjetjet dhe rezultatet

Metoda e kërkimit shkencor në këtë punim përfshin një anketim/pyetësor mbi aktivitetet mësimore dhe një studim rasti dhe vëzhgimin të kryer nga një mësues lëndor i gjuhës angleze. Në këtë studim rasti dhe vëzhgim përmenden disa aktivitete mësimore të stileve të ndryshme të të nxënimit gjatë procesit mësimor të zhvilluar në lëndën e gjuhës angleze në katër klasa të gjashta të dy shkollave 9-vjeçare në periferi të Tiranës.

Përsa u përket gjetjeve dhe rezultateve të këtij punimi paraqiten të dhënat e mbledhura në mënyrë statistikore të anketës së zhvilluar me nxënës të arsimit parauniversitar të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve të qyteteve të ndryshme të Shqipërisë si: Tiranë, Kamëz etj.. Target grupi i studimit përfshin nxënës të grup-moshës 12-18 vjeç. Pyetjet e pyetësorit të zhvilluar përmbanin pyetje të mbyllura me dy alternativa. Pyetjet u zhvilluan mbi përdorimin e fjalorëve me piktura, hartave të koncepteve të reja mësimore, vidjove të shkurtëra mësimore, mbi punën në grupe, mbi përdorimin e Audio-CD-ve në lëndën e gjuhës angleze, mbi dialogjet në gjuhë angleze dhe mbi mënyrën se si ndiheshin nxënësit në orën e mësimimit të gjuhës së huaj angleze.

Rreth 50,9% e nxënësve të anketuar u shprehën se mësuesi/ja e tyre e gjuhës angleze përdorte fjalor me piktura gjatë shpjegimit të mësimimit. 63,6% e nxënësve të anketuar u përgjigjën që i përdornin hartat konceptuale në mësim për konceptet e reja. 20,6% e nxënësve të anketuar u shprehën se mësuesit e gjuhës angleze e ilustronin mësimin me vidjo të shkurtëra mësimore. 56,4% e nxënësve të anketuar u shprehën që punonin në punë me grupe gjatë mësimimit të gjuhës angleze. 53,6% e nxënësve të anketuar u përgjigjën se mësuesit e tyre të gjuhës angleze tregonin tregime ilustruese për të shpjeguar fjalët e reja. 70,8% e

nxënësve të anketuar yreguan se mësuesit e tyre të gjuhës angleze përsornin një magnetofon për pjesët e dëgjimit me Audio-CD. 80,9% e nxënësve të anketuar u përgjigjën se mësuesit e tyre të gjuhës angleze i nxisnin ato që të zhvillonin dialogje në situata të ndryshme sociale në gjuhë angleze me bashkëmoshatarët e tyre. 97,3% e nxënësve të anketuar u shprehën që ndiheshin shumë të lumtur gjatë orës mësimore të gjuhës angleze dhe se mezi presin që të vinte ora tjetër mësimore e gjuhës angleze.

Përsa i përket studimit të rastit, mësuesi lëndor i gjuhës së huaj angleze ka përdorur gjatë orës mësimore mjete didaktike si: magnetofon për Audio-CD për dëgjimin e dialogjeve në gjuhë angleze, laptop, vidjo-projektor, fjalor me piktura, hartat e koncepteve, tabelën e bardhë ndërvepruese (Interactive WhiteBoard) etj.. Ky mësues i ka nxitur nxënësit e tij që të zhvillojmë dialogje dhe të recitojnë vjersha në gjuhë angleze. Gjithashtu, nxënësit kanë punuar në grupe dhe kanë përshkruar me fjalët e tyre pikturat e tekstit të leximit në anglisht si dhe kanë plotësuar hartën e koncepteve të fjalëve të reja në tabelën e zezë. Gjatë gjithë procesit mësimor, nxënësit kanë shprehur vazhdimisht nismën e tyre për të marrë pjesë në orën mësimore të gjuhës angleze gjithmonë kur mësuesi lëndor ka zhvilluar aktivitete mësimore me në qendër nxënësin me anë të stileve të ndryshme të të nxënësve të gjuhës së huaj angleze. Mësuesi lëndor ka nxitur kreativitetin e nxënësve duke u dhënë si detyrë për të dhënë një përfundim ndryshe të tekstit të leximit në anglisht. Gjatë çdo stili të të nxënësve, mësuesi lëndor ka mbajtur shënime nëpërmjet checklist (listës së kontrollit), gjë e cila ka dhënë një ndihmesë të madhe në identifikimin e stilit të të nxënësve në të cilin nxënësit e klasës mësonin më mirë.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se mësuesit e gjuhës angleze në arsimin parauniversitar përdorin në një masë të konsiderueshme aktivitete dhe mjete mësimore që lidhen me stile të ndryshme të të nxënësve. Rezultatet dëshmojnë se ekziston një tendencë për të integruar qasje të ndryshme pedagogjike që synojnë përfshirjen e nxënësve me preferenca të ndryshme të të nxënësve, duke krijuar një mjedis më të larmishëm dhe më motivues për zhvillimin e kompetencave gjuhësore.

Përdorimi i fjalorëve me piktura nga 50,9% e mësuesve dhe i hartave konceptuale nga 63,6% e tyre tregon se elementet vizuale janë të pranishme në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze. Këto rezultate sugjerojnë se një pjesë e konsiderueshme e mësuesve i kushtojnë rëndësi stilit vizual të të nxënësve, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më lehtë fjalorin e ri dhe marrëdhëniet ndërmjet koncepteve gjuhësore. Megjithatë, përqindja jo shumë e lartë e përdorimit të fjalorëve me piktura tregon se ende ka hapësirë për zgjerimin e përdorimit të materialeve vizuale në klasë.

Një tjetër gjetje me rëndësi lidhet me përdorimin relativisht të ulët të videove të shkurtra mësimore (20,6%). Ky rezultat mund të tregojë kufizime në infrastrukturën teknologjike të shkollave ose mungesën e praktikave të konsoliduara për integrimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënien e gjuhës angleze. Duke qenë se videot kombinojnë elemente vizuale dhe dëgjimore, përdorimi i tyre mund të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e interesit dhe të kuptuarit të përmbajtjes nga nxënësit.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se 56,4% e nxënësve punojnë në grupe gjatë orëve të gjuhës angleze. Ky tregues dëshmon praninë e aktiviteteve bashkëpunuese, të cilat favorizojnë stilin social të të nxënësve dhe zhvillimin e aftësive komunikuese. Në të njëjtën kohë, 80,9% e nxënësve raportuan se mësuesit i nxinin të zhvillonin dialogje në situata të ndryshme sociale në gjuhën angleze. Kjo përqindje e lartë dëshmon orientimin e mësimit drejt qasjes komunikuese dhe krijimit të mundësive për përdorimin praktik të gjuhës.

Përqindja prej 70,8% e përdorimit të Audio-CD-ve dhe materialeve dëgjimore tregon se mësuesit i kushtojnë rëndësi zhvillimit të aftësive receptive, veçanërisht të dëgjimit. Kjo gjetje është në përputhje me rëndësinë që ka ekspozimi ndaj gjuhës autentike në përvetësimin e gjuhëve të huaja. Gjithashtu, përdorimi i tregimeve ilustruese nga 53,6% e mësuesve tregon përpjekjet për të lidhur mësimin me situata konkrete dhe kuptimplota, duke e bërë përmbajtjen më të afërt me përvojat e nxënësve.

Ndër rezultatet më domethënëse të studimit është fakti se 97,3% e nxënësve deklaruan se ndiheshin shumë të lumtur gjatë orës së gjuhës angleze dhe prisnin me interes orën e radhës. Ky rezultat sugjeron një nivel shumë të lartë motivimi dhe angazhimi, i cili mund të lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e aktiviteteve të larmishme dhe me qasjen e përqendruar të nxënësit. Literatura pedagogjike thekson se motivimi është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në suksesin e të nxënësve të gjuhëve të huaja, prandaj ky rezultat përbën një tregues pozitiv për efektivitetin e praktikave të përdorura.

Studimi i rastit mbështet dhe plotëson rezultatet e anketimit. Përdorimi i mjeteve të ndryshme didaktike, si magnetofoni, laptopi, videoprojektori, fjalorët me piktura, hartat konceptuale dhe tabela ndërvepruese, dëshmon për një qasje të larmishme pedagogjike që synon të adresojë stile të ndryshme të të nxënësve. Aktivitetet si dialogjet, recitimi i vjershave, puna në grupe, përshkrimi i pikturave dhe plotësimi i hartave konceptuale kanë krijuar mundësi që nxënësit të përfshihen aktivisht në procesin mësimor. Të dhënat e grumbulluara nga checklist (lista e kontrollit) rezulton se shumica e nxënësve mësojnë më mirë dhe tregojnë interes të madh për mësimin e gjuhës angleze nëpërmjet stilit pamor të të nxënësve. Angazhimi dhe iniciativa e vazhdueshme e nxënësve gjatë këtyre

aktiviteteve sugjerojnë se mësimdhënia e diferencuar sipas stileve të të nxënësve mund të ndikojë pozitivisht në pjesëmarrjen dhe motivimin e tyre.

## 6. Diskutime dhe përfundime

Mësimdhënia duhet të zhvillohet në përputhje me stilet e të nxënësve të të gjithë nxënësve të klasës. Nxënës të ndryshëm kanë stile të ndryshme të të mësuarit e koncepteve të reja mësimore. Stilet e të nxënësve lehtësojnë mësimdhënien e diferencuar në klasë ku secili nxënës mëson sipas stilit që i përshtatet më së miri. Duke njohur stilet e të nxënësve, mësuesi/ja mund të organizojë aktivitetet mësimore në atë mënyrë që t'u përshtaten nevojave të nxënësve. Në stilin pamor/vizual, mësuesi/ja mund të nxisë nxënësit që të bëjnë vizatime ose harta konceptesh; nxënësit mund të shikojnë dokumentar ose video udhëzuese; nxënësit mund të përdorin hartën e koncepteve, diagramin e Venit për të krahasuar dy koncepte të ndryshme; nxënësit mund të përshkruajnë foto ose harta të ndryshme etj.. Në stilin dëgjimor, nxënësit mund të përdorin tregime të bazuara në ilustrime dhe të incizuara në audio në formatin e librit digjital e-book; nxënësit mund të dëgjojnë dialogje në kontekste të ndryshme sociale në gjuhë të huaj etj.. Në stilin verbal të lexim-shkrimit, nxënësit mund të mbajnë shënime gjatë shpjegimit të mësimin nga mësuesi/ja; mund të lexojnë një tekst me zë të lartë dhe me pas, të diskutojnë dhe t'a ritregojnë tekstin; mund të shkruajnë një ese ose mund të recitimin një vjershë përpara klasës. Në stilin kinestetik, nxënësit mund të zhvillojnë një lojë me role duke improvizuar një situatë sociale; mund të aktrojnë një dramë, mund të zhvillojnë një dialog etj..

Ky studim evidenton se përdorimi i stileve të ndryshme të të nxënësve në mësimdhënien e gjuhës angleze kontribuon në krijimin e një mjedisi mësimor më gjithëpërfshirës, më motivues dhe më efektiv për nxënësit e arsimit parauniversitar. Gjetjet tregojnë se mësuesit e gjuhës angleze përdorin një sërë strategjish dhe aktivitetesh që adresojnë stile të ndryshme të të nxënësve, si stili vizual, dëgjimor dhe bashkëpunues, duke mundësuar përfshirjen aktive të nxënësve në procesin mësimor. Përdorimi i mjeteve vizuale, si fjalorët me piktura dhe hartat konceptuale, ka rezultuar i dobishëm për kuptimin dhe përvetësimin e koncepteve të reja gjuhësore, duke lehtësuar procesin e të nxënësve të një numër i konsiderueshëm nxënësish.

Aktivitetet dëgjimore dhe komunikative, të tilla si dëgjimi i dialogjeve në gjuhën angleze dhe zhvillimi i dialogjeve ndërmjet nxënësve, kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe në rritjen e vetëbesimit të nxënësve gjatë përdorimit të gjuhës së huaj. Puna në grupe dhe aktivitetet bashkëpunuese kanë nxitur ndërveprimin social, shkëmbimin e ideve dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave

komunikuese dhe sociale. Studimi i rastit konfirmon se përdorimi i metodave dhe aktiviteteve të larmishme, të orientuara drejt nevojave të nxënësve, rrit interesin, angazhimin dhe motivimin e tyre gjatë orëve të gjuhës angleze.

Niveli shumë i lartë i kënaqësisë së nxënësve ndaj orës së gjuhës angleze tregon se zbatimi i aktiviteteve që përfshijnë stile të ndryshme të të nxënësve ndikon pozitivisht në klimën e klasës dhe në qëndrimin e nxënësve ndaj procesit mësimor. Rezultatet e studimit mbështesin idenë se nuk ekziston një stil i vetëm i të nxënësve që garanton sukses për të gjithë nxënësit; përkundrazi, kombinimi i strategjive të ndryshme pedagogjike krijon mundësi më të mëdha për arritje dhe përfshirje të suksesshme të çdo nxënësi. Mësimdhënia e diferencuar, e mbështetur në stile të ndryshme të të nxënësve, paraqitet si një qasje e rëndësishme pedagogjike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të rezultateve të nxënësve në gjuhën angleze.

Në përfundim, studimi dëshmon se integrimi i stileve të ndryshme të të nxënësve në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze përbën një faktor të rëndësishëm në rritjen e motivimit, pjesëmarrjes aktive dhe efektivitetit të të nxënësve, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm akademik dhe personal të nxënësve.

## 7. Rekomandime

Një vëmendje e veçantë në këtë punim do t'u kushtohet edhe rekomandimeve mbi zbatimin e stileve të të nxënësve në kontekstin e arsimit parauniversitar shqiptar ku theksohet rëndësia e mjeteve didaktike dhe aktiviteteve mësimore për një mësimdhënie cilësore e bashkëkohore sa më gjithëpërfshirëse. Rekomandohet që mësuesit, veçanërisht mësuesit e gjuhës së huaj angleze të përdorin tabelën e bardhë ndërvepruese (Interactive WhiteBoard) për të shpjeguar mësimin e ri sipas stileve të sipërpërmendura të të nxënësve. Gjithashtu, mësuesit e gjuhës së huaj angleze duhet të përdorin një magnetofon ose pajisje audio MP3 në mënyrë që nxënësit të mund të dëgjojnë dialogje të ndryshme sociale në gjuhë të huaj. Përdorimi i laptopit dhe i vidjo-projektorit është një nevojë e domosdoshme për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Sugjerohet që mësuesit të përdorin fjalor me piktura për të shpjeguar fjalët e reja në gjuhë të huaj. Për më tepër, mësuesit mund të përdorin piktura të një tregimi të shkurtër të renditura pa radhë, të cilat nxënësit mund t'i rendisin sipas radhës së duhur dhe të formojnë një ngjarje imagjinare me to. Përdorimi i diagramit të Venit në tabelën e zezë ose në fletore ndihmon nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike duke krahasuar dhe duke gjetur të përbashkëtat dhe ndryshimet e dy koncepteve të ndryshme. Ditari dy pjesësh ku në njërin anë citohet një thënie e autorit dhe në anën tjetër komentohet ajo shprehje nga nxënësit, i ndihmon nxënësit të zhvillojnë stilin verbal të shkrim-leximit. Dialogjet, loja me role

dhe dramatizimi janë aktivitete mësimore të shkëlqyera për stilin kinestetik të të nxënit dhe e bëjnë mësimin më interesant e më ndërveprues dhe e kthejnë klasën në një mjesis shkollor më miqësor për nxënësit.

Mësuesit e gjuhës angleze duhet të vazhdojnë të përdorin një kombinim aktiviteteve që mbështesin stile të ndryshme të të nxënit, në mënyrë që të plotësojnë nevojat dhe preferencat e ndryshme të nxënësve. Institucionet arsimore duhet të investojnë më shumë në pajisje teknologjike dhe burime digjitale për të rritur përdorimin e videove edukative dhe materialeve multimediale në klasë. Duhet të organizohen trajnime profesionale për mësuesit lidhur me identifikimin dhe integrimin e stileve të të nxënit në procesin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja. Aktivitetet bashkëpunuese, puna në grupe dhe dialogjet komunikative duhet të zënë një vend më të madh në planifikimin mësimor, pasi ato nxisin ndërveprimin dhe zhvillimin e aftësive komunikuese.

Mësuesit duhet të përdorin më shpesh mjete vizuale, si fjalorët me piktura, hartat konceptuale dhe tabelat ndërvepruese, për të lehtësuar kuptimin dhe përvetësimin e koncepteve të reja gjuhësore. Drejtoritë dhe institucionet përgjegjëse për arsimin duhet të mbështesin krijimin e mjediseve mësimore që favorizojnë qasjet me në qendër nxënësin dhe promovojnë pjesëmarrjen aktive të tij. Studime të ardhshme mund të përfshijnë mostra më të gjera dhe instrumente kërkimore më të larmishme për të analizuar më thellësisht ndikimin e stileve të të nxënit në arritjet akademike të nxënësve në gjuhën angleze. Rekomandohet që hartuesit e kurrikulave të integrojnë më qartë strategjitë e lidhura me stilet e të nxënit, duke ofruar udhëzime praktike për përdorimin e tyre në klasat e arsimit parauniversitar. Duhet të inkurajohet përdorimi i metodave aktive të të nxënit, të cilat rrisin motivimin, autonominë dhe përgjegjësinë e nxënësve për të nxënin e tyre. Nisur nga niveli shumë i lartë i kënaqësisë së nxënësve ndaj lëndës së gjuhës angleze, praktikat e suksesshme të evidentuara në këtë studim mund të shërbejnë si modele të mira për t'u zbatuar edhe në lëndë të tjera të kurrikulës shkollore.

---

**BIBLIOGRAFIA**

- BABJI, N., *Stilet e të nxënit*, <https://naimbabaj67.weebly.com/stilet-e-teuml-nxeuml-nit.html>.
- DUNN, R., & DUNN, K. (1993). *Teaching secondary students through their individual learning styles: Practical approaches for grades 7–12*. Allyn & Bacon.
- FLEMING, N. D. (2001). *Teaching and learning styles: VARK strategies*.
- GARO, S. (2011). *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*. U.F.O. Press, fq.7.
- Grup autorësh (1997). *Strategjia e të mësuarit*. Prishtinë: Koha, fq.362.
- KOLB, D. A. (1984). *Experiential learning: Experience as the source of learning and development*. Prentice Hall.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar e Republikës së Shqipërisë, e përditësuar, Tiranë, 2024.
- KRAJA, M. (2012). *Pedagogjia*. Tiranë: Erik, fq.332
- OXFORD, R. L. (2003). *Language learning styles and strategies: An overview*. GALA Journal, 1(1), 1–25.
- PASHLER, H., MCDANIEL, M., ROHRER, D., & BJORK, R. (2008). *Learning styles: Concepts and evidence*. Psychological Science in the Public Interest, 9(3), 105–119.
- Portali Shkollor Alb. <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/stilet-e-te-nxenit-ngamsepranvera-musta>
- REID, J. M. (1987). *The learning style preferences of ESL students*. TESOL Quarterly, 21(1), 87–111.
- RICHARDS, J. C., & RODGERS, T. S. (2014). *Approaches and methods in language teaching* (3rd ed.). Cambridge University Press.
- TOMLINSON, C. A. (2014). *The differentiated classroom: Responding to the needs of all learners* (2nd ed.). ASCD.